



# **Plani - Vendor**

**I Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve**

**Bashkia Elbasan**

**2019 - 2024**



## Fjala e kryetarit

Të nderuar Këshilltar e Bashkëqytetarë!

Mbrojtja e mjedisit dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve urbane janë një objektiv parësor i Bashkisë. Në territorin e Bashkisë gjenden burime të rëndësishme natyrore të cilat kanë statusin e zonave të mbrojtura si Qafa e Bushit në Njësinë Administrative Labinot Mal, zona e Sopotit pjesërisht në Njësin Administrative Zavalinë, zona e burimeve të Llixhave në Njësinë Administrative Tregan, etj si dhe një rrjet hidrik i pasur me jetë.

Zhvillimi i turizmit dhe ekonomisë së gjelbër përbëjnë potenciale të rëndësishme për përmirësimin e nivelit të jetesës së qytetarëve Elbasanas. Këto veprimtari do të zhvillohen duke ruajtur e konsoliduar këto burime natyrore të rëndësishme nëpërmjet një mjedisi më të pastër dhe shfrytëzimi racional të tyre.

Bashkia e Elbasanit është e qartë dhe kupton se menaxhimi i integruar i mbetjeve është një sfidë shumë ambicioze, por njëkohësisht është dhe një kusht që duhet përmbushur domosdoshmërisht për të mundur një mjedis të pastër dhe ekonomi të qëndrueshme.

Nëpërmjet Planit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2019 – 2024, Bashkia do të synojë grumbullimin e mbetjeve në të paktën 85 % të territorit dhe do të përmbushë të gjitha detyrimet për reduktimin deri në 50 % të mbetjeve nëpërmjet riciklimit dhe kompostimit, kështu do të arrijë të gjitha objektivat kombëtare dhe kriteret e integritimit Evropian.

Përmbushja e këtyre objektivave është e kushtueshme, ajo kërkon, kohë, përkushtimin tonë por edhe të qytetarëve Elbasanas. Ne e kuptojmë se krahas vendosjes së një sistemi efektiv për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, është e rëndësishme që qytetarët të bëhen pjesë e këtij përkushtimi. Bashkia nuk do të kursejë për të investuar në edukimin, ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen qytetare, ashtu sikundër ne do të bëjmë transparente të gjitha vendimet tona, për të mundur një rol sa më të madh të qytetarëve në zbatimin e këtij Plani.

Nëpërmjet këtij mesazhi i bëj thirrje të zgjedhurve vendor, administratës vendore dhe qendrore në Elbasan, si dhe të gjithë qytetarëve që me përkushtim të bashkëpunojmë të gjithë së bashku për ta bërë këtë Plan një realitet dhe ta kthejmë Elbasanin në një Bashki të gjelbër dhe miqësore me mjedisin.

Me respekt,

**Qazim Sejdini**

Kryetari i Bashkisë Elbasan



## Akronime

AKM	- Agjensia Kombëtare e Mjedisit
ARM	- Agjensia Rajonale e Mjedisit
BE	- Bashkimi European
ISHMPU	- Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit Pyjeve dhe Ujrave
ISHSH	- Inspektoriati Shtetëror i Shëndetësisë
MB	- Mbetjet nga Bizneset
MBZHR	- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MF	- Mbetjet nga Familjet
MIE	- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MTM	- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
NJA	- Njësi Administrative
NJQV	- Njësi Qëndrore Vendore
OJF	- Organizata Jo Fitim prurëse
PLMIMNU	- Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane
PKMM	- Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve
VGM	- Vend - Grumbullimi Mbetjesh
PPP	- Partneritet Publik Privat
SKM	- Strategjia Kombëtare e Mbetjeve
VKM	- Vendim i Këshilit të Ministrave
ZAM	- Zona e Administrimit të Mbetjeve

## Parantezë

Hartimi i Planit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve Urbane 2019 – 2024 (PMIM) në Bashkinë Elbasan është hartuar duke u mbështetur mbi një analizë të gjëndjes aktuale, të karakteristikave kryesore që lidhen elementët e planifikimit si dhe në përputhje me legjislacionin, dokumentat strategjike dhe syminet e Shqipërisë në procesin e Integritimit Evropian.

Analiza ka evidentuar problematikat kryesore siç janë renditur më poshtë:

- Nivel mesatar i mbulimit me grumbullimin e mbetjeve dhe standardit të shërbimit të largimit të mbetjeve të ngurta.
- Nivel mesatar i riciklimit.
- Kosto të larta të transportit.
- Nivel mesatar i mbulimit të kostos nga të ardhurat prej tarifës së shërbimit.
- Edukim dhe ndërgjegjësim i pamjaftueshëm.
- Investime kapitale të munguara.

Bashkia e Elbasan është e qartë dhe kupton se menaxhimi i integruar i mbetjeve është një sfidë shumë ambicioze.

Nëpërmjet zbatimit të PMIM, Bashkia do të përballet me sfidat kryesore të cilat do të adresojnë çështjet në vijim:

- Arritja e mbulimit me grumbullimin e mbetjeve në të gjithë territorin e aksesueshëm të Bashkisë Elbasan.
- Ofrimi i shërbimit sipas hierarkisë së menaxhimit të mbetjeve duke siguruar grumbullimin, reduktimin, ripërdorimin dhe riciklimin.
- Orjentimi drejt menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve nëpërmjet reduktimit, rritjes së riciklimit dhe rikuperimi.
- Përcaktimi i rolit të komunitetit të mbledhësve informal në sistemin e menaxhimit të integruar të mbetjeve.
- Krijimi i bazës së të dhënave për optimizmin e shërbimit.
- Zbatimi i parimit “ndotësi paguan”, rritja e të ardhurave nga tarifa drejt mbulimit të kostove të shërbimit

Në kuadër të këtij Plani është vlerësuar se arritja e objektivave në harkun kohor 2019 – 2024, do ti kushtojë Bashkisë Elbasan rreth 686 928 000 Lekë ose shumën ekuivalente prej 5 584 780 Euro. Plani synon vendosjen e një sistemi efektiv për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve duke kombinuar disa mënyra, kontenierë, qese, etj., përfshirë këtu investimet kapitale dhe mbulimin e kostove operacionale të cilat do të mbulohen kryesisht nga buxheti i Bashkisë dhe përmirësimi i infrastrukturës. Për vitin 2016 Bashkia Elbasan ka shpenzuar për shërbimin e pastrimit 82 896 000 lekë të ardhura nga tarifat 83 649 000 lekë. Për vitin 2017 Bashkia Elbasan ka shpenzuar për shërbimin e pastrimit 96 700 000 lekë të ardhura nga tarifat 102 771 000 lekë. Për vitin 2018 Bashkia Elbasan ka shpenzuar për shërbimin e pastrimit 91 867 000 lekë të ardhura nga tarifat 139 661 000 lekë. Për vitin 2019 Bashkia Elbasan ka planifikuar për shërbimin e pastrimit 106 384 000 lekë dhe të ardhura të parashikuara nga tarifat 140 000 000 lekë, ky shërbim rritet ~ 3% çdo vit. Për të rritur standartin dhe arritur objektivat në lidhje me reduktimin e mbetjeve, Bashkia e ka



Objektin për Reduktimin e Mbetjeve ( Inceleratorin ).

## Përmbajtja

- Mirënjohje	2
- Fjala e kryetarit	3
- Akronime	4
- Parantezë	5
- Përmbajtja	6
- Legjislacionin	7
- Kreu I Planifikimi i menaxhimit të mbetjeve urbane në Shqipëri	9
- Kreu II Hapat për zhvillimin e Planit - Vendor	11
- Kreu III Planifikimi operacional i Menaxhimit të mbetjeve	16
- Planifikimi Financiar i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve	21
- Aspektete institucionale të Menaxhimit të Mbetjeve	23
- Instrumentat për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve	26
- Përshkrimi i situatës së përgjithshme	28
- Aspektet Institucionale e teknike në Menaxhimin e mbetjeve në Bashki	40
- Aspektet ekonomiko - financiare të Menaxhimit të Mbetjeve	56
- Planifikimi Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane	68
- Studime dhe propozimet për realizimin e Planit Vendor 2019 - 2024 e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane	77
- Të dhënat teknike në lidhje me ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve deri në vitin 2024.	102
- Politika mbulimit të kostos nga të ardhurat nga tarifat e pastrimit	107
- Kuadri Ligjor dhe Institucional	113
- Plani i veprimit	121
- Objektivi Strategjik	123
- Rishikimi i Planit Vendor	125
- Hartat dhe pikat e grumbullimit të mbetjeve urbane	135



## Legjislacionin

- Ligji nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".
- Ligji nr. 10 463, datë 22.9. 2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve", amenduar me Ligjin nr. 156, datë 10.10.2013.
- Ligji nr. 9537, datë 18.5.2006 "Për manaxhimin e mbetjeve të rrezikshme".
- Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit".
- V.K.M nr.319 datë 31.05.2018 "Për miratimin e masave për koston e menaxhimit të integruar të mbetjeve
- VKM nr. 428, datë 08.06.2016 "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për hartën dixhitale vend deozitimeve të mbetjeve urbane".
- VKM nr. 687 datë 29.07.2015 "Për miratimin për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve".
- VKM nr. 575 datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte".
- VKM nr. 387 datë 06.05.2015 "Për miratimin e rregullave për kontrollin e asgjësimit të PCB-ve, ç'ndotjen apo asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB dhe/ose asgjësimin e mbetjeve të PCB-ve të përdorura.
- VKM nr. 127 datë 11.02.2015 "Për kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujrave të ndotura".
- VKM nr. 641, datë 01.10.2014 "Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme dhe mbetjeve inerte".
- VKM nr. 608 datë 17.09.2014 "Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve BIO si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre".
- VKM nr. 579 datë 03.09.2014 "Për një shtesë në vendimin nr.99, datë 18.02.2005 të Këshillit të Ministrave, për miratimin e Katalogut Shqipëtar të Klasifikimit të Mbetjeve".
- VKM nr.418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim".
- VKM nr. 371 datë 11.06.2014 "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre.
- VKM nr. 229 datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit"
- VKM nr. 52, datë 05/02.2014 për disa ndryshime në Vendimin Nr.117, datë 13/02/2013 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret që përcaktojnë kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje".
- VKM nr. 117, datë 13/02/21013 "Për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje".
- VKM nr. 957, datë 19/12/2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike".
- VKM nr. 866, datë 04/12/2012 "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre".
- VKM nr. 765, datë 07/11/2012 "Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura".



- VKM nr. 705, datë 10/10/2012 "Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës".
- VKM nr. 452, datë 11/07/2012 "Për Landfill-et e mbetjeve".
- VKM nr. 177, datë 06/03/2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre".
- VKM nr. 178, datë 06/03/2012 "Për incinerimin e mbetjeve".
- VKM nr. 175, datë 19/01/2011 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve".
- VKM nr. 798, datë 29/09/2010 për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore".
- VKM nr. 99, datë 18/02/2005 "Për miratimin e katalogut Shqipëtar të klasifikimit të mbetjeve".
- Udhëzim nr.1738, datë 12.03.2015 "Mbi kriteret e studim-projektimit për rehabilitimin e vend-depozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane, si dhe ndërtimin e Landfilleve apo impianteve të trajtimit të mbetjeve të ngurta urbane".

## KREU I

### Planifikimi i menaxhimit të mbetjeve urbane në Shqipëri

Viti 1994 shënoi momentin kur autoriteteve lokale ju deleguan shërbimet e menaxhimit të mbetjeve dhe shërbime të tjera pastrimi, duke i bërë këto të fundit përgjegjëse për manaxhimin e tyre dhe njëkohësisht, duke u siguruar financimin nga Qeverisja Qendrore me anë të "granteve të pakushtëzuara".

Hartimi i planit vendor nga Njësitë e Qeverisjes Vendore është një detyrim ligjor i përcaktuar nga Ligji i ri nr.10463, datë 22.09.2011 "Për manaxhimin e integruar të mbetjeve" ku në nenin 12, pika 2 citohet:

*"Çdo Njësi e Qeverisjes Vendore apo grup njësisht të qeverisjes vendore harton planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me planin kombëtar dhe planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe me kërkesat e nenit 10 të këtij ligji"*

Proçesi i delegimit të kompetencave, pavarsisht përmirësimeve graduale të vrejtura është kthyer në një sfidë për autoritetet Vendore. Ata janë ballafaqur:

- Me mungesën e instrumentave të nevojshëm për Menaxhimin Mjedisor të Mbetjeve.
- Me mungesë të teknologjive dhe të investimeve.
- Si dhe të kapaciteteve të mjaftueshëm të burimeve njerëzore dhe financiare.

Planifikimi. Krahas Aspekteve Financiare, Legjislative e të Edukimit është:

- Një nga shtyllat kryesore për zbatimin e politikave strategjike të Menaxhimit të Mbetjeve.
- Garanton qëndrueshmëri në suksesin e menaxhimit në nivel kombëtar, rajonal e vendor.
- Hapi i parë në zbatimin e politikës kombëtare për menaxhimin e mbetjeve.

Autoritetet vendore duhet të përfshijnë në Planet e tyre të Menaxhimit projekte për:

- Pastrimin e infrastrukturës rrugore të sipërfaqeve urbane.
- Rehabilitimin e vendeve të pa autorizuar të vendeve të grumbullimit të mbetjeve.
- Transportin e largimin e mbetjeve urbane.
- Depozitimin e trajtimin e mbetjeve në Landfill.

Këto plane duhet të hartohen dhe të mbështeten nga udhëzimet dhe standartet e vendosura si dhe nga metodologjia që mundëson zbatimin e tyre me efektivitet.

Gjatë zhvillimit të proçesit të Planifikimit të mbetjeve u bë gjithnjë e më shumë evidente nevoja për të pa një udhëzues për autoritet vendore, që mund të hartojnë Planet e tyre të Menaxhimit të Mbetjeve.

Ç'farë është një Plan - Vendor

Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane (PLMIMNU) është:

- Një dokument i Planifikimit Strategjik, i cili mundëson zbatimin e politikave kombëtare të mbetjeve në nivel vendor
- Një Plan - Lokal i menaxhimit të mbetjeve urbane tregon një drejtim për të ardhmen dhe nxit mendimin e përbashkët të aktorëve që janë përfshirë në proçesin e studimit, planifikimit, hartimit e zbatimit të tij.

Qëllimi i PLMIMNU konsiston në:





Të orientojë Autoritetet Vendore drejt masave praktike dhe veprimeve në lidhje me pastrimin, grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve si dhe sistemet e riciklimit dhe impianteve që lidhen me ta. Nga ku:

- Një Plan Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane synon të ofrojë:
  - Sfidën e re që ka Bashkia për të ofruar shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në të gjithë territorin e saj.
  - Optimizimi i kostos së shërbimit kundrejt buxheteve të limituara që ka Bashkia.
  - Si dhe në hartimin e nevojave për investime kapitale për sektorin e menaxhimit të mbetjeve.
- Gjithashtu plani fokusohet edhe në përcaktimin e metodologjisë për zbatimin e sistemit të monitorimit, si dhe në ngritjen e kapaciteteve brenda Bashkisë për zbatimin e planit.
- Më konkretisht;  
Ky plan ka si qëllim të mundësojë dhe sigurojë si më poshtë:
  - Përputhshmëri me Strategjinë Kombëtare të Mbetjeve (SKM) dhe objektivat e saj: duke kontribuar në zbatimin e politikave kombëtare dhe arritjen e objektivave në fushën e menaxhimit të mbetjeve.
  - Opsionet e menaxhimit të mbetjeve: për të mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve në përputhje me objektivat kombëtare.
  - Plani identifikon fushat dhe teknologjitë e duhura për minimizimin dhe depozitimin (asgjësimin ) final të mbetjeve.
  - Instrumente institucionale, organizative dhe rregullore: mundëson paraqitje të plotë të kuadrit institucional, organizativ e rregullator dhe rekomandon masat për përmirësimin e elementeve përbërës të tij, duke përfshirë ato që kontrollojnë mbetjet në të gjithë sistemin e menaxhimit për të siguruar përputhshmërinë me standartet e menaxhimit të mbetjeve.
  - Nevojat financiare për investime: duke përshkruar dhe argumentuar nevojat financiare dhe nevojën për investime për zbatimin e skemave të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve.
  - Burime financiare për investime: duke krijuar një klimë të favorshme për sigurimin e fondeve qeveritare për mbetjet sikurse dhe fonde nga institucione ndërkombëtare.

## Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve si një prespektive Strategjike.

Viti 1994 shënoi momentin kur autoriteteve lokale ju deleguan shërbimet e menaxhimit të mbetjeve dhe shërbime të tjera pastrimi, duke i bërë këto të fundit përgjegjëse për manaxhimin e tyre dhe njëkohësisht, duke u siguruar financimin nga Qeverisja Qendrore me anë të "granteve të pakushtëzuara".

Hartimi i planit vendor nga Njësitë e Qeverisjes vendore është një detyrim ligjor i përcaktuar nga Ligji i ri nr.10463, datë 22.09.2011 "Për manaxhimin e integruar të mbetjeve", ku në nenin 12, pika 2 citohet:

*"Çdo Njësi e Qeverisjes Vendore apo grup Njësish të Qeverisjes Qendrore harton Planin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me Planin Kombëtar dhe Planin Rajonal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe me kërkesat e nenit 10 të këtij ligji"*

Autoritetet vendore duhet të përfshijnë në Planet e tyre të Menaxhimit projekte për:

- Pastrimin e infrastrukturës rrugore e sipërfaqeve urbane.



- Reabilitimin e vendeve të pa autorizuar të vendeve të grumbullimit të mbetjeve.
- Transportin e largimin e mbetjeve urbane.
- Depozitimn e trajtimin e mbetjeve në Landfill.

Këto plane duhet të hartohen dhe të mbështeten nga udhëzimet dhe standartet e vendosura si dhe nga metodologjia që mundëson zbatimin e tyre me efektivitet.

Rreth metodologjisë:

- Objektivat dhe përfitimet prej metodologjisë:  
Metodologjia mund të shërbejë si një instrument ndihmës për Njësitë e Qeverisjes Vendore të cilat duhet të analizojnë:
  - Gjendjen ekzistuese të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane.
  - Të identifikojë dhe vlerësojë metodologjitë dhe opsionet.
  - Të përcaktojnë kostot dhe nevojat financiare.
  - Të hartojë rregullore dhe të organizojë shërbimet nga faza parë fshirje dhe pastrim, gjenerimi, grumbullimi e deri tek depozitimi e trajtimi në landfill.
- Grupet e adresuara:  
Manualet, udhëzimet dhe metodologjia duhet të përdoren nga:
  - Departamentet kompetente dhe zyrtarët lokale brenda qeverisjes vendore.
  - Ekspertët që do të përfshihen në procesin e përgatitjes së planeve të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane.
  - Autoritetet e tjera Vendore që luajnë një rol në planifikimin dhe zbatimin e planeve të Menaxhimit të mbetjeve.
  - Agjensitë Rajonale të Mjedisit.
- Si të përdorim këtë manual:  
Metodologjia, zhvillohet dhe është e organizuar në këto seksione:
  - E para: Prezanton:
    - Një vështrim të përgjithshëm të situatës së menaxhimit të mbetjeve.
    - Konsistimin e një Plan - Menaxhimi të Mbetjeve në kontekstin ligjor e strategjik.
  - E dyta: Prezanton:
    - Proçeset e zhvillimit të Planit të Menaxhimit të Mbetjeve
    - Aspektet e metodologjisë dhe hapat bazë të planifikimit
  - E treta : Fokusohet në :
    - Në çështjet e planifikimit menaxherial dhe teknik
    - Hapat për planifikimin e shërbimeve.
  - E katërta : Adreson :
    - Problemet financiare të planifikimit.
    - Udhëzon për përmirësimin e praktikave financiare.
    - Llogaritjet e kostos buxhetin, investimet e të ardhurat.
  - E pesta : Ofron:
    - Elementet të tjerë shtesë për seksionet 2, 3, 4.
    - Organizimin e strukturave organizative.

## KREU II

### Hapat për zhvillimin e Planit - Vendor

#### Proçesi i Planifikimit të Menaxhimit të Mbetjeve


- Hapat bazë të planifikimit:  
Plani - Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane në tërësinë ë tij është një proçes që funksionon me cikle dhe përbëhet nga:
  - Planifikimi.
  - Zbatimi.
  - Rishikimi i planit.

Plani duhet të rishikohet rregullisht një herë në 5 vjet

I gjithë proçesi i Planifikimit të Menaxhimit të Mbetjeve është i vazhdueshem, për pasojë duhet të funksionojë me cikle dhe duhet të përbëhet nga disa nën - proçese si:

Skema e Proçesit të Planifikimit të Menaxhimit të Mbetjeve

Tabela Nr. 1



Hapi I:

- Krijimi i strukturave organizative:  
Ky proces është hapi i parë dhe shërben si bazë për fazat e planifikimit dhe zbatimit ku në fillim përcaktohen fazat:
  - Përcakton aktorët kryesorë që duhet të përfshihen në procesin e planifikimit.
  - Përfshirjen e palëve të interesuara (grupet e interesit) që ndikojnë drejtpërdrejt nga plani i menaxhimit të mbetjeve.
  - Përcaktimi i roleve dhe përgjegjësi organizative.

Hapi II:

- Vlerësimi i gjëndjes ekzistuese:  
Qëllimi i këtij seksioni është të ofrojë një pamje të përgjithshme dhe të hollësishme të kontekstit vendor për menaxhimin e mbetjeve nga ku përcaktojmë:
  - Njohja e profilizimi i gjeneruesëve dhe zonat e mbetjeve urbane.
  - Njohja e sistemit aktual të menaxhimit të mbetjeve dhe elementeve të tij.
  - Vlerësimi

Hapi III:

- Planifikimi Operacional i menaxhimit të mbetjeve  
Ky proces planifikimi organizohet në bazë të kërkesave që rrjedhin nga analizimi i gjëndjes ekzistuese për projektimin e zhvillimeve e për të ardhmen në këtë sektor, ku përfshihen:
  - Identifikimi i nevojave dhe përparësive për përmirësimin e shërbimeve,
  - Komunikimi me vendimarrësit, menaxheret dhe publikun.
  - Përcaktimi i qëllimeve dhe objektivave.
  - Planifikimi teknik.

Hapi IV :

- Planifikimi financiar i menaxhimit të mbetjeve.  
Pasi është zhvilluar metodologjia për organizimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve, është mjaft e rëndësishme planifikimi dhe zhvillimi financiar të cilat janë kostot e investimeve dhe kostove operacionale

Hapi V :

- Zbatimi i planit:  
Pas miratimit të planit të menaxhimit të mbetjeve, ndërtohet një plan - veprimi i cili përcakton:
  - Listën e Veprimeve.
  - Personat përgjegjës për çdo Veprim.
  - Kohën e përmbushjes së Veprimeve.
  - Zhvillimin e planit të zbatimit.
  - Zhvillimi i indikatorëve matës së performancës.
  - Ndërtimi i skemës së monitorimit.

Hapi VI :

- Rishikimi i Planit  
Vlerësimi i Planit të menaxhimit të mbetjeve, duhet të parashikojë hapat pasuese të mëtejshme, për të verifikuar nëse janë përmbushur objektivat.  
Proçesi i monitorimit dhe vlerësimit përbëhet nga:
  - Përcaktimi i punonjësve përgjegjës për procesin e monitorimit.
  - Vlerësimin e qëllimeve dhe objektivave.
  - Mbledhjen e të dhënave të nevojshme.



- Analizimi i të dhënave.
- Komunikimi dhe diskutimi mbi konstatimet e konkluzionet.
- Konteksti Kombëtare për menaxhimin e mbetjeve  
Ç'do Njësi e Qeverisjes Vendore duhet të hartojë një strukturë në mënyrë individuale dhe në varësi të diversitetit të faktorëve dhe kushteve të tyre.  
Ndër elementet kryesore të strukturës së përmbajtjes të një Plani-Vendor për menaxhimin e mbetjeve janë:
  - Qëllimi i Planit-Vendor.
  - Kuadri Kombëtar për menaxhimin e mbetjeve.
  - Kuadri kombëtar i politikave dhe legjislacionit.
  - Rolet dhe përgjegjësitë në nivel rajonal dhe vendor.
- Konteksti Vendor
  - Profili i qytetit.
  - Organizimi i menaxhimit të mbetjeve.
  - Sasitë e mbetjeve dhe karakteristikat, burimet dhe parashikimet.
  - Shërbimet aktuale të mbetjeve (objektet, mjetet, personeli, etj).
  - Ekonomia dhe financimi, procedurat e tarifave dhe vjelja e tyre.
  - Vlerësimi.
- Planifikimi i menaxhimit të mbetjeve
  - Fokusi i planit.
  - Planifikimi strategjik.
  - Identifikimi dhe shqyrtimi i alternativave.
  - Identifikimi dhe vlerësimi i skenarëve.
  - Perspektivat financiare, tarifat dhe rikuperimi i kostos.
  - Kuadri ligjor, rregullator dhe institucional.
  - Ndërgjegjësimi publik.

### **KREU III**

#### **Planifikimi operacional i Menaxhimit të mbetjeve:**

##### **1. Organizimi i Shërbimeve dhe operacioneve të Menaxhimit të Mbetjeve:**

Planifikimi operacional duhet të hartohet për të përmissuar ose krijuar një sistem të ri për menaxhimin e mbetjeve në mënyrë të qëndrueshme dhe efektive.

Pra konsiston në krijimin e procedurave të planifikimit për sa i përket aspekteve teknike. si:

- Organizimi i shërbimeve dhe operacioneve:

Autoriteti vendor, ka për detyrë të mundësojë ofrimin e shërbimit të pastrimit, grumbullimit riciklimit dhe depozitimit të mbetjeve urbane, të cilat përfshihen në këto kategori:

- Organizim nga vetë Institucioni ( sipërmarrje publike ).
- Organizim i deleguar i kryerjes së shërbimit ( sipërmarrje private ).
- Organizim i përbashkët i shërbimit ( publik - publik ).
- Organizim i përbashkët ( publik - privat ).

Gjatë procesit të marrjes së një vendimi duhet të merren në konsideratë këto të dhëna:

##### **a - Përzgjedhja midis alternativave (publike ose private)**

Konsideratat e të dhënave do të ndihmojnë Bashkinë për të vendosur se si të përfshijnë sektorin privat apo të lejojnë konkurrencen midis sektorit publik. Të gjitha këto shtjellohen nga analizat e elementëve të mëposhtëm:

- Popullsia e Njësisë Administrative dhe Efienca e Shërbimeve
- Konkurenca
- Teknologjia dhe kualifikimi i personelit



- Rreziqet dhe siguria.
- b - Si të përmirësohet organizimi publik i shërbimeve:  
Autoritetet vendore duhet të planifikojnë masat e duhura për përmirësimin e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve si:
  - Mbështetje e jashtme për investime.
  - Struktura dhe personeli.
  - Komercializmi i operacioneve të sektorit publik.
  - Kontrolli i shërbimeve.
- c - Përmirësimi i organizimit Privat për kryerjen e shërbimeve:  
Përpjekjet dhe burimet duhet të përqëndrohen drejt monitorimit dhe kontrolleve të shërbimeve, si:
  - Kërkesës së llogarisë.
  - Transparencës.
  - Afatet e përshtatshme për marrëveshjet.
  - Të garantohet besueshmëria dhe të ulen rreziqet.
  - Të sigurohet cilësia e shërbimit.
  - Të përzgjidhet tipi i duhur i kontratës sipërmarrëse.
- d. - Bashkëpunimi ndërvendor dhe organizimi rajonal  
Ka disa mënyra për të formalizuar një organizim ndërvendor për menaxhmin e mbetjeve, duke krijuar një organizim të përbashkët  
Një marrëveshje e përbashkët përbëhet nga:
  - Qëllimi dhe funksionet që do të realizohen bashkërisht.
  - Metodat dhe mënyrat që do të përdoren.
  - Proçesi i organizimit për marrjen e vendimeve dhe delegimin e kompetencave.
  - Në bazë të kësaj marrëveshje autoritetet mund të përcaktojnë:
  - Personat përgjegjës nga secili autoritet i qeverisjes vendore.
  - Proçedurat për prokurim, nënshkrimin e kontratës dhe mbikqyrjen e saj.
  - Përfitimet dhe detyrimet që rrjedhin nga kontrata.

## 2. Sistemet e Grumbullimit dhe transportit të Mbetjeve:

Duke ju referuar situatave aktuale, grumbullimi, transportimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane zë pjesën më të madhe të kostos së përgjithshme të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane.

Elementet më të rëndësishme për t'u marrë parasysh në Planifikimin e Sistemit të Grumbullimit të Mbetjeve Urbane janë:

- a. Të dhëna teknike dhe informacioni i përgjithshëm për zonat e shërbimit.
  - Autoriteti vendor duhet të mbledhi informacione të detajuara mbi të cilat do të planifikojë e të analizojë, nga ku të marrin vendimet bazë për përcaktimin e elementeve kryesore të skemës.
  - Informacionet duhet të përmbajnë :
    - a) Karakteristikat e zonave ku gjenerohen mbetje urbane.
    - b) Sasia e norma e gjenerimit të mbetjeve dhe përbërja e tyre.
- b. Skemat e grumbullimit, transportit e largimit të mbetjeve urbane.  
Komponentët e këtij elementi kanë të bëjnë me fillimin e kryerjes së shërbimit nga ku të përmirësohet shërbimet aktuale si:
  - Përcaktimi i Vend - Grumbullimeve të mbetjeve urbane.
  - Përcaktimi i numrit të konteneireve të mbetjeve.
  - Përcaktimi i numrit të mjeteve teknologjike dhe të thjeshta.
  - Burimet Njerëzore.
- c. Skema e ndarjes së mbetjeve.



Ndarja e mbetjeve është një element i rëndësishëm gjatë planifikimit të sistemit të grumbullimit.

Planifikimi dhe zhvillimi i skemave për ndarjen e mbetjeve duhet të bazohet në këto faktorë:

- Sa e rëndësishme është ndarja e mbetjeve në prioritetet vendore?
- Ç'farë mbetjesh, sa mbetje, cila është përbërja e tyre dhe ku janë sasi të duhura?
- Cilat janë skemat e përshtatshme dhe efektive që përshtaten me realitetin vendor?

Të gjithë elementët e mësipërm duhet detyrimisht të zgjidhin çështje si:

- Mbrojtjen e shëndetit të komunitetit dhe të mjedisit.
- Reduktimin e vëllimit të mbetjeve urbane.
- Reduktimin e kostos së Menaxhimit të Mbetjeve.
- Ç'farë mbetjesh duhen ndarë dhe a ka interes për to.
- Madhësinë e projekteve të skemave të grumbullimit.
- Përcaktimi i metodologjisë së përshtatshme në nivel vendor.

### 3. Trajtimi i Mbetjeve Urbane.

Kërkesa për minimizimin e mbetjeve urbane nuk lidhet vetëm me përmbushjen e objektivave kombëtare; por është mënyra e vetme për të ulur barrën financiare të shkaktuar nga rritja e tarifave për trajtimin dhe grosposjen e mbetjeve në Landfill.

#### a. Riciklimi:

Detyra e autoriteve vendore është:

- Të krijojnë një mjedis të favorshëm për zhvillimin e këtij procesi.
- Të krijojnë dhe zbatojnë skemat e ndarjes së mbetjeve.
- Të nxisë investimet e biznesit të riciklimit.
- Të rrisë ndërgjegjësimin publik dhe edukimin e komunitetit për parandalimin e mbetjeve me metodat e ripërdorimit, riciklimit e kompostimit.

#### b. Kompostimi:

Aktualisht janë zhvilluar disa metodologji për kompostimin e mbetjeve, por kompostimi në shtëpi (në zonat rurale), përbën një nga metodat më të mundshme dhe të realizueshme, në sajë të thjeshtësisë dhe kostove të ulta që kanë.

Për një Njësi Administrative në zonat rurale alternativa më e mirë do të ishte inkurajimi i bujqëve për kompostimin e mbetjeve në nivel familje apo fshati.

Planifikimi dhe ngritja e një impianti për kompostimin e mbetjeve në nivel familje apo fshati duhet të marrë në konsideratë:

- Vendi. Duhet të jetë pranë zonës së banimit për të ulur koston e transportit.
- Kushtet specifike. Normalisht duhet të vendosen në një mjedis të hapur nga ku mund të mbulohen për shkak të kushteve klimaterike apo për të parandaluar erën e keqe.
- Koha e nevojshme. Plehu është gati pas një periudhe 6 deri në 8 muaj.
- Koeficienti. Normalisht materiale hyrëse konsistojnë në rreth 90% të rrymave të mbetjeve.
- Produktiviteti i metodës. Plehu i përgatitur përbën 40 % të masës së mëparshme. Nga kjo masë vetëm 5 % shkon në Landfill.
- Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve në Landfill.

Për të zhvilluar dhe progresuar menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane, fillimisht duhet të ndjekim si hap të parë:

Kalimin nga depozitimi i mbetjeve në vend-grumbullime të paligjshme e të pakontrolluara drejt Landfilleve sanitare të cilat plotësojnë të gjitha standartet e kërkuara.

Në zbatim të politikave Kombëtare për menaxhimin e mbetjeve, autoritetet vendore duhet të përfshijnë në Planet e tyre të menaxhimit këto masa:

- Mbyllja e vend - grumbullimeve aktuale.



- Rehabilitimin e vend - grumbullimeve aktuale.
- Projektimi dhe menaxhimi i një Landfilli sanitar.

#### 4. Skenarët e Menaxhimit të Mbetjeve Urbane


- Identifikimi dhe Vlerësimi i Skenarëve

Në kuadër të identifikimit dhe vlerësimit të alternativave të mundshme për secilin element të menaxhimit të mbetjeve ne duhet të analizojmë në rradhë të parë faktorët që ndikojnë si:

- Aspektet ekonomike
- Mjedisore
- Fizibiliteti
- Pranueshmëria shoqërore

Ilustrimi i skenarit të Menaxhimit të Mbetjeve

##### Skemë Nr.1



Vlerësimi i skenarëve konsiston në:

- Vlerësimi i sistemeve.
- Alternativave.
- Metodologjive.
- Skemave.

nga të cilat lindin dhe parametrat vlerësuese të cilat do të përcaktohen nga autoriteti vendor bazuar në këto kriteret:

- Përputhshmëria me rregullat dhe standartet kombëtare dhe vendore.
- Hierarkia e prioriteteve të kërkuara nga komuniteti.
- Hierarkia e prioriteteve të shprehura nga autoriteti vendor.
- Kosto vjetore, kosto totale për banor në vit dhe kosto për investime.

- Pastrimi i rrugëve.

##### a. Planifikimi

Të gjitha operacionet zinxhir të menaxhimit të mbetjeve urbane fillojnë nga proceset e pastrimit të qytetit, dhe vazhdojnë me grumbullimin e transportimin e mbetjeve.

Pastrimi i rrugëve është një nga shërbimet më të rëndësishme publike.

Brenda këtij shërbimi përfshihen këto operacione:

1. Fshirja e rrugëve
  - Në mënyrë manuale ( me fshesarë ).
  - Në mënyrë mekanike ( me autofshesë ).
2. Trajtimi i rrugëve me detergjente
  - Larje e gjithë sipërfaqes së rrugës.
  - Freskimi i rrugëve.





3. Mirëmbajtja e rrugëve

- Mirëmbajtje e plotë ( pastrimi i kuletave ).
- Mirëmbajtje e pjesëshme.

4. Larja dhe dezenfektimi i kontenierëve të mbetjeve urbane.

Pastrimi i rrugëve lidhet drejtëpërdrejt me sistemin e grumbullimit dhe transportin e mbetjeve.

Kordinimi midis shërbimit të pastrimit dhe atij të grumbullimit duhet të marrë në konsideratë këto elementë të rëndësishëm të organizimit:

- Kush do të jenë përgjegjës për pastrimin e infrastrukturës dhe sipërfaqeve urbane?
- Kush do të jenë përgjegjës për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve?
- Koordinimi i orareve të shërbimit.

Për organizimin dhe planifikimin e shërbimeve të pastrimit duhet të ndiqen këto hapa kryesore:

<u>HAPI I PARË</u>
Konsiston në :
- Identifikimin e rrugëve, trotuareve, shesheve dhe sipërfaqeve urbane
- Parametrave të rrugëve
- Vlerësimi i volumeve të punës

<u>HAPI I DYTË</u>
Konsiston në:
- Identifikimi i nevojave për shërbime pastrimi
- Frekuencat e grafikët e shërbimeve
- Vlerësimi i ndotjes nga veprimtaritë e komunitetit

<u>HAPI I TRETË</u>
Konsiston në :
- Përcaktimi i metodologjisë dhe indikatorëve matës për të siguruar cilësinë dhe efektivitetin e kostos
- Vlerësimi i rrugëve në të cilat ka parking apo jo
- Vlerësimi i ndotjes dhe aksesit në shërbim

Në bazë të vëzhgimeve dhe monitorimeve në terren, Njësitë e Qeverisjes Vendore, do të përcaktojnë:

- Frekuencat dhe oraret e shërbimit
- Kohën e kryerjes së shërbimit të fshirjes
- Orët e natës apo orët e ditës
- Grafikët e shërbimit të pastrimit në rrugët kryesore, periferi apo brenda lagjeve.
- Vlerësimi i ndotjeve për çdo rrugëve si dhe sjellja e banorëve.

Ndërsa klasifikimi i rrugëve sipas kategorive për përcaktimin e shërbimeve të nevojshme:

<u>KATEGORIA E PARË</u>
<u>Përfshin :</u>
- Rrugët kryesore të mbushura me njësi tregtare
- Rrugë me qarkullim të dendur mjetesh e këmbësor
<u>Kërkohet:</u>
- Fshirje manuale apo mekanike
- Mirëmbajtje e plotë dhe e pjesëshme
- Larje dhe freskim të rrugëve
- Larje dhe dezenfektim të konteniereve
- Kompletimi me konteniere të mbetjeve urbane
- Frekuenca shërbimit për çdo ditë
<u>KATEGORIA E TRETË</u>
<u>Përfshin :</u>
- Rrugët dytësore
- Rrugët brenda lagjeve
<u>Kërkohet:</u>
- Fshirje manuale
- Mirëmbajtje e plotë dhe e pjesëshme
- Frekuenca shërbimit për 1 ditë në javë

<u>KATEGORIA E DYTË</u>
<u>Përfshin :</u>
- Rrugë kryesore me veprimtari të pakët tregtare dhe më pak qarkullim të këmbësorëve
<u>Kërkohet:</u>
- Fshirje manuale apo mekanike
- Mirëmbajtje e pjesëshme
- Larje dhe dezenfektim të konteniereve
- Kompletimi me konteniere të mbetjeve urbane
- Frekuenca shërbimit për 3 ditë në javë
<u>KATEGORIA E KATËRT</u>
<u>Përfshin :</u>
- Rrugët periferike
- Rrugët brenda lagjeve por në gjëndje të dëmtuar dhe të pa shtruara
<u>Kërkohet:</u>
- Mirëmbajtje e pjesëshme
- Frekuenca shërbimit për 2 ditë në javë

b. Rekomandimi për përdorimin e metodave të përshtatshme:

Aktualisht, metoda e fshirjes manuale ( fshirje me krah ) është më e përshtatshme për kontekstin shqiptar. Argumenti:

- Realizimi i shërbimit të pastrimit të fshirjes me autofshesë është i papërshtatshëm pasi në shumicën e rrugëve kemi bllokim, si pasojë e parkimit të automjeteve.
- Së dyti; kjo metodë kërkon shpenzime të larta, kostot e të cilave nuk përballohen nga buxhetet vendore për pastrimet e qytetit.

## Planifikimi Financiar i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve

- Financimi Vendor aktual i menaxhimit të mbetjeve.
- Perspektiva e tij.

Në kuadër të projektit “Mbështetje Bashkisë Elbasan në sektorin e menaxhimit të mbetjeve”, pjesë e Programit të Decentralizimit dhe Zhvillimit Lokal (dldp), Bashkia Elbasan mundësoi hartimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane.

Ata ishin pjesë e zhvillimit të Planit që në fillimet e tij duke rishikuar dhe përzgjedhur opsionet që janë ekonomikisht të mundshme me buxhetin që ka në dispozicion Bashkia, dhe të pranueshme nga ana mjedisore me ndikimet minimale në mjedis dhe në përputhje me politikat dhe legjislacionin mjedisor në fuqi.

Çdo etapë e këtij plani, duke përfshirë prioritetet e Bashkisë, vizionin, objektivat, opsionet, investimet dhe afatet kohore u diskutuan dhe u ranë dakort gjatë takimeve të grupit të punës.

- Bashkia Elbasan ka një eksperiencë të gjatë në fushën e planifikimit të shërbimit të mbetjeve në sajë të mbështetjes të vazhdueshme teknike dhe asistencës që ka marrë nga programi i dldp-së me anë të financimeve të ndryshme, si në hartimin e planeve lokale të Njësisve Administrative që janë sot pjesë e Bashkisë, ( përpara reformës territoriale dhe administrative kur ishin NJQV si komuna ), ashtu edhe së fundmi në ngritjen e sistemit të monitorimit të shërbimit në qytetin e Elbasanit.
- Ky i fundit, një proces të cilin Bashkia me këmbënguljen dhe rolin e saj, dhe veçanërisht të Kryetarit për ta ngritur dhe zbatuar rigorozisht dhe me sukses në qytetin e Elbasanit si fillim, dhe më pas në Njësitë Administrative, ka shërbyer për grumbullimin dhe gjenerimin e të dhënave të nevojshme për bazat e një Planifikimi të Integruar të shërbimit.
- Në hapa të ndryshëm të hartimit të Planit-Vendor, grupi i punës organizoi seanca diskutimi dhe konsultimi me përfaqësuesit kryesorë të Bashkisë. Procesi i konsultimit, i cili çoi në punën e ngushtë midis aktorëve, duke rakorduar në ato që i nevojiten Bashkisë, duke ofruar mundësi për komente apo diskutime të ndryshme.
- Përfaqësuesit e Bashkisë Elbasan, kanë asistuar gjatë lëvizjeve në terren dhe kanë dhënë asistencën e tyre në lidhje me identifikimin e gjendjes ekzistuese të ofrimit të shërbimit në të gjithë territorin e Bashkisë së madhe.

Politikat kombëtare dhe principet bazë të menaxhimit të mbetjeve.

Strategjia Kombëtare e Mbetjeve dhe Plani Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve ka përcaktuar drejtimin e politikës së Qeverisë së Shqipërisë për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve deri në 2024, duke synuar:



- Minimizimin e impaktit të mbetjeve në mjedis në nivelin kombëtar dhe lokal si dhe përmirësimin e përdorimit eficient të burimeve në Shqipëri.
- Kjo strategji është krijuar duke u mbështetur në angazhimin financiar të Qeverisë Shqiptare për të transformuar statusin e vendit në lidhje me reduktimin e mbetjeve, riciklimin, kompostimin apo përpunimin me përfitim energjie.
- Ajo ka vendosur objektiva sfiduese dhe realiste njëkohësisht, të cilët synojnë mundësimin e ndryshimit rrënjësor të mënyrës së menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri.

Strategjia kombëtare e mbetjeve paracakton katër shtylla kryesore me qëllim zbatimin e politikës dhe strategjisë së mbetjeve nëpërmjet Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve (PKMM).

Këto shtylla politike janë thelbësore dhe shumë të rëndësishme për të garantuar qëndrueshmërinë dhe suksesin e të gjithë menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri. Shtyllat politike janë si në vazhdim:

**Planifikimi:**

Hapi i parë në zbatimin e procesit duhet të jetë zhvillimi i planeve për të çuar përpara axhendën e strategjisë dhe politikës së mbetjeve në lidhje me zbatimin;

**Edukimi:**

Partnerët, bashkëpunëtorët kryesorë të sistemit duhet të edukohen në mënyrë që të përmbushin potencialin e tyre brenda sistemit dhe të lehtësojnë zbatimin e reformave;

**Mbështetja financiare:**

Burimet njerëzore dhe vetë sistemi duhet të mbështeten financiarisht në mënyrën e duhur;

**Kuadri ligjor:**

Sistemi kërkon një paketë rregulloresh. Për më tepër, për të siguruar hyrjen në Bashkimin Evropian, vendi do të duhet të bëjë përafrimin me legjislacionin përkatës të Komitetit Evropian në fushën e mjedisit në vitet në vijim. Direktivat e BE-së dhe dokumentat strategjik, rekomandojnë që të gjithë planet në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal duhet të bazohen në parimet e përgjithshme të paraqitur më poshtë:

**1. Hierarkia e mbetjeve:**

Hierarkia e mbetjeve përfaqëson një nga parimet kryesore udhëzuese në menaxhimin e mbetjeve në BE. Hierarkia përshkruan një set të metodave prioritare në menaxhimin e mbetjeve duke vendosur “parandalimin, ripërdorimin” dhe depozitimin si alternativën më pak të favorshme.

**2. Parimi reduktues:**

Të sigurojë ruajtjen e burimeve natyrore, duke minimizuar sa më shumë të jetë e mundur gjenerimin e mbetjeve. Qëllimi kryesor në reduktimin e mbetjeve qëndron në domosdoshmërinë e ndërprerjes së lidhjes midis rritjes ekonomike dhe gjenerimit të tyre;

**3. Parimi parandalues:**

Të sigurojë reduktimin e impakteve nga mbetjet në shëndetin e njerëzve dhe të mjedisit, veçanërisht të reduktojë substancat e rrezikshme tek mbetjet.

**4. Parimi i afërsisë dhe vetëmjaftueshmërisë:**

Parimi i afërsisë dhe vetëmjaftueshmërisë kërkon që mbetjet të menaxhohen sa më afër vendit ku prodhohet. Politika e BE-së rekomandon që shtetet anëtare të merren vetë me mbetjet e tyre, duke shmangur eksportin në vende të tjera.

**5. Parimi i përgjegjësisë së prodhuesit apo ndotësit:**

Parimi “Ndotësi paguan” kërkon që prodhuesit e mbetjeve të mbulojnë koston e menaxhimit të mbetjeve që gjenerojnë. Kështu kostot mjedisore dhe kostoja e menaxhimit të mbetjeve në të gjitha proceset duhet të reflektohen në çmimin e produktit si dhe në tarifatat për ofrimin e shërbimit.



Objektivi është:

- Ofrimi i një sistemi të drejtë dhe dekurajues për prodhimin pa kriter të mbetjeve. Qeveria Shqiptare është e angazhuar në procesin e anëtarësimit të plotë në BE dhe për këtë qëllim, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është duke punuar drejt përafrimit dhe adoptimit të legjislacionit Shqiptar në përputhje me instrumentet legjislativë të BE-së.
- Progresi më i madh në fushën e mbetjeve është bërë në fushën e legjislacionit. Gjatë periudhës 2011-2016, legjislacioni Shqiptar për menaxhimin e mbetjeve është përmirësuar me ligje të reja, vendime dhe rregullore që reflektojnë në direktivat e BE-së dhe detyrimet nga Konventa e Baselit.

## Aspekte institucionale të Menaxhimit të Mbetjeve

### Organizimi në nivel qendror

Aktorët kryesorë përgjegjës, në nivel kombëtar, në fushën e menaxhimit të mbetjeve janë:

- Ministria e Turizimit dhe Mjedisit.
- Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë.
- Ministria e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale.
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Bazuar në legjislacionin mjedisor në fuqi:

- MTM: Është institucioni i specializuar dhe përgjegjësi kryesor për hartimin e politikës së menaxhimit të mbetjeve; hartimin e legjislacionit, udhëzuesve dhe rregulloreve si dhe zbatimin në nivel qendror me anë të dy autoriteteve të specializuara në varësi të saj: Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve (ISHMPU) dhe Agjensinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Agjensive Rajonale të Mjedisit (ARM).
- ISHMPU: Në zbatim të Ligjit nr. 10431, është përgjegjës dhe ushtron aktivitetin për garantimin e mbrojtjes së mjedisit në nivel qendror dhe për kontrollin dhe zbatimin e legjislacionit mjedisor (ku përfshihen edhe mbetjet) në të gjithë vendin për të gjithë konsumatorët që gjenerojnë mbetje. Ai vendos penalitete për shkeljet administrative apo mund të pezullojë aktivitete që nuk janë në përputhje me legjislacionin mjedisor; informon rregullisht autoritetet lokale për gjendjen e mjedisit, aktet ligjore të miratuara dhe projektet e miratuara; kontrollon regjistrin e ndotësve (ku përfshihen dhe mbetjet), rregulloret teknike dhe teknologjitë. ISHMPU bashkëpunon me autoritete të tjera në nivel qendror, rajonal dhe lokal (si p.sh. ARM, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor ISHSH, IKMT-ja, Policinë Bashkiake etj.) për përmbushjen e detyrave të këtyre të fundit.
- Agjensitë Rajonale të Mjedisit: Në zbatim të Ligjit nr. 10431 janë autoritete të specializuara për monitorimin dhe mbrojtjen e mjedisit në nivel rajonal dhe, bashkë me AKM-më si njësi qendrore, përbëjnë rrjetin e agjensive mjedisore. Ato kanë për detyrë: (i) të realizojnë zbatimin e ligjeve mjedisore dhe atyre të menaxhimit të mbetjeve në nivel lokal dhe rajonal; të bashkëpunojnë me autoritetet lokale në zhvillimin e aksioneve, planeve, projekteve apo fushatave të sensibilizimit në nivel lokal; kanë përgjegjësi në miratimin e vendeve të grumbullimit të mbetjeve dhe japin në bashkëpunim me autoritetet vendore, lejet mjedisore për impiantet lokale të mbetjeve apo aktivitete të tjera lokale.
- MIE
- Konkretisht Drejtoria e Politikave të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Mbetjeve të Ngurta:



Ka për detyrë formulimin dhe zbatimin e politikave kombëtare, normave dhe standardeve për shërbimet publike në fushën e mbetjeve urbane apo mbetjeve të tjera. MIE është autoriteti përgjegjës në nivel kombëtar për planifikimin, financimin, zbatimin dhe monitorimin e investimeve publike në fushën e menaxhimit të mbetjeve, rehabilitimit të fushave të vend-depozitimeve, ngritjes së Landfill-eve, etj. Në zbatim të kuadrit ligjor, ajo duhet të përgatisë rregullore, teknika dhe metoda për të gjitha proceset e menaxhimit të mbetjeve si: ndarja dhe grumbullimi i tyre, transporti dhe riciklimi, trajtimi dhe groposja etj.

Gjithashtu, MTI është autoriteti kontraktues për konçesionin e aktiviteteve ekonomike nën përgjegjësinë e saj, duke përfshirë fushën e shërbimeve publike ku bën pjesë edhe menaxhimi i mbetjeve.

- **Këshilli Kombëtar i Territorit:**

Në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, miraton lejen e sheshit dhe lejen e ndërtimit për objektet ( si rrjedhojë edhe për Landfill-etj ) me një sipërfaqe më të madhe se 0.5 ha që ndërtohen jashtë kufijve administrative të sipërfaqeve të qytetit/fshatit/zonave të banuara.

- **Ministria e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale:**

Në bashkëpunim me MTM dhe në zbatim të ligjit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve harton rregullore për menaxhimin e mbetjeve në nivele të ndryshme të hierarkisë së menaxhimit të tyre dhe gjithashtu harton dhe zbaton rregulloren për mbetjet spitalore ( miratuar Udhëzimi Nr. 6, dt. 30.11.2007 )

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor është një autoritet në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, i cili ka për detyrë të kontrollojë dhe ndërmarrë veprime për të siguruar kushtet e nevojshme higjeno-sanitare për aktivitetet e ndryshme.

Ai bashkëpunon me Inspektoriatet Mjedisore dhe në raste të veçanta, edhe me inspektoriate të tjera, sikurse edhe me autoritetet lokale për kryerjen e inspektimeve të aktiviteteve që lidhen me mbetjet. Aktiviteti i inspektoriatit mbështetet në ligjin 7904 datë 08.03.1995 dhe ka për detyrë të vendosë gjoba për probleme që lidhen me mos pastrimin e zonave urbane apo kur grumbullimi dhe depozitimi janë jo të përshatshëm dhe bëhen të rrezikshëm për popullsinë.

Përgjegjësia e inspektoratit shtrihet edhe në përcaktimin e vendgrumbullimit të mbetjeve. Spitalet dhe gjithë prodhuesit e mbetjeve spitalore janë përgjegjës për administrimin e mbetjeve spitalore si dhe për projektimin e skemave të menaxhimit të mbetjeve të tyre, në përputhje me Planet Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve dhe Planet e Menaxhimit të Mbetjeve të Rrezikshme. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ( në bashkëpunim me MTM ) është përgjegjëse për hartimin e rregulloreve për:

- Mbetjet industriale.
- Mbetjet minerale.
- Rehabilitimin e vend-depozitimeve në përputhje me specifikat.

- **Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural.**

Në bashkëpunim me MTM është përgjegjëse për hartimin e rregullores për mbetjet bujqësore dhe shtazore.

- **Ministria e Financës**

Në bashkëpunim me MM është përgjegjëse për hartimin e legjislacionit për paraqitjen e taksave të ndryshme mjedisore.

## Organizimi në nivel lokal



Detyrat dhe përgjegjësitë: Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” dhe ligjin nr.10463 datë 22.09.2011 Bashkitë janë përgjegjëse për të organizuar shërbimin e grumbullimit, transportit, trajtimit dhe depozitimit final të mbetjeve, duke i deleguar këto shërbime organeve lokale ose duke kontraktuar një kompani private të specializuar.

- Bashkia përcakton:
  - Strukturat Bashkiake për administrimin dhe monitorimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve si dhe inspektimin e territorit urban;
  - Përcakton buxhetin e mjaftueshëm për mbulimin e shpenzimeve operative dhe të investimeve në fushën e mbetjeve; vendos tarifa për menaxhimin e mbetjeve urbane në territorin nën juridiksionin e saj dhe autorizon organizmat publikë apo privatë që t’i grumbullojnë ato;
  - Harton dhe miraton rregullore lokale specifike territoriale për çdo metodë menaxhimi për mbetjet duke zbatuar rregulloret “tip” të miratuara nga MM, MTI dhe MSH;
  - Harton planet e menaxhimit të mbetjeve urbane në nivel lokal apo rajonal në bashkëpunim me autoritetet rajonale dhe autoritetet e tjera lokale fqinje;
  - Përcakton vendet dhe metodologjitë e përshtatshme për grumbullimin, trajtimin dhe depozitimin përfundimtar të mbetjeve në përputhje me kriteret mjedisore dhe planet e zhvillimit;
  - Mbledh të dhëna dhe mban regjistrin lokal të mbetjeve si dhe kryen fushata sensibilizuese.
- Në përputhje me legjislacionin mjedisor dhe për mbetjet.

Bashkitë kanë detyrimet si më poshtë:

1. Të kujdesen për higjenën publike kur kjo rrezikohet nga ndotja që shkaktohet prej mbetjeve të gjeneruara apo atyre të braktisura;
2. Të zbatojnë projekte dhe investime për përmirësimin e gjendjes së mjedisit urban në lidhje me ndotjen e mbetjeve;
3. Të monitorojnë dhe inspektojnë të gjitha proceset e menaxhimit të mbetjeve nga grumbullimi deri në depozitimin përfundimtar në përputhje me standardet kombëtare mjedisore dhe rregulloret dhe manualet lokale
4. Të inspektojnë “zotëruesin e mbetjeve” për të konfirmuar zbatimin e rregullave dhe standarteve në nivel kombëtar dhe lokal dhe të vendosë sanksione në rast shkeljesh;
5. Të bashkëpunojë me ARM për lëshimin e lejeve mjedisore për persona fizikë dhe juridikë që lidhen edhe me aktivitetin e tyre në raport me proceset e menaxhimit të mbetjeve;
6. Të bashkëpunojë me ISHMPU, ARM si dhe inspektoriate të tjerë për të ndërmarrë inspektime të mbetjeve dhe aktiviteteve që lidhen me to brenda territorit dhe juridiksionit lokal;
7. Çdo njësi e qeverisjes vendore është autoritet kontraktues për konçesionet lidhur me aktivitetet ekonomike nën juridiksionin përkatës dhe, si rrjedhojë, edhe për konçesionin e projekteve mbi mbetjet ( neni 5 i ligjit nr. 9663 ).

Këshilli Bashkiak:

Është autoriteti përfaqësues lokal me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për miratimin e buxhetit të mbetjeve dhe investimeve, miratimin e strukturave urbane për administrimin mbetjeve, miratimin e nivelit të tarifave të mbetjeve dhe miratimin e dokumenteve rregullatore dhe strategjike ( plane, plan-veprime ) dhe është i përfshirë në procesin e dhënies së lejes për një vend për mbetjet e rrezikshme ( Ligjit 9537 ).



Policia Bashkiake:

Eshtë përgjegjëse për të evidentuar dhe parandaluar ndotjen mjedisore dhe depozitimet e papërshtatshme të mbetjeve, dhe për të siguruar zbatimin e urdhërave, akteve lokale dhe vendimet në lidhje me menaxhimin e mbetjeve.

## Instrumentat për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve.

Plani Vendor i Planifikimit e Menaxhimit të Integruar të mbetjeve konsiston:

- Si instrumenti kryesor i planifikimit për përcaktimin e vizionit dhe objektivat specifike, të mundshëm nga ana ekonomike dhe mjedisore, në lidhje me drejtimet që do të ndërmerren Bashkia në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve.
- Këto objektiva specifike duhet të reflektojnë orientimet e politikës kombëtare drejt-menaxhimit të integruar të mbetjeve, të aktualizuara në gjendjen ekzistuese të Bashkisë.
- Mbi bazën e objektivave specifike të dakortësuar në të gjitha nivelet vendim-marrëse dhe me grupet e interesit, plani fillon dhe analizon skenarët e mundshëm të organizimit të shërbimit të shoqëruar me koston përkatëse dhe politikën fiskale që duhet të ndjekë Bashkia në mbulimin e plotë të koston.
- Ai përfundon me një plan veprimi konkret të ndarë në afate kohore, brenda një 5 vjeçari, sipas përgjegjësi përkatëse të aktorëve të përfshirë në zbatimin e planit.
- Plani është një dokument planifikimi, i cili merr fuqi të plotë me miratimin nga Këshilli Bashkiak.
- *Rregulloret Bashkiake për menaxhimin e mbetjeve:*
  - Për çdo rrymë specifike: është përgjegjësi e Bashkisë Elbasan të hartojë këto rregullore (duke zbatuar specifikat e ndarjes së re territoriale - administrative), e cila përcakton:
    - Metodologjitë dhe rregullat për shërbimet e pastrimit të qytetit dhe menaxhimit të mbetjeve për të gjitha rrymat specifike të mbetjeve, brenda territorit administrativ të Bashkisë duke hartuar procedurën për ankesat e banorëve.
    - Aplikimin e sanksioneve në rast të mos zbatimit të rregullores nga aktorë të ndryshëm. Rregullorja duhet të miratohet nga Këshilli Bashkiak për të marrë fuqi të plotë ligjore.
- *Rregulloret për llogaritjen e koston dhe tarifave për mbetjet:*

Në sajë të asistencës teknike nga programi dldp, Bashkia Elbasan ka qënë pjesë e shumë trajnimeve për aplikimin e modelit të llogaritjes së koston dhe tarifave të prezantuar nga programi dldp. Në këtë kuadër, nisur edhe nga fakti që shumë shpejt këto metodologji do të miratohen edhe në nivel kombëtar, për t'u përdorur zyrtarisht nga të 61 Bashkitë e vendit, Bashkia duhet të hartojë:

  - Rregulloret përkatëse në lidhje me rregullat dhe procedurat për llogaritjen e koston vjetore të shërbimit dhe nivelit të tarifave për konsumatorë të ndryshëm që janë pjesë e skemës, sipas modeleve të dldp-së.
  - Këto rregullore do të qartësojnë punën e stafit të financës dhe tarifave, të cilët në bashkëpunim me stafin teknik të menaxhimit të shërbimit, duhet të llogarisin koston vjetore dhe të përcaktojnë politikën fiskale, e cila i përshtatet më mirë nevojave të Bashkisë bazuar në konceptin e përballeshmërisë nga konsumatori, por edhe në drejtim të mbulimit të plotë të koston nga tarifat e pastrimit. Këto rregullore duhet të miratohen në Këshill Bashkiak.
- *Modeli i Sistemit të Monitorimit:*



Ky është një instrument të cilin Bashkia:

- Ka filluar të zbatohet për qytetin e Elbasanit, ku çdo ditë Administratorët, nga inspektorët e terrenit, përgjegjësit e shërbimit dhe përfaqësuesit e firmës private.
- Raportojnë në lidhje me gjendjen e VGM (a janë evaduar rregullisht apo jo) sipas formateve tashmë të hartuara dhe konsoliduar për Bashkinë Elbasan.
- Në këtë kuadër, Bashkia Elbasan duhet ta shtrijë modelin e monitorimit edhe në Njësitë e tjera Administrative, duke angazhuar edhe vetë Administratorët e këtyre Njësiteve apo stafin e tyre, që të jenë pjesë e procesit dhe të kryejnë raportimet ditore, javore dhe mujore tek qendra e Bashkisë.
- Në këtë mënyrë, Bashkia në sajë të ngritjes së sistemit të monitorimit në të gjithë territorin e saj do të kuptojë më mirë nivelin e ofrimit të shërbimit, elementet ku ajo duhet të ndërhyjë për të përmirësuar situatën, apo edhe të rishikojë objektivat specifike për zona, apo kategori të ndryshme të konsumatorëve.
- Me anë të këtij sistemi edhe sistemi i sanksioneve, kryesisht për firmat private që ofrojnë shërbimin, për bizneset apo edhe për konsumatorët familjarë mund të ekzekutohen lehtësisht.

• *Strategjia e informimit:*

Një instrument tjetër mjaft i rëndësishëm për zbatimin e suksesshëm të planit të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane.

- Bashkia duhet të sigurojë angazhimin e plotë të komunitetit duke i informuar ata në lidhje me skemën e menaxhimit të mbetjeve që po zbaton në territorin e Bashkisë dhe me politikën fiskale që ajo po aplikon.
- Bashkia duhet të hartojë një strategji informimi, që në hapat e parë të hartimit të planit, duke informuar komunitetin në lidhje me iniciativën që ajo ka ndërmarrë, objektivat e përcaktuara, skenarët që kërkon të aplikojë dhe politikën fiskale që Bashkia kërkon të ndjekë.
- Kjo strategji duhet të përcaktojë edhe etapa të tjera që duhet të përsëritën vit pas viti, ku synimi kryesor duhet të jetë informimi i komunitetit në lidhje me proceset që zhvillon Bashkia dhe marrja e opinionit të tyre në lidhje me performancën e shërbimit dhe sygjerimeve që ata mund të kenë.
- Zhvillimi i pyetësorëve të ndryshëm, apo i dëgjesave publike në periudha të ndryshme gjatë zbatimit të planit, janë disa nga elementet që strategjia e informimit duhet të parashikojë, për të matur opinionin qytetar, i cili duhet të reflektohet si në përmirësimin e shërbimit ashtu edhe në strategjinë e informimit.

## Përshkrimi i situatës së përgjithshme.

Profili i Bashkisë Karakteristikat sociale ekonomike.

- Bashkia Elbasan shtrihet në pjesën qendrore të Shqipërisë.
- Pas Reformës Administrative Territoriale, Bashkisë së vjetër i janë shtuar edhe 12 Njësi Administrative të tjera, kryesisht në zonat rurale.
- Siperfaqja e territorit të Bashkisë Elbasan është 872 km<sup>2</sup>, nga 8 km<sup>2</sup> që ishte para Reformës.
- Pra, sipërfaqja e territorit të Bashkisë është rritur përafërsisht 110 herë.
- Bashkia Elbasan shtrihet në pozicion mjaft strategjik nga ku kufizohet nga rrugë të rëndësishme kombëtare si :
  - Largësia nga Aeroporti "Nënë Tereza" është 63 km.
  - Nga Porti i Durrësit 83 km.
  - Nga pika kufitare e Qafë - Thanës 65 km.





- Dhe nga pika kufitare e Kapshticës 150 km.
- Nga pikepamja e mjedisit përshkohet nga lumenjt si Shkumbini, Manazderë, Zaranika, Papër dhe Gostimë.
- Zona industriale (ish Metarlugjiku) shtrihet përgjatë lumit Shkumbin dhe rrugës nacionale Elbasan-Rrogozhinë.
- Njëkohësisht në territorin e Bashkisë ndodhen dhe zonat turistike të mbrojtura si Sopoti, Stravaj dhe Kutomani.
- Duke qenë se shtrirja e territorit të Bashkisë është relativisht e madhe, ka larmi relievesh, e cila është kryesisht me karakter kodrinor - fushor.
- Bashkia Elbasan është qendra kryesore politike, ekonomike dhe kulturore e Shqipërisë së mesme.
- Në një udhëkryq mjaft të favorshëm kulturor me universitetin, bibliotekat, arkivat, kishat, xhamitë, muzetë, dhe me një ekosistem mjaft të larmishëm ( lumi Shkumbin dhe kurorat me ullishtë për rreth tij ), është në qendër të gadishullit të Ballkanit d.m.th qendër tranzit për tregun e Bashkimit Evropian ( me rrugë tokësore e hekurudhore ).
- Bashkia Elbasan manifeston të gjitha parakushtet e një zone të rëndësishme tregtare dhe tranziti, si dhe një qendër e rëndësishme ekonomike dhe industriale e Shqipërisë së mesme dhe e gjithë vendit.
- Ndër aktivitetet kryesore ekonomike në Bashkinë Elbasan përmendim zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorinë e cila është e zhvilluar në të gjithë territorin e Bashkisë.
- Vlen të përmendet, edhe pse në ritme jo të larta, në zonat periferike të qytetit të Elbasanit ka një sërë stabilimentesh me industrinë fasone.
- Turizmi, si aktivitet ndërsektoral, është i lidhur me shumë aktivitete ekonomike me ndikim të jashtëzakonshëm në sektorë të ndryshëm, duke ofruar shërbime të lidhura me kohën e lirë dhe me udhëtimet e biznesit.
- Ai luan një rol të madh në zhvillim, pasi kontribon në zhvillimin lokal, krijimin e vendeve të punës, zhvillimin e zonave në rënie industriale apo rurale, si dhe në rigjenerimin urban.
- Bashkia Elbasan, shtrihet në pjesën qendrore të Shqipërisë.
- Pas Reformës Administrative - Territoriale të miratuar në vitin 2014, Bashkisë së vjetër i janë bashkuar dhe 12 Njësi Administrative të zonave rurale (fshatrat).
- Aktualisht Bashkia Elbasan, përbëhet nga 13 Njësi Administrative respektivisht:
  - Njësia Administrative (Bashkia e vjetër Elbasan) me 6 (gjashtë) Nën - Njësi Administrative (bazuar në ndarjen të ish rajoneve te lagjeve).
  - Si dhe me 12 Njësi Administrative të zonave rurale ( me 116 fshatra ).

Të dhënat demografike e social-kulturore

Njësia Administrative e qytetit Elbasan ( ish Bashkia para Reformës ).

Me 6 ( gjashtë ) Lagje Administrative e pozicionuar nga qendra e Bashkisë, në pjesën verilindore kufizohet nga Kodra e Krastës dhe ajo e fshatit Godolesh, në jug nga lumi Shkumbin dhe në pjesën perëndimore nga ish uzina e Kombinatit Metalurgjik.

Tabela Nr. 1

	Lagjet	Shtrirja e siperfaqeve urbane per sherbime publike
--	--------	--



Nr	Administrative të qytetit	Pozicioni gjeografik	Te ndara sipas lagjeve në Gjendjen Civile	Nr. Familjeve
1	Lagjja I	Veri - lindje	"Kongresi Elbasanit"- "Luigj Gurakuqi" "Emin Matraxhiu" - "Beqir Dardha"	7470
2	Lagjja II	Jug	" Qemal Stafa"- " Çlirimi" - "Shënkoll" " Brigada 17" - "Sulë Papri"	7751
3	Lagjja III	Perëndim	" Syrja Dylgjeri" - "28 Nëntori" "Skënderbej" " Dyli Haxhire - Myzyri"	9208
4	Lagjja IV	Veri	" Kala" - "Partizani" - "Aqif Pasha" " Visarion Xhuvani"	7378
5	Lagjja V	Veri	" Vullnetari"- "Haxhias" - "11 Nëntori"	4133
6	Lagjja VI	Lindje	" 5 Maji"	7474

- Lagjja Administrative Nr. I.

Kjo Lagje Administrative është shtrirë në veri - lindje të qytetit dhe ka në përbërje të saj këto lagje:

1. Lagja: "Kongresi i Elbasanit"

- Shtrihet në veri - lindje të qytetit, dhe kufizohet nga Veri-Lindja me lagjen "5 Maji" nga jugu me lagjen "Luigj Gurakuqi" dhe në perëndim me lagjen "Aqif Pasha".
- Në përbërje të saj ka rrugë të kategorisë së parë dhe dytësore si rrugët : Një segment i rrugës "Tomorr Domi", "Ismail e Xhemali Debrova", "Çaush Asllani" e "Mahmud Biçaku", të cilat janë planifikuar në shërbimin e fshirjes dhe të mirëmbajtjes.
- Numri i popullsisë është rreth 4050 banorë, respektivisht me një numër familjesh rreth 1350. Referuar karakteristikave të kësaj zone të banuar dhe kërkesave të komunitetit për ofrimin e shërbimeve publike, krahas planifikimit për shërbimet e pastrimit janë vendosur konteniere për grumbullimin e mbetjeve urbane si dhe e planifikuar sipas skemës së transportit dhe largimit të mbetjeve në zonën veriore të qytetit.

2. Lagja: " Luigj Gurakuqi "

- Shtrihet në jug - lindje të qytetit, dhe kufizohet nga jug - lindja me lagjen " Emin Matraxhiu", nga jugu me lagjen " Beqir Dardha e Qemal Stafa' dhe në perëndim me lagjen " 28 Nëntori". Në shtrirjen e saj; ka rrugë të kategorisë së parë dhe dytësore si rruga : "Aqif Pasha", "Qemal Stafa", "Kamber Sejдини", "Lublin Dilja" të cilat janë planifikuar në shërbimin e fshirjes, mirëmbajtjes e të freskimit të rrugëve.
- Numri i popullsisë është rreth 6960 banorë, respektivisht me një numër familjesh rreth 2320. Referuar karakteristikave të kësaj zone të banuar, dhe kërkesave të komunitetit për ofrimin e shërbimeve publike, krahas planifikimit për shërbimet e pastrimit janë vendosur konteniere për grumbullimin e mbetjeve urbane si dhe e planifikuar sipas skemës së transportit dhe largimit të mbetjeve në zonën veriore të qytetit.

3. Lagja: " Emin Matraxhiu "

- Shtrihet në jug - lindje të qytetit, dhe kufizohet; lindje me malin e Krastës, në jug me lumin "Shkumbin", në veri me lagjen "5 Maj" dhe në perëndim me lagjen "Çlirimi".
- Në shtrirjen e saj ka rrugë të kategorisë kryesore dhe dytësore.
- Numri i popullsisë është rreth 7320 banorë, respektivisht me një numër familjesh rreth 2440. Referuar karakteristikave të kësaj zone të banuar, deri tani nuk janë planifikimet për shërbimet e pastrimit, por vetëm për transportimin e mbetjeve urbane.



- Për këtë qëllim janë vendosur konteniere për grumbullimin e mbetjeve urbane si dhe e planifikuar sipas skemës së transportit dhe largimit të mbetjeve në zonën jugore të qytetit.

4. Lagja: " Beqir Dardha "

- Shtrihet në jug - lindje të qytetit dhe kufizohet nga jugu me unazën jugore e lagjen " Emin Matraxhiu", në veri me lagjen "Luigj Gurakuqi" dhe në perëndim me lagjen "Qemal Stafa".
- Në shtrirjen e saj ka rrugë të kategorisë së parë dhe dytësore si rruga : "Qemal Stafa", "Borodin Mitarja", "28 Nentori", "Tomorr Sinani" të cilat janë planifikuar në shërbimin e fshirjes, mirëmbajtjes e të freskimit të rrugëve.
- Numri i popullsisë është rreth 4080 banorë, respektivisht me një numër familjesh rreth 1360. Referuar karakteristikave të kësaj zone të banuar dhe kërkesave të komunitetit për ofrimin e shërbimeve publike, krahas planifikimit për shërbimet e pastrimit janë vendosur konteniere për grumbullimin e mbetjeve urbane si dhe e planifikuar sipas skemës së transportit dhe largimit të mbetjeve në zonën jugore të qytetit.

- Lagja Administrative Nr. II.

Kjo Lagje Administrative është shtrirë në jug të qytetit dhe ka në juridiksionin e saj këto lagje:

1. Lagja "Qemal Stafa"

- Shtrihet në jug të qytetit, ku kufizohet në veri me lagjen "Luigj Gurakuqi", në lindje me lagjen "Baqir Dardha", në jug me unazën jugore dhe në jug-perëndim me lagjen "Çlirimi".
- Numri i popullsisë është rreth 3750 banorë, respektivisht me një numër familjesh rreth 1250. Referuar karakteristikave të kësaj zone të banuar dhe kërkesave të komunitetit për ofrimin e shërbimeve publike, krahas planifikimit për shërbimet e pastrimit janë vendosur konteniere për grumbullimin e mbetjeve urbane si dhe e planifikuar sipas skemës së transportit dhe largimit të mbetjeve në zonën jugore të qytetit.

2. Lagja: " Çlirimi "

- Shtrihet në jug të qytetit, ku kufizohet nga jugu me unazën jugore e me lagjen "Emin Matraxhiu", në veri me rrugën "Qemal Stafa" dhe në perëndim me rrugën "Thoma Kalefi".
- Në shtrirjen e saj ka rrugë të kategorisë së parë si rruga: "Qemal Stafa", "Thoma Kalefi" e "Sadik Metro" të cilat janë planifikuar në shërbimin e fshirjes, mirëmbajtjes e të freskimit të rrugëve.
- Numri i popullsisë është rreth 4860 banorë, respektivisht me një numër familjesh rreth 1560. Referuar karakteristikave të kësaj zone të banuar dhe kërkesave të komunitetit për ofrimin e shërbimeve publike, krahas planifikimit për shërbimet e pastrimit si dhe e planifikuar sipas skemës së transportit dhe largimit të mbetjeve në zonën jugore të qytetit, direkt nga shtëpitë e qytetarëve.

3. Lagja: " Shënkoll "

- Shtrihet në jug të qytetit, ku kufizohet nga jugu me lumin Shkumbin, në veri me unazën jugore dhe në perëndim me lagjen " Brigada 17 Sulmuese".
- Në shtrirjen e saj ka rrugë të kategorisë së parë dhe dytë; si rrugët "Thoma Kalefi", "Vasil Llapushi", "Babe Sherif Cani", "Balashe", "Aleks Vini" etj, të cilat janë planifikuar në shërbimin e fshirjes, mirëmbajtjes e të freskimit të rrugëve.
- Numri i popullsisë është rreth 6090 banorë, respektivisht me një numër familjesh rreth 2030. Referuar karakteristikave të kësaj zone të banuar, dhe kërkesave të



komunitetit për ofrimin e shërbimeve publike, krahas planifikimit për shërbimet e pastrimit, për grumbullimin e mbetjeve urbane si dhe e planifikuar sipas skemës së transportit dhe largimit të mbetjeve në zonën jugore të qytetit, me konteniere dhe direkt nga shtëpitë e qytetarëve.

4. Lagja: " Brigada 17 "

- Shtrihet në jug të qytetit, ku kufizohet nga jugu me unazën jugore e me lagjen "Shënkoll", në veri me rrugën "Qemal Stafa" dhe në perëndim me lagjen "Sulë-Papri".
- Në shtrirjen e saj ka rrugë të kategorisë së parë dhe dytësore si rruga: "Thoma Kalefi", "Unazën jugore", " Labinoti", të cilat janë planifikuar në shërbimin e fshirjes, mirëmbajtjes e të freskimit të rrugëve.
- Numri i popullsisë është rreth 3210 banorë, respektivisht me një numër familjesh rreth 1070. Referuar karakteristikave të kësaj zone të banuar, dhe kërkesave të komunitetit për ofrimin e shërbimeve publike, krahas planifikimit për shërbimet e pastrimit, për grumbullimin e mbetjeve urbane si dhe e planifikuar sipas skemes së transportit dhe largimit të mbetjeve në zonën jugore të qytetit, direkt nga shtëpitë e qytetarëve.

5. Lagja: " Sulë Papri "

- Shtrihet në jug të qytetit, ku kufizohet nga jugu me unazën jugore e me lagjen "Shënkoll", në veri me rrugën "25 Nentori" dhe në perëndim me lagjen "Syrja Dylgjeri".
- Në shtrirjen e saj ka rrugë të kategorisë së parë dhe dytësore si rruga : "25 Nëntori ", "Unazën jugore" të cilat janë planifikuar në shërbimin e fshirjes dhe të mirëmbajtjes e të freskimit të rrugëve.
- Numri i popullsisë është rreth 5523 banorë, respektivisht me një numër familjesh rreth 1841. Referuar karakteristikave të kësaj zone të banuar, dhe kërkesave të komunitetit për ofrimin e shërbimeve publike, krahas planifikimit për shërbimet e pastrimit, për grumbullimin e mbetjeve urbane si dhe e planifikuar sipas skemës së transportit dhe largimit të mbetjeve në zonën jugore të qytetit, me konteniere dhe direkt nga shtëpitë e qytetarëve.

- Lagja Administrative Nr. III.

Kjo Lagje Administrative është shtrirë në jug të qytetit e ka në përbërje këto lagje:

1. Lagjen " Syrja Dulgjeri"

- E cila shtrihet në pjesën jugore - perëndimore të qytetit dhe kufizohet, në lindje nga lagja "Sulë Papri", në jug me unazën jugore, në veri me rrugën "25 Nëntori" dhe në perëndim me lagjen "Skëndërbej".
- Numri i popullsisë është rreth 4050 banorë, respektivisht me një numër familjesh rreth 1350. Referuar karakteristikave të kësaj zone të banuar dhe kërkesave të komunitetit për ofrimin e shërbimeve publike, krahas planifikimit për shërbimet e pastrimit, për grumbullimin e mbetjeve urbane si dhe e planifikuar sipas skemës së transportit dhe largimit të mbetjeve në zonën jugore të qytetit, si me konteniere ashtu dhe direkt nga shtëpitë e qytetarëve.

2. Lagjen " Skëndërbej"

- E cila shtrihet në pjesën jugore - perëndimore të qytetit dhe kufizohet, në jug nga shtrati i lumit Shkumbin, në veri me unazën jugore, në lindje me lagjen "Shënkoll" dhe në jugperëndim me Nënstacionin 400 kv e me rrugën "25 Nëntori".
- Numri i popullsisë është rreth 7602 banorë, respektivisht me një numër familjesh rreth 2534. Referuar karakteristikave të kësaj zone të banuar, dhe kërkesave të komunitetit për ofrimin e shërbimeve publike, krahas planifikimit për shërbimet e pastrimit, për grumbullimin e mbetjeve urbane si dhe e planifikuar sipas skemës së

transportit dhe largimit të mbetjeve në zonën jugore të qytetit, me zbrazje të konteniereve.

### 3. Lagjen "28 Nëntori"

- E cila shtrihet në pjesën veriore të qytetit dhe kufizohet, në jug me rrugën "25 Nëntori" dhe autostradën e ish metalurgjisë, në lindje me rrugën "Lublin Dilja", në veri me bulevardin "Aqif Pasha" dhe në perëndim me Njësinë Administrative Bradashesh.
- Numri i popullsisë është rreth 8880 banorë, respektivisht me një numër familjesh rreth 2960. Referuar karakteristikave të kësaj zone të banuar dhe kërkesave të komunitetit për ofrimin e shërbimeve publike, në pjesën më të madhe të kësaj sipërfaqe nuk janë planifikuar shërbime pastrimi, por vetëm për grumbullimin e mbetjeve urbane si dhe e planifikuar sipas skemës së transportit dhe largimit të mbetjeve në zonën jugore të qytetit, si me konteniere ashtu dhe direkt nga shtëpitë e qytetarëve.

### 4. Lagjen "Dyli Haxhire Myzyri"

- E cila shtrihet në pjesën veriore të qytetit dhe kufizohet, në jug me rrugën "Aqif Pasha" dhe "Kadri Hoxha", në lindje me lagjen "Kala", në veri me lagjen "Partizani" dhe në jug-perëndim me ullishtën e qytetit.
- Numri i popullsisë është rreth 7092 banorë, respektivisht me një numër familjesh rreth 2364. Referuar karakteristikave të kësaj zone të banuar dhe kërkesave të komunitetit për ofrimin e shërbimeve publike, në pjesën më të madhe të kësaj sipërfaqe nuk janë planifikuar shërbime pastrimi për vetë infrastrukturën e kësaj zone, por vetëm për grumbullimin e mbetjeve urbane si dhe e planifikuar sipas skemës së transportit dhe largimit të mbetjeve në zonën veriore të qytetit, si me konteniere ashtu dhe direkt nga shtëpitë e qytetarëve.

### • Lagja Administrative Nr. IV

Kjo Lagje Administrative është shtrirë në jug të qytetit dhe ka në përbërjen e saj këto lagje:

#### 1. Lagjen "Partizani"

- E cila shtrihet në pjesën veriore të qytetit dhe kufizohet, në veri me lagjen "Vullnetari", në lindje me Lagjet "Visarion Xhuvani" e "Aqif Pasha", në jug me lagjen "Dyli Haxhire" dhe në perëndim me shtratin e përroit të Zaranikës.
- Numri i popullsisë është rreth 6282 banorë, respektivisht me një numër familjesh rreth 2094. Referuar karakteristikave të kësaj zone të banuar dhe kërkesave të komunitetit për ofrimin e shërbimeve publike, në pjesën më të madhe të kësaj sipërfaqe nuk janë planifikuar shërbime pastrimi, por vetëm për grumbullimin e mbetjeve urbane si dhe e planifikuar sipas skemës së transportit dhe largimit të mbetjeve në zonën jugore të qytetit, si me konteniere ashtu dhe direkt nga shtëpitë e qytetarëve.

#### 2. Lagjen "Kala"

- E cila shtrihet në pjesën veriore të qytetit dhe kufizohet, në veri me lagjen "Aqif Pasha", në lindje me rrugën "Rinia", në jug me bulevardin "Aqif Pasha" dhe në perëndim me rrugën "Janaq Kilica".
- Numri i popullsisë është rreth 1950 banorë, respektivisht me një numër familjesh rreth 650. Referuar karakteristikave të kësaj zone të banuar, dhe kërkesave të komunitetit për ofrimin e shërbimeve publike, nuk janë planifikuar shërbime pastrimi, por vetëm për grumbullimin e mbetjeve urbane si dhe e planifikuar sipas skemës së transportit dhe largimit të mbetjeve në zonën veriore të qytetit, direkt nga shtëpitë e qytetarëve.

#### 3. Lagjen "Aqif Pasha"





- E cila shtrihet në pjesën veriore të qytetit dhe kufizohet, në veri me lagjen "Visarion Xhuvani", në lindje me rrugën "Rinia", në jug me lagjen " Kala" dhe në perëndim me lagjen "Partizani".
- Numri i popullsisë është rreth 6972 banorë, respektivisht me një numër familjesh rreth 2324. Referuar karakteristikave të kësaj zone të banuar dhe kërkesave të komunitetit për ofrimin e shërbimeve publike, në pjesën më të madhe të kësaj sipërfaqe nuk janë planifikuar shërbime pastrimi, por vetëm për grumbullimin e mbetjeve urbane si dhe e planifikuar sipas skemës së transportit dhe largimit të mbetjeve në zonën veriore të qytetit, si me konteniere ashtu dhe direkt nga shtëpitë e qytetarëve.

#### 4. Lagjen "Visarion Xhuvani"

E cila shtrihet në pjesën veriore të qytetit dhe kufizohet, në veri me lagjen "Haxhias", në lindje me rrugën "Rinia", në jug me lagjen "Aqif Pasha" dhe në perëndim me lagjen "Partizani".

- Numri i popullsisë është rreth 6930 banorë, respektivisht me një numër familjesh rreth 2310. Referuar karakteristikave të kësaj zone të banuar dhe kërkesave të komunitetit për ofrimin e shërbimeve publike, në pjesën më të madhe të kësaj sipërfaqe janë planifikuar shërbime pastrimi, për grumbullimin e mbetjeve urbane si dhe e planifikuar sipas skemës së transportit dhe largimit të mbetjeve në zonën veriore të qytetit, si me konteniere ashtu dhe direkt nga shtëpitë e qytetarëve.

- Lagjja Administrative Nr. V.

Kjo Lagje Administrative është shtrirë në jug të qytetit e ka në përbërje këto lagje:

#### 1. Lagjen " Vullnetari"

- E cila shtrihet në pjesën veriore të qytetit dhe kufizohet, në veri me "kurorën e ullishtës", në lindje me lagjen "Haxhias", në jug me lagjen "Partizani" dhe në perëndim me shtratin e përroit të Zaranikës.
- Numri i popullsisë është rreth 2538 banorë, respektivisht me një numër familjesh rreth 846. Referuar karakteristikave të kësaj zone të banuar dhe kërkesave të komunitetit për ofrimin e shërbimeve publike, në pjesën më të madhe të kësaj sipërfaqe janë planifikuar shërbime pastrimi dhe për grumbullimin e mbetjeve urbane si dhe e planifikuar sipas skemës së transportit dhe largimit të mbetjeve në zonën veriore të qytetit, me konteniere.

#### 2. Lagjen " Haxhias"

- E cila shtrihet në pjesën veriore të qytetit dhe kufizohet, në veri me "kurorën e ullishtës", në lindje me kishën "Shën Thanasi", në jug me lagjen " Visarion Xhuvani", "11 Nëntori" dhe në perëndim me lagjen "Vullnetari".
- Numri i popullsisë është rreth 4620 banorë, respektivisht me një numër familjesh rreth 1540. Referuar karakteristikave të kësaj zone të banuar dhe kërkesave të komunitetit për ofrimin e shërbimeve publike, në pjesën më të madhe të kësaj sipërfaqe janë planifikuar shërbime pastrimi dhe për grumbullimin e mbetjeve urbane si dhe e planifikuar sipas skemës së transportit dhe largimit të mbetjeve në zonën veriore të qytetit, me konteniere dhe direkt nga shtëpitë e qytetarëve.

#### 3. Lagjen " 11 Nentori"

- E cila shtrihet në pjesën veriore të qytetit dhe kufizohet, në veri me lagjen "Haxhias" dhe "bllokun e spitaleve", në lindje me lagjen "5 Maji" e "11 Nëntori", në jug me rrugën "Ismail e Xhemali Debrova" dhe në perëndim me rrugën "28 Nëntori".
- Numri i popullsisë është rreth 5241 banorë, respektivisht me një numër familjesh rreth 1747. Referuar karakteristikave të kësaj zone të banuar dhe kërkesave të komunitetit për ofrimin e shërbimeve publike, në pjesën më të madhe të kësaj



sipërfaqe janë planifikuar shërbime pastrimi dhe për grumbullimin e mbetjeve urbane si dhe e planifikuar sipas skemës së transportit dhe largimit të mbetjeve në zonën veriore të qytetit, me konteniere dhe direkt nga shtëpitë e qytetarëve.

- Lagja Administrative Nr. VI.

Kjo Lagje Administrative është shtrirë në jug të qytetit, ka në përbërje këtë lagje:

1. Lagjen " 5 Maji"

- E cila shtrihet në pjesën veriore të qytetit dhe kufizohet, në veri me "kurorën e ullishtës", në lindje me Urën e Lizës", në jug me rrugën "Tomorr Domi" dhe "Sheferedin Biçakçiu" dhe në perëndim me lagjet "11 Nëntori" dhe "Kongresi Elbasanit".
- Numri i popullsisë është rreth 22 122 banorë, respektivisht me një numër familjesh rreth 7374. Referuar karakteristikave të kësaj zone të banuar dhe kërkesave të komunitetit për ofrimin e shërbimeve publike, në pjesën më të madhe të kësaj sipërfaqe nuk janë planifikuar shërbime pastrimi, por vetëm për grumbullimin e mbetjeve urbane si dhe e planifikuar sipas skemës së transportit dhe largimit të mbetjeve në zonën veriore të qytetit, me konteniere dhe direkt nga shtëpitë e qytetarëve.

Njësitet Administrative në zonat rurale

Tabela Nr. 2

Nr	Njësitet Administrative	Shtrirja e sipërfaqeve rurale për shërbime publike				
		Pozicioni Gjeografik	Sipërfaqe km <sup>2</sup>	Fshatrat	Distanca km	Nr. banorëve
1	Njësia Administrative Shushice	Veri - lindje	107	- Shushicë	9.8	11 342
				- Fush - Bull	18.2	
				- Hajdaran	4.4	
				- Mlizë	6.3	
				- Polisi - Vogël	11.4	
				- Polis - Vale	17.2	
				- Shelcan	12.3	
				- Vasjan	38.2	
2	Njësia Administrative Shirgjan	Jug	22	- Vreshtaj	4.2	10 585
				- Shirgjan	9.8	
				- Bathës	10.3	
				- Bujqës	7.5	
				- Jagodine	8.6	
				- Kryerzjarrth	7.8	
				- Kuqan	8.4	
3	Njësia Administrative Gjergjan	Jug	28	- Mjekës	6.4	8 049
				- Gjergjan	11.8	
				- Bujaras	19.3	
				- Gjonme	10.6	
				- Keshtjellë	13.3	
				- Koder Bujaras	17.5	
				- Muriqan	11.4	
- Thanë	17.7					



4	Njësia Administrative Tregan	Jug lindje	57	- Tregan	12.3	4606
				- Bizhdan	29.2	
				- Blerimas	24.8	
				- Çikallesh	19	
				- Gurishtë	17	
				- Kaçivel	28.7	
				- Kyçyk	15.2	
				- Muçan	16.5	
				- Shilbatër	19.8	
				- Shinavlash	24	
				- Trepshenisht	13.4	
				- Tudan	16.5	
5	Njësia Administrative Gjinar	Jug	89	- Gjinar	24	5 047
				- Derstile	21	
				- Kaferr	30.1	
				- Lukan	21.1	
				- Lleshan	15.8	
				- Maskarth	24.2	
				- Pashtresh	26.7	
				- Pobrat	17.2	
				- Stërstan	28.4	
				- Valesh	27.6	
- Xibresh	29.7					
6	Njësia Administrative Zavalin	Jug	101	- Zavalinë	36.2	1 914
				- Burrishtë	33.4	
				- Jeronishtë	40.1	
				- Kamiçan	39.6	
				- Nezhan	32.7	
- Selte	35.3					
7	Njësia Administrative Paper	Perendim	102	- Paper	14.4	9 341
				- Balldren	7	
				- Bizhuta	18	
				- Broshka	18.4	
				- Jatesh	10.8	
				- Lugaj	18.4	
				- Murrasi	17	
				- Pajuni	23	
				- Papër Sallak	27.3	
				- Ullishta	14	
				- Valasi	16.8	
				- Vidhasi	7.5	
- Vidhas Hasgjel	24.3					
				- Bradashesh	5.6	
				- Balëz lart	7	
				- Balëz poshtë	5	
				- Fikas	8.4	
				- Gurabardh	4.8	





8	Njësia Administrative Bradashesh	Perendim	56	- Karakullak	5	13155
				- Katundi Ri	4.2	
				- Kozan	11	
				- Kusarth	2.7	
				- Letan	10.3	
				- Petresh	12.3	
				- Reçan	8.2	
				- Rrilë	12.8	
				- Shënmëhill	11.2	
				- Shijon	6.6	
				- Shtëmaj	11	
				- Ulëm	12	
9	Njësia Administrative Gracen	Veri	57	- Gracen	20.4	2 497
				- Bodin	33.7	
				- Dopaj	27.1	
				- Gjormë	28.7	
				- Mamël	15.7	
				- Pajengë	21.2	
				- Plangaricë	29	
				- Shingjin	28	
				- Tërbaç	30	
10	Njësia Administrative Funar	Veri	77	- Branesh	18.8	3 063
				- Bixelle	16.2	
				- Cërruje	27.2	
				- Korrë	32	
				- Krrabë vogel	31	
				- Mollagjesh	25.6	
				- Preçe poshtë	19	
				- Preçe sipër	20	
- Stafaj	18.7					
11	Njësia Admin. Labinot Mal	Veri lindje	106	- Labinot Mal	24	5 764
				- Benë	34.3	
				- Dritas	38	
				- Guri Zi	18	
				- Lamollë	20	
				- Lugaxhi	29.4	
				- Qafë	24.8	
				- Qerret	22.8	
				- Sericë	17	
- Shmil	28					
12	Njësia Administr Labinot Fushe	Lindje	49	- Labinot-fushë	9.5	6 979
				- Godolesh	7.5	
				- Griqan poshtë	11.7	
				- Griqan sipër	14.2	
				- Mengel	4	
- Xibrakë	12.4					

1. Njësia Administrative Shushice:

- Shtrihet në pjesën juglindore të qytetit të Elbasanit në një distancë rrugor (nga qendra e Njesisë) 12 km.
- Kjo Njësi ka një shtrirje relativisht prej 107 km<sup>2</sup> dhe thuajse e gjithë kjo sipërfaqe është me relief fushor e kodrinor tokë bujqësore me vlera të mira prodhuese.
- Kjo Njësi kufizohet në veri me Njësinë e Labinotit - Fushë në jug me Njësinë Gjergjan dhe Tregan, në lindje me fshatin Polis dhe në perëndim me Njësine Shirgjan dhe qytetin e Elbasanit.

2. Njësia Administrative Shirgjan:

- Shtrihet në pjesën juglindore të qytetit të Elbasanit në një distancë rrugore nga qendra e Njesisë 10 km.
- Kjo Njësi ka një shtrirje relativisht prej 22 km<sup>2</sup> dhe thuajse e gjithë kjo sipërfaqe është me relief fushor tokë bujqësore me vlera të mira prodhuese.
- Kjo Njësi kufizohet në veri me Njësine Bradashesh, në jug me Njësinë Gjergjan dhe Tregan, në lindje me Njësinë Shushicë e Tregan dhe në perëndim me lumin Shkumbin.

3. Njësia Administrative Gjergjan:

- Shtrihet në pjesën jugore të qytetit të Elbasanit në një distancë rrugor (nga qendra e Njesisë) 13 km .
- Kjo Njësi ka një shtrirje relativisht prej 28 km<sup>2</sup> dhe thuajse e gjithë kjo sipërfaqe është me relief fushor e kodrinor tokë bujqësore me vlera të mira prodhuese.
- Kjo Njësi kufizohet në veri me lumin Shkumbin ne jug me Njësine Gostime, në lindje me Njësine Shirgjan dhe Tregan dhe në perëndim me Njësinë Cerrik.

4. Njësia Administrative Tregan:

- Shtrihet në pjesën juglindore të qytetit të Elbasanit në një distancë rrugore prej 20km larg.
- Kjo Njësi ka një shtrirje relativisht të madhe 57 km<sup>2</sup> dhe thuajse e gjithë kjo sipërfaqe është tokë bujqësore kodrinore - malore.
- Kjo Njësi kufizohet në veri me Njësinë Shushicë dhe Shirgjan ne jug Njësine Gramsh në lindje me Njësinë Gjinar dhe veriperëndim me Njësitet Shirgjan dhe Gjergjan.

5. Njësia Administrative Gjinar:

- Shtrihet në pjesën juglindore të qytetit të Elbasanit në një distancë rrugore prej 26 km larg.
- Kjo Njësi ka një shtrirje relativisht të madhe 89 km<sup>2</sup> dhe thuajse e gjithë kjo sipërfaqe është relief malore.
- Kjo Njësi kufizohet në veri me Njësinë Shushice, në jug Njësine e Gramsh në lindje me Njësinë Zavalinë dhe veriperëndim me Njësitet Tregan.

6. Njësia Administrative Zavaline:

- Shtrihet në pjesën juglindore të qytetit të Elbasanit në një distancë rrugore prej 40km larg.
- Kjo Njësi ka një shtrirje relativisht të madhe 101 km<sup>2</sup> dhe thuajse e gjithë kjo sipërfaqe është relief malore.
- Kjo Njësi kufizohet në veri me Njësitet Gjinar e Stravaj, në jug fshatin Poroçan në lindje me Njësine Stravaj dhe veriperëndim me Njësitet Gjinar, fshahti Pishaj (Gramash).



7. Njësia Administrative Bradashesh:

- Shtrihet në pjesën perindimore të qytetit të Elbasanit në një distancë rrugore prej 10km larg.
- Kjo Njësi ka një shtrirje relativisht të madhe 56 km<sup>2</sup> dhe thuajse e gjithë kjo sipërfaqe është reliev fushor e kodrinor.
- Kjo Njësi kufizohet në veri me Njësitë Gracen, Funar, në jug lumin Shkumbin në lindje me qytetin e Elbasanit dhe veriperëndim me Njësin Papër.

8. Njësia Administrative Papër:

- Shtrihet në pjesën perendimore të qytetit të Elbasanit në një distancë rrugore prej 18km larg.
- Kjo Njësi ka një shtrirje relativisht të madhe 102 km<sup>2</sup> dhe thuajse e gjithë kjo sipërfaqe është reliev fushor e kodrinor.
- Kjo Njësi kufizohet në veri me Njësitë Gracen e Funar, në jug me Bashkin e Cerrikut, në lindje me Njësinë Brdashesh dhe veriperëndim me Njësinë Pajovë.

9. Njësia Administrative Gracen:

- Shtrihet në pjesën veri-perndimore të qytetit të Elbasanit në një distancë rrugore prej 30 km.
- Kjo Njësi ka një shtrirje relativisht të madhe 57 km<sup>2</sup> dhe thuajse e gjithë kjo sipërfaqe është reliev malor.
- Kjo njësi kufizohet në veri me Njësite e Tiranës, në jug me Njësitë Paper e Bradashesh, në lindje me Njësinë Funar dhe veriperëndim me Njësite Pajove.

10. Njësia Administrative Funar:

- Shtrihet në pjesën veriore të qytetit të Elbasanit në një distancë rrugore prej 27 km larg.
- Kjo Njësi ka një shtrirje relativisht të madhe 77 km<sup>2</sup> dhe thuajse e gjithë kjo sipërfaqe është reliev malor.
- Kjo Njësi kufizohet në veri me Njësite e Tiranës, në jug me Njësinë Bradashesh në lindje me Njësinë Labinot - Mal, dhe veriperëndim me Njësite Gracen, Tirane.

11. Njësia Administrative Labinot - Mal:

- Shtrihet në pjesën veriore të qytetit të Elbasanit në një distancë rrugore prej 27 km larg.
- Kjo Njësi ka një shtrirje relativisht të madhe 77 km<sup>2</sup> dhe thuajse e gjithë kjo sipërfaqe është reliev malor.
- Kjo njësi kufizohet në veri me Njësite e Tiranës, në jug me Njësinë Bradashesh, në lindje me Njësitë e Librazhdit dhe veriperëndim me Njësite Funar e Njësite e Tiranës.

12. Njësia Administrative Labinot - Fush:

- Shtrihet në pjesën veriore-lindore të qytetit të Elbasanit në një distancë rrugore prej 5 km larg.
- Kjo Njësi ka një shtrirje relativisht të madhe 49 km<sup>2</sup> dhe thuajse e gjithë kjo sipërfaqe është bujqesore me reliev fushor.
- Kjo Njësi kufizohet në veri me Njësinë e Labinotit Mal, në jug me Njësinë Shushice, në lindje me fshatin Mirakë dhe veriperëndim me qytetin e Elbasanit.



## Aspekte Institucionale e teknike në Menaxhimin e mbetjeve në Bashkinë Elbasan:

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Elbasan, në të gjitha Njësitet Administrative ofrohet:

- Për Njësine Administrative te qytetit (të ndara sipas Njësive) nga kompani private të kontraktuara nga Bashkia dhe monitorohet dhe kontrollohet rregullisht nga stafi i Bashkisë.
- Për Njësitet Administrative të zonave rurale, menaxhimi kryhet nga vete këto Njësi në bashkëpunim me Agjensinë e Shërbimeve Publike pranë Bashkisë.

Funksionimi i Struktures në Bashki për Menaxhimin Mbetjeve:

- Kompanitë private (operatorët ekonomik) ofrojnë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në të gjithë territorin e Bashkisë (të qytetit) bazuar në kushtet e përcaktuara në kontratën e nëshkruar me Bashkinë.
- Në Njësine Administrative Elbasan (te qytetit) në 6 Njësi Administrative (ish Rajonet ku përfshihen të gjitha lagjet e qytetit) Bashkia kontrollon e monitoron kryerjen e shërbimit të pastrimit të qytetit nëpërmjet Mbikqyreseve (supervizorët) të ndare në dy zona kontrate (veri dhe jug) dhe raportojnë tek Përgjegjësi i Sektori dhe Drejtori i Shërbimeve Publike, Bashki.
- Për të qenë sa më reale dhe produktiv duhet të theksohet se në çdo Njësi Administrative duhet të vendoset një Inspektor (nga vetë Njësia) i cili monitoron ofrimin e shërbimit dhe raporton tek Mbikqyresi (supervizori) i zonës (veriore ose jugore), i cili më pas raporton tek përgjegjësi i sektorit dhe Drejtori i Shërbimeve Publike, Bashki.
- Përgjegjësi i sektorit së bashku me specialistin e sektorit, nën varësi të Drejtorit të Shërbimeve Publike dhe ndjekjes të Shërbimeve të Infrastrukturës, koordinojnë sistemin e menaxhimit të mbetjeve që nga hartimi i preventivave për kontratat, evidentimin e gjendjes ekzistuese të infrastrukturës dhe hartimin e raporteve përfundimtare të gjendjes së shërbimit.
- Edhe në Landfill Bashkia, duhet të vendosë një supervizorin e saj, i cili bën raportime të rregullta mujore në lidhje me ngarkesat e mbetjeve që vijnë në Landfill nga e gjithë Bashkia.
- Përgjegjësi i sektorit është personi kryesor në menaxhimin e sistemit, jo vetëm për Njësine Administrative Elbasan, por edhe për Njësitet e tjera, ku të gjithë administratorët raportojnë tek përgjegjësi në lidhje me situatën e ofrimit të shërbimit në territorin e tyre.  
Përgjegjësi i sektorit raporton tek Drejtori i Shërbimeve Publike për situatën e shërbimit në të gjithë territorin e Bashkisë, i cili më pas raporton në instancat vendim-marrëse të Bashkisë



## Aspekte teknike në menaxhimin e mbetjeve në Bashkinë Elbasan

- Pas Reformes Territoriale,për hartimine Planit - Vendor dhe për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve janë të ngarkuar :
  - Kryetari i Bashkisë
  - Sekretari i Përgjithshem
  - Zv/ Kryetari që mbulon Shërbimet Publike
  - Drejtori i Shërbimeve Infratrakturore.
  - Drejtori i Shërbimit të Territorit Urban
  - Përgjegjesi i Sektorit të Mjedisit
  - Mbikqyresit (supervizoret)
  - Inspektoret në Njësiti Administrative ( qytet e fshat)
  - Inspektori në Landfill
  - Operatori ekonomik ( kompanite private )
- Bashkia e madhe Elbasan,e përbërë nga 13 Njësi Administrative; nga ku:
  - Në zonat urbane të qytetit ( ish Bashkia ) menaxhohen 6 Nën - Njësi Administrative
  - Në zonat ruale menaxhohen 12 Njësi Administrative me rreth 116 fshatra, të cilat i dërgojnë mbetjet urbane në Landfillin ( dampa e ish TEC fshati Katundi Ri, Njësia Administrative Bradashesh ) që nga data 16.02.2016 e në vazhdim.
- Në Landfillin, Bashkia nuk ka pasë një punonjës të saj, i cili mban të dhënat në lidhje me të gjitha dërgesat që vijnë në Landfill nga të gjitha Njësiti Administrative të Bashkisë Elbasan.
- Njekohesisht në këtë periudhë kur mbetjet urbane depozitoheshin në Landfillin e ri, planifikimet dhe përlllogaritjet për analizën e kostos, janë kryer në baze të sasise së grumbulluar në konteniere ( në baze të procesit të zbrastjeve të kontenireve 660 cope x 125 kg/cope).
- Ndërsa për përlllogaritjet e sasisë së mbetjeve të gjeneruara ( grumbulluara ) direkt nga shtëpitë e qytetarëve janë bërë në baze të nurmit të familjeve ( banoreve ), në ato zona në të cilat ky shërbim nuk mund të realizohet me makina teknologjike, por sipas planifikimit ku janë përfshirë rreth 6900 familje të cilat gjenerojnë afro 18 ton mbetje në ditë.
- Nga këto të dhëna rezulton se; për çdo dërgesë mbetjesh urbane,të depozituar në Landfill nuk i është bërë peshimi ( detyruar nga kushtet e vëna nga Landfilli )
- Sipas të dhënave të raportuara nga Bashkia në tabelat e më poshtë tregohet; sasia e mbetjeve të gjeneruara kundrejt atyre të grumbulluara të cilat shkojnë në Landfillin për vitin 2016, 2017, 2018 për ato Njësi Administrative në të cilat ofrohej shërbimi.
- Në bazë të numrit të popullsisë dhe shtrirjes gjeografike në zonën e kontratës rezultojnë këto të dhëna mbi sasinë e gjeneruar:

## Vlerësimi i kostos së Plotë për Menaxhimin e Mbetjeve.

Për të vlerësuar koston e plotë të Menaxhimit të Mbetjeve, duhet të llogariten kostot reale që rezultojnë nga nevojat:

- Për shërbimet e mbetjeve.
- Për investimet e nevojshme.
- Dhe objektivat vendore për menaxhimin e mbetjeve.

Procedurat e vlerësimit të kostos së plotë të menaxhimit të mbetjeve përbëhet nga këto etapa:

- Faza përgatitore.
- Përcaktimi i investimeve.
- Llogaritja e kostos së menaxhimit të mbetjeve.



- Rishikimi dhe monitorimi .

Faza përgatitore.

1. Vlerësimi i të dhënave bazë

Ky informacion do të ndihmojë në:

- Përlllogaritjen e kostos.
- Vlerësimin e përgjithshëm të sasisë të mbetjeve të gjeneruara.
- Vlerësimin e të ardhurave të pritshme nga tarifat e mbetjeve.

Tabela Nr. 3

Nr.	Njësiti Administrative	Popullsia		
		Nr. Lagjeve	Nr. Familjeve	Nr. Banoreve
I	Qyteti			
	Lagjja 1	4	7 470	22 407
	Lagjja 2	4	7 751	23 253
	Lagjja 3	4	9 208	27 626
	Lagjja 4	4	7 378	22 136
	Lagjja 5	3	4 133	12 400
	Lagjja 6	1	7 374	22 122
	Shuma		<b>43 314</b>	<b>129 944</b>

Tabela Nr. 4

	Zonat rurale	Popullsia		
		Nr. Fshatra	Nr. Familje	Nr. Banore
II	Njësia Administrative Shushice	9	3 780	11 342
	Shirgjan	7	3 528	10 585
	Gjergjan	7	2 683	8 049
	Tregan	11	1 535	4 606
	Gjinar	11	1 682	5 047
	Zavaline	6	638	1 914
	Bradashesh	17	4 375	13 125
	Paper	13	3 113	9 341
	Gracen	9	832	2 497
	Funar	9	1 021	3 063
	Labinot - Mal	10	1921	5 764
	Labinot - Fushe	6	2 326	6 979
	Shuma	<b>116</b>	<b>27 450</b>	<b>82 342</b>



Për Bashkin e Elbasanit nga përllogaritjet e elementeve si më sipër, rezultojnë këto vlera të normës të gjenerimit e të grumbullimit të mbetjeve urbane .

Tabela Nr. 4

Nr	Emërtimet	Poullsia Regjistrimi Gjendje Civile		Nr. banorëve qe marrin shërbim		Norma Gjenerim (kg/bano)	Sasia mbetjeve të gjerneruar (ton/dite)	Sasia (ton/vit)
		Nr. Popullsi	Nr. familje	Nr. Popullsi	Nr. familje			
<b>Lagjet Administrative ne zona urbane (qytet)</b>								
1	Lagjja 1	22 410	7 470	20 678	6 892	0.870	18	6 570
	Lagjja 2	23 253	7 751	21 521	7 173		18.7	6 825
	Lagjja 3	27 624	9 208	25 892	8 630		22.5	8 212
	Lagjja 4	22 134	7 378	20 402	6 800		17.7	6 460
	Lagjja 5	12 400	4 133	10 668	3 556		9.2	3 358
	Lagjja 6	22 122	7 374	20 390	6 796		17.7	6 460
	Shuma	129 942	43 314	119 551	39 847		103.8	37 885
<b>Njësite Administrative në zonat rurale</b>								
2	Shushice	11 342	3 780	10 435	3 478	0.870	9	3 285
	Shirgjan	10 585	3 528	9 738	3 246		9.2	3 358
	Gjergjan	8 049	2 649	7 406	2 468		6.4	2 336
	Tregan	4 606	1 535	4 236	1 412		3.6	1 314
	Gjinar	5 047	1 682	4 644	1 548		4	1 460
	Zavaline	1 914	638	1 801	600		1.5	547
	Bradashesh	13 155	4 385	12 103	4 034		10.5	3 832
	Paper	9 341	3 113	8 604	2 868		7.5	2 737
	Gracen	2 497	832	2 297	765		2	730
	Funar	3063	1021	2 813	937		2.4	876
	Labinot Mal	5 764	1 921	5 204	1 734		4.5	1 642
	Labinot Fushe	6 979	2 326	6 421	2 140		5.5	2 007
Shuma	82 342	27 447	75 702	25 234		65.8	24 017	





Gjatë procesit të planifikimit për periudhen në fjalë ( deri në vitin 2017 ); Bashkia ka propozuar këto vlera të normës së gjenerimit, për shkak se ky shërbim është planifikuar të kryhet me procedurë ( operacion tjetër shërbimi ) duke përllogaritur sasinë e grumbullimit dhe të transportimit të mbetjeve për në Landfill me **zbrazje te konteniereve**. Pra:

- Nga përllogaritjet rezultojnë 660 copë x 125 kg/copë = 83 ton/dite
- Duke shtuar edhe sasinë e mbetjeve të grumbulluar direkt nga shtëpitë e qytetareve 18 ton në ditë, shuma totale e mbetjeve të gjeneruara në një ditë për vitin 2016 - 2017 - 2018 shkon në rreth 101 deri në 110 ton në ditë.
- Referuar metodologjisë dhe monitorimeve në terren; si dhe përllogaritjeve mbi sasinë e gjenerimit të mbetjeve rezultojnë:
  - Në bazë të numrit të popullsisë i cili ( ishte ) dhe është 129 902 banorë .
  - Duke zbritur numrin e banorëve të larguar jashtë dhe brenda vendit ( 8% ) = 10 392 banorë.
  - Numri real i banorëve të cilët kërkojnë shërbime publike është 119 510 banorë.
  - Duke shtuar edhe numrin e bizneseve dhe të institucioneve shtetërore e arsimore në rreth 4000 rezultojnë se sasia e gjeneruar e mbetjeve është e barabartë me sasinë të dërgura për çdo ditë në Landfill pas muajit Shkurt 2016, e përllogaritur kjo me metodologjinë e procesit me zbraze te konteniereve.
  - Edhe në rast se e konsiderojmë këtë metodologji në përllogaritjeve e sasisë së grumbulluar e transportuar të mbetjeve urbane, në kushtet aktuale të menaxhimit nuk mund të rezultojë se kjo sasi është e barabartë me sasinë e gjeneruar.
  - Nga kontrollet dhe monitorimet është fakt; që jo të gjitha sasia e mbetjeve të gjenerohen ( pra hidhen në VGM ) dërgohen të gjitha në Landfillin. Pse?
  - Në zonat ku mungojnë VGM, mbetjet hidhen në vende të hapura.
  - Nga VDM, shumë qytetare të ndryshëm ( sidomos romë ) tërheqin një sasi të konsiderueshme të mbetjeve urbane.
  - Në shumë fshatra të Njësi Administrative në zonat rurale mbetjet hidhen në vende të hapura dhe në hapsira të ndryshme ujore.
  - Të gjitha këto konstatime tregojnë që; vlerat e normës që grumbullohet ( pra sasia e mbetjeve që mblidhen dhe dërgohen në Landfill ), janë më të ulta se vlerat e mbetjeve që realisht banorët gjenerojnë për çdo ditë.

## Përbërja mercologjike e mbetjeve

Gjatë hartimit të Startegjisë dhe Planit Kombëtar të Mbetjeve në vitin 2010, Bashkia Elbasan ( vetëm Lagjet Administrative të qytetit ), ishte një ndër qytetet, të cilat u monitoruan dhe u morën si kampion për përcaktimin e përbërjes mercologjike të mbetjeve. Në tabelën më poshtë tregohet përbërja mercologjike e qytetit të Elbasanit për 16 rrymat e mbetjeve të përzgjedhura gjatë fazës së kampionimit:

Përbërja mercologjike e mbetjeve në nivel kombëtar.

Të dhënat e mbetjeve për vitin 2018

Nr.	Të dhënat e informacionit	Kodi i Katalogut Shqiptar	Bashkia
1	Numri i Banorëve		212 244
2	Sasia e mbetjeve për person Kg/Vit		218





3	Sasia e mbetjeve Organike (shtëpiake) Ton/ Vit	20	14 846.30
4	Sasia e mbetjeve Inerte Ton/ Vit	17 09 04	1 079.74
5	Sasia e mbetjeve Spitalore Kg/Ton Vit	18 01 10	-
6	Sasia e mbetjeve Sasia e mbetjeve Plastike Ton/ Vit	17 02 03 15 01 02	5 252.50
7	Sasia e mbetjeve të Qelqit Ton/ Vit	15 01 07	2 701.96
8	Sasia e mbetjeve Metalike Ton/ Vit	17 04 07 15 01 04	1 085.61
9	Sasia e mbetjeve të Drurit Ton/m <sup>3</sup>	17 02 01 15 01 03	694.48
10	Sasia e mbetjeve të Letër dhe Kartonit Ton/ Vit	15 01 01 03 03 08	4 906.19
11	Sasia e mbetjeve të Baterive të dala jashtë përdorimit Ton/ Vit	16 06 16 06 01* 16 06 06*	166.30
12	Sasia e mbetjeve të gomave të dala jashtë përdorimit Ton/ Vit	16 01 03 400400 00	332.61
13	Sasia e mbetjeve të vajrave të përdorur Ton/ Vit	12 01 06* 12 01 10*	33.26
14	Sasia e mbetjeve nga produktet të Kafshëve Ton/ Vit	02 01 02	532.17
15	Sasia e mbetjeve të produkteve të tekstilit Ton/ Vit	04 15 09 04	1 230.65
16	Sasia e mbetjeve Elektrike dhe Elektronike Ton/ Vit	16 02 20 01 36	399.13
17	Sasia e mbetjeve të depozituara në Lendfill Ton/Vit		-
18	Sasia e mbetjeve të depozituara në Inceneritor Ton/Vit		33 260.90

Tabela Nr. 5

Nr	Perberja mercellogjike	%
1	Organike	45.5
2	Druri	1.5
3	Leter	5.1
4	Karton	8.3
5	LD - plastike	10.7
6	HD - plastike	3.5
7	Qelqi	5.4
8	Tekstile	5.1
9	Metale ferore	0.5
10	Metale me mgjyra	0.5
11	Mbetje spitalore	4.5
12	Produkte kaucuku	0.3
13	Inerte	7.7
14	MPEE	0.5
15	Bateri	0.03
16	Mbetje bujqesore - blektorale	1.2



Siç mund të shihet nga grafiku, mbetjet **organike** përbëjnë përqindjen më të madhe të mbetjeve në qytetin e Elbasanit të ndjekura nga **plastika, letra e kartoni** dhe **mbetjet inerte**. Pra 60.3% e sasisë të mbetjeve në qytetin e Elbasanit është e biodegradueshme ( organike, lëndë drusorë, letër dhe karton ) dhe potencial për t'u djegur, ndërsa 25.7% të sasisë të mbetjeve të qytetit e përbëjnë mbetjet e riciklueshme ( plastikë, qelq, metale, tekstile ), ku vetëm mbetjet plastikë përbëjnë 14.5% të sasisë së mbetjeve. Rreth 25% e sasisë janë mbetje të tjera.

### Skema e ofrimit të shërbimit në Bashkinë Elbasan deri në vitin 2019

Pas vitit 2017, Bashkia Elbasan ka qënë në proces të hartimit e planifikimi të kontratave të reja për Njësitë Administrative në drejtim të menaxhimit të integruar të mbetjeve:

Qellimi :

- Për të perpunuar të gjitha të dhënat dhe tregueseve që i përkasin viteve 2016 - 2017-2018.
- Për kontrolluar dhe monitoruar të gjitha proceset e shërbimit dhe zbatuar standarte të reja në përlllogartijen e kostove dhe menaxhimin menaxhimin e përgjithshem.
- Për të vendosur një Sistem monitorimit në Landfill, nje standrt ky që do të vijë në ndihmë Bashkisë për të llogaritur sasi të mbetjeve që grumbullohen.
- Për të punuar e menaxhuar me mire e me shumë, për të patur të dhëna sa më të sakta.

Në tabelat e më poshtë jepen të dhënat për muajt Qershor, Korrik dhe Gusht në lidhje me sasinë e mbetjeve të grumbulluara në të gjitha Njësitë Administrative.

Sasia e mbetjeve të grumbulluara gjatë muajve Qershor, Korrik dhe Gusht 2016 - 2017 - 2018

Lagjet Administrative të qytetit:

Tabela Nr. 6

Nr	Lagjet Administrative qytetit	Dergesat ( sasit ne ton/dite) per vitin 2016 - 2017 - 2018						
		Popullsia		Norma Gjenerim Kg/fryme	Qershor	Korrik	Gusht	Shuma
		Regjistruar	Kerkojne sherbime					
1	Lagjja 1	22 410	20 678	0.870	18.0	18.0	18.0	54.0
2	Lagjja 2	23 253	21 521		18.7	18.7	18.7	56.1
3	Lagjja 3	27 624	25 892		22.5	22.5	22.5	67.5
4	Lagjja 4	22 134	20 402		17.7	17.7	17.7	53.1
5	Lagjja 5	12 400	10 668		9.2	9.2	9.2	27.6
6	Lagjja 6	22 122	20 390		17.7	17.7	17.7	53.1
	Shuma	129 942	119 551		104	104	104	312

Njësitë Administrative në zonat rurale :

Në këto Njësi Administrative kryhet vetëm shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve urbane. Edhe ky shërbim kryhet në Njësitë Administrative si më poshte, si pasojë e shtrirjes gjeografike dhe infrastrukturës rrugore.

Tabela Nr. 7

Nr	Njësia Administrative (zonat rurale)	Dergesat ( sasit ne ton/dite) per vitin 2016 - 2017 - 2018						
		Popullsia		Norma gjenerimi	Sasia e gjeneruar ne dite	Sasia transportuar		
		Regjistri	Kerkojne sherbime			Frekue	Cikle (rruge)	Sasia mujore
1	Shushice	11 342	10 435	0.870	9	2 dit/jav	2	48
2	Shirgjan	10 585	9 738		9.2	3 dit/jav	2	72
3	Gjergjan	8 049	7 406		6.4	2 dit/jav	2	48
4	Tregan	4 606	4 236		3.6	3 dit/jav	2	72
5	Gjinar	5 047	4 644		4	1 dit/jav	2	16
6	Zavaline	1 914	1 801		1.5	-	-	-
7	Bradashesh	13 155	12 103		10.5	3 dit/jav	2	72
8	Paper	9 341	8 604		7.5	1 dit/jav	1	90
9	Gracen	2 497	2 297		2	-	-	-
10	Funar	3 063	2 813		2.4	-	-	-
11	Labinot- Mal	5 764	5 204		4.5	-	-	-
12	Labinot- Fushe	6 979	6 421		5.5	3 dit/jav	2	72
	Shuma	82 342	75 702		65.8			490

Në përfundim :

Në bazë të tabelave të mësipërme ku pasqyrohen të dhënat mbi sasitë e gjeneruara dhe krahasimi i normave të mbetjeve urbane në Njësine Vendore Bashkia Elbasan situatat mbi menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane dhe në veçanti të kryerjes së shërbimit të grumbullimit dhe të transportimit të mbetjeve urbane rezultojnë si:

A. Në sipërfaqet urbane dhe infrastrukturore të Njësive Administrative të qytetit, shërbimet realizohen me sipërmarrje në bazë të kontratave me Operator ekonomik.

Nga ku :

- Sipërfaqet urbane të 6 (gjashte) Lagjeve Administrative, në të cilat kryhen shërbimet e pastrimit dhe ato të grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane, janë të përfshira vetëm në një zonë kontrate, gjë e cila nuk ka sjelle rezultatet e dëshiruara.
- Sipërfaqja e zonës së kontratës nuk e mbulon të gjithë territorin urbane me shërbime, aktualisht zona e kontratës ze rreth 1500 ha të territorit urban të qytetit.
- Relativisht kjo ka sjellë që jo vetëm, vështërsi në kryerjen e shërbimit të pastrimit, por edhe në normën e grumbullimit të mbetjeve, pasi ajo është më e ulët se ajo e gjenerimit.
- Edhe pse në vijimesi, Bashkia Elbasan ka bashkëpunuar edhe me Institucione të tjera dhe OJQ të ndryshme mbi realizimin e një programi ( pilot ) mbi edukimin dhe ndergjegjësimin e komunitetit mbi riciklimin dhe ndarjen e mbetjeve urbane qysh në burim, rezultatet nuk kanë qenë të kënaqshme.

B. Dhe në Njësitë Administrative të zonave rurale.

Relativisht norma e grumbullimit të mbetjeve është më e ulët se ajo e gjenerimit, duke u nisur edhe nga fakti që shërbimi nuk ofrohet në 100% të territorit ku shtrihen keto Njësi.

Nga pasqyruarimi i të dhënave në tabelat e mësipërme, rezultojnë:



Tabela Nr. 8

Nr	Ndarja territoriale	Viti 2016		Viti 2017		Viti 2018	
		Gjeneruar	Grumbulluar	Gjeneruar	Grumbulluar	Gjeneruar	Grumbulluar
1	<b>Mbetje urbane</b>						
	- Lagjet Administrative	38 106	37 960	38 106	36 427	38 106	27 381
	- Njësiti Administrative	24 017	5 880	24 017	5 880	24 017	5 880
Shuma		62 123	43 840	62 123	43 840	62 123	33 261

Bashkia Elbasanit pas reformës së re administrative dhe territoriale, përbëhet nga: - 13 Njësi Administrative Nga keto :

- 1 Njësia Administrative në zonat urbane qytet; e ndarë në 6 Lagjet Administrative.
- 12 Njësi Administrative në zonat rurale ( fshatra ).

Në Bashkinë Elbasan situata e ofrimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në Njësitë Administrative deri në fund vitit 2018 jepet si në tabelën më poshtë:

Lloji i shërbimit ne 6 Lagjet Administrative te qyteti te Elbasanit ofrohet:

1. Shërbimi i pastrimit te qytetit ne baze te Struktures se shërbimeve.

I cila konsiston ne:

- Fshirjen e rrugeve e siperfaqeve urbane.
- Mirembajtjen e pjeseshme.
- Freskimin.
- Larjen e dezenfektimin e kontenireve te mbetjeve urbane.
- Transporti dhe largimi i mbetjeve urbane.

a. "Fshirja e rrugeve e trotuareve me fshese ( manuale )".

- Ky proces shërbimi, ne terma teknike konsiston në, fshirje për çdo meter katror të siperfaqeve të rrugëve dhe të trotuareve me krah (me fshesare) duke respektuar specifikimet teknike të vendosura për kryejen e këtij shërbimi pastrimi.
- Frekuenca e shërbimit për çdo ditë.
- Paraprakisht, janë bërë studime dhe verifikime në territorin urban.
- Klasifikimin dhe gjendjen teknike dhe funksionale të infrastruktures rrugore.
- Kategorizimin dhe nevojat që kërkojnë siperfaqet e rrugëve dhe trotuareve për trajtime me shërbime pastrimi.
- Përcaktimin e volumet të punës të cilat janë llogaritur në bazë të sipërfaqeve.
- Përgatitja e hartave digitale mbi parametrat dhe vendosjen e siperfaqeve në të cilat do të kryhet shërbimi i fshirjes me krah.
- Kontrolli dhe monitorimi mbi kryerjen e këtij shërbimi pastrimi duke vendosur standarte dhe akte normative.
- Përcaktimin e elementeve të kosos dhe infrastruktures mbështetese.
- Përllogaritjet e kostimit për çdo element si dhe të kosos së përgjithshme

b. "Mirëmbajta e pjesëshme e rrugëve dhe trotuareve".

- Ky proces shërbimi, ne terma teknike konsiston në; Mirëmbajtjen e pjeseshme për çdo meter katror të siperfaqeve të rrugëve dhe të trotuareve me krah (me fshesare) duke respektuar specifikimet teknike të vendosura për kryejen e këtij shërbimi pastrimi.
- Ky shërbimi konsiston vetëm në mirembajtje të pjesëshme pasi ai nuk kryen grryerjen dhe pastrimin e kunetave.
- Ashtu si për procesin e " Fshirjes" edhe për këtë proces pastrimi, paraprakisht, janë bërë studime dhe verifikime në terren.
- Frekuenca e shërbimit për çdo ditë.



- c. "Freskimi (lagia) e sipërfaqeve vetem të rrugëve e shesheve".
- Ky proces shërbimi, në terma teknike konsiston në; Freskimin (lagien) e sipërfaqeve të rrugëve dhe të shesheve duke respektuar specifikimet teknike të vendosura për kryejën e këtij shërbimi pastrimi.
  - Ky shërbim kryhet me autobot (10 m<sup>3</sup>) dhe nëpërmjet pjeseve të sprucatoreve bën të mundur larjen e pluhura dhe mbetjeve të mbetura nga procesi i fshirjes, operacion ky që ben të mundur lagien e rrugëve duke eliminuar pluhurat gjatë qarkullimit të automjeteve në rruget kryesore të qytetit.
  - Frekuenca e shërbimit për çdo ditë në periudhën Prill - Tetor.
  - Edhe për këtë shërbim, ashtu si dhe për proceset e tjera të pastrimit të qytetit, paraprakisht, janë bërë studime dhe verifikime në territorin urban.
- d. "Larja dhe dezenfektimin e kontenierëve të mbetjeve urbane".
- Ky proces shërbimi pastrimi, është mjaft i rëndësishëm, sepse ka një ndikim të drejtpërdrejtë në nuditjen e mjedisit si dhe në performancën e pastërtisë së qytetit.
  - Ky proces shërbimi, në terma teknike konsiston në; larjen dhe dezenfektimin e kontenierëve në një vend të caktuar, duke respektuar specifikimet teknike të vendosura për kryejën e këtij shërbimi pastrimi.
  - Frekuenca e shërbimit për çdo ditë, duke lare dhe dezenfektur të gjithë sasinë e kontenierëve në zonën e kontratës brenda një muaji.

Realizimin e kësaj strukture, e cila përmban të gjitha proceset e shërbimit të pastrimit të qytetit;

- Nga viti 2007 e në vazhdim kryhet nga Operatore ekonomik, nëpërmjet procedurave të prokurimit publik.
- Këto shërbimi pastrimi nuk ka qenë dhe nuk janë të planifikuara në Njësitë Administrative të zonave rurale.

## 2. Grumbullimin, Transportin e largimin të mbetjeve urbane.

I cili konsiston në:

1. Zbrastjen e kontenierëve (edhe nga vende të hapura), transportimi i tyre për në Landfill.  
Ky shërbim kryhet me sipërmarrje dhe ofrohet nga Operatori Shërbimit (kompani private) nëpërmjet procedurave të prokurimit publik, për Njësitë Administrative të zonave urbane (të qytetit) dhe nga Agjencia e Shërbimeve Publike pranë Bashkisë për Njësitë Administrative të zonave rurale.
2. Në grumbullimin e mbetjeve urbane me konteniere dhe direkt nga shtëpitë e qytetarëve. Edhe ky shërbim aktualisht kryhet me sipërmarrje dhe është i planifikuar vetëm për Lagjet Administrative të qytetit.  
Procesi i grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane, në terma teknike konsiston në:
  - a. Grumbullimi i mbetjeve urbane në çdo Njësi Administrative.
  - b. Ky proces shërbimi kryhet nëpërmjet përcaktimit të Vend-grumbullimit të mbetjeve e respektivisht numrit të kontenierëve të vendosura në çdo Vend-Grumbullim.
  - c. Grumbullimi dora - dorës i mbetjeve urbane; derë me derë të qytetarëve sipas zonave urbane të përcaktuara në Strukturën e shërbimeve.
  - d. Ky planifikim është bërë në baze të përpunimit të dhënave.

Për shërbimin e parë:

- Janë të vendosur në zonën e kontratës 650 copë konteniere me kapacitet 1.1m<sup>3</sup>, për të grumbulluar sasinë e mbetjeve të gjeneruar të përlogaritur në baze të procesit të trajtimit të transportimit të mbetjeve me konteniere dhe mjete teknologjike.

- Ne baze te perlllogaritjve per kryerjen e ketij sherbimi jane planifikuar me 4-5 cope ( nje rezereve ) mjete transporti teknologjik me kapacitet deri ne 10 ton.
- Njekohesisht eshte planifikuar dhe nje mjet vetshkarkues (rifurxho) per te transoprtuar mbetjet urbane te hedhura ne vende- grumbullimi te hapura te cilat i perkasin zonave te banuara ne periferi te qytetit.
- Frekuenca e sherbimit per çdo dite.

Per sherbimin e dyte:

- Per kete qellim eshte bere studimi dhe jane percaktuar ato zona urbane (enklava) ne te cilat do te kryhet sherbimi i transportimit te mbetjeve urbane dora - dores direkt nga shtepite e qytetareve.
- Ne baze te perlllogaritjve per kryerjen e ketij sherbimi jane planifikuar me 4 cope mjete transporti te thjeshta vetshkarkese me kapacitet deri ne 3 ton.
- Frekuenca e sherbimit per çdo dite.

Per sherbimin e trete:

- Grumbullimi e largimi i mbetjeve urbane nga Njësitet Administrative te zonave rurale, aktualisht eshte planifikuar dhe kryhet vetem ne disa Njësi Administrative.

Siç mund ta shohim edhe nga tabela, vetëm në zonat rurale; ky shërbimi menaxhohet dhe kryhet me anë të mjeteve të mundësuar nga Agjensia e Sherbimeve Publike prane Bashkise Shërbimi ishte i kombinuar në disa Njësi Administrative si me poshte:

Tabela Nr. 11

Nr	Njësitet Administrative (zonat rurale)	Dergesat ( sasit ne ton/dite) per vitet 2016 - 2017 - 2018						
		Popullsia		Norma gjenerimi	Sasia e gjeneruar	Sasia transportuar		
		Regjistri	Kerkojne sherbime			Frekue	Cikle (ruge)	sasia
1	Shushice	11 342	10 435	0.870	9	2 dit/jav	2	48
2	Shirgjan	10 585	9 738		9.2	3 dit/jav	2	72
3	Gjergjan	8 049	7 406		6.4	2 dit/jav	2	48
4	Tregan	4 606	4 236		3.6	3 dit/jav	2	72
5	Gjinar	5 047	4 644		4	1 dit/jav	2	16
6	Zavaline	1 914	1 801		1.5	-	-	-
7	Bradashesh	13 155	12 103		10.5	3 dit/jav	2	72
8	Paper	9 341	8 604		7.5	7 dit/jav	1	90
9	Gracen	2 497	2 297		2	-	-	-
10	Funar	3 063	2 813		2.4	-	-	-
11	Labinot- Mal	5 764	5 204		4.5	-	-	-
12	Labinot- Fushe	6 979	6 421		5.5	3 dit/jav	2	72
	Shuma	82 342	75 702		65.8			490

Skema e ofrimit të shërbimit në Bashkinë Elbasan pas vitit 2016 - 2017 - 2018.

- Pas kesaj periudhe, Bashkia Elbasan, per arritjen e standarteve mbi menaxhimin e integruar te mbetjeve urbane ka mendura te studjoje dhe te hartoje procedura te reja ne termat e tenderimit per nje kontrate sipermarrje me te madhe dhe mundesisht e shtrire ne te gjithe territorin e Njësive Administrative te Bashkise.
- Per kete qellim ( duke ju referuar te dhenave te deritanishme ) eshte menduar sipërfaqe e planifikuar per sherbime publike me sipermarrje, te ndahet ne disa zona kontrate dhe Kohezgjatje e ketyre kontratave do të jenë të vlefshme për nje periudhën 12 mujore ( 1 vit ) apo dhe 2 ( dy ) vjeçare.





- Konkretisht, Bashkia Elbasan ka mundësuar dhe planifikuar që këto shërbime publike t'i ofrojnë duke mbështetur në eksperimentet e mëparshme si dhe në standartet e reja që kërkon menaxhimi i integruar i mbetjeve urbane.
- Të ndajë territorin e Njësisë Administrative në disa Zona kontrate menaxheriale dhe në disa nënzona ( brenda tyre ) për kryerjen sa më mirë të shërbimeve të pastrimit, si dhe grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane në përputhje me nevojat e komunitetit si dhe të tregueseve sasiorë dhe cilësorë.

Orientuar:

1. Në sipërfaqet urbane dhe infrastrukturën rrugore të territorit të Bashkisë shërbimet e pastrimit dhe të transportimit të mbetjeve urbane në baze të kësaj ndarje të zonave dhe të nënzonave të kontratave sipërmarrëse.
2. Përcaktimin e termave dhe procedurave të tenderimit të bëhet për çdo zonë kontrate dhe jo në një kontratë të përbashkët për gjithë Bashkinë.
3. Planifikimi dhe përcaktimi i proceseve të shërbimit (struktura) të kryhet në baze jo vetëm të buxhetit por duke marrë në konsideratë dhe nevojat që ka çdo rrugë apo sipërfaqe urbane për këto shërbime.
4. Në kërkesat dhe standartet europiane mbi menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane si dhe mbështetur në Planin Strategjik Kombëtar për këtë qëllim.

Krahas orientimeve si më sipër, Bashkia Elbasan, gjatë studimit dhe hartimit të skemave për ofrimin e shërbimeve të pastrimit dhe menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane, ka kontrolluar dhe monitoruar gjendjen aktuale dhe të perspektives mbi:

- Shtrirjen gjeografike për çdo Njësi Administrative.
- Relievin.
- Gjendjen infrastrukturorë.

Paraprakisht, janë përpunuar të gjitha të dhënat mbi faktorët e mesipër, dhe në baze të tyre është bërë planifikimi dhe përcaktimi i Skemës së shërbimeve për çdo Lagje Administrative. Konkretisht:

Per Lagjet Administrative të qytetit gjatë viteve 2020-2024:

- Territori urban dhe infrastruktura rrugore të ndahet në dy zona shërbimi ( zona kontrate ) nga ku edhe procedurat e prokurimit publik të kryhen të ndara sipas zonave d.m.th shërbimi do të kryhet me Operatore ekonomik të ndryshëm.
- Për realizimin e shërbimeve të pastrimit dhe të grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane, të bëhet përcaktimi në Zonën Veriore dhe Zonën jugore të qytetit të Elbasanit.
- Vija ndarëse e zonave të kontratës do të jetë aksi rrugor "Qemal Stafa" nga lindja në perëndim ( në lindje Ura e Lizes, në perëndim kufiri me Njësinë Administrative Bradashesh )
- Zona Veriore: Lagjet Administrative Nr. 4 - 5 - 6, dy lagje të Lagjes Nr.1 "Kongresi Elbasanit" e "Luigj Gurakuqi" dhe dy lagje të Lagjes Nr. 3 "Dyli-Haxhire" e "28 Nentori".
- Zona Jugore: Lagjja Administrative Nr. 2, Lagjja Administrative Nr. 1 (pa lagjet "Kongresi Elbasanit" e "Luigj Gurakuqi") si dhe Lagjja Administrative Nr. 3 (pa lagjet "Dyli-Haxhire" e "28 Nentori")



Skema e shërbimeve sipas strukturës:

I. Proçeset e shërbimeve të pastrimit të qytetit.

Tabela Nr. 12

Nr	Struktura e Shërbimeve	Zonat e kontaktës	
		Zona Veriore	Zona jugore
1	<b>Fshirja rrugëve e trotuare me krah (fshesare):</b>		
	- Siperfaqja	168 000 m <sup>2</sup>	140 000 m <sup>2</sup>
	- Volumi punës në një vit	61 320 000 m <sup>2</sup>	51 100 000 m <sup>2</sup>
	- Frekuenca e shërbimit	7 dite në javë	7 dite në javë
	- Numri i operatorëve të shërbimit	20	17
2	<b>Mirembajtje pjesëshme rrugë e trotuare</b>		
	- Siperfaqja	180 000	150 000
	- Volumi punës në një vit	65 700 000	54 750 000
	- Frekuenca e shërbimit	7 dite në javë	7 dite në javë
	- Numri i operatorëve të shërbimit	6	5
4	<b>Freskimi i rrugëve</b>		
	- Siperfaqja	62 000	43 000
	- Volumi punës (periudha Prill - Tetor)	13 260 000	9 300 000
	- Frekuenca e shërbimit	7 dite në javë	7 dite në javë
	- Numri i operatorëve të shërbimit	1 (shofer autoboti)	1 shofer (autoboti)
	<b>Larja e rrugëve e shesheve</b>		
	- Siperfaqja	56 000	42 000
	- Volumi punës në një vit	672 000	504 000
	- Frekuenca e shërbimit	Një herë në muaj	Një herë në muaj
	- Numri i operatorëve të shërbimit	2 (1 shofer-1 operator)	2 (1 shofer-1 operator)
5	<b>Larja dhe dezinfektimi i kontenierëve</b>		
	- Numri i kontenierëve	370	330
	- Volumi punës në një vit	4 440	3 960
	- Frekuenca e shërbimit (çdo ditë nga 13 cope)	Një herë në muaj	Një herë në muaj
	- Numri i operatorëve të shërbimit	1 shofer - 2 operator	1 shofer - 2 operator
6	<b>Fshirja e rrugëve dytesore (manuale ose autofshese të kapaciteteve të vogla)</b>		
	- Siperfaqja		
	- Volumi punës në një vit		
	- Frekuenca e shërbimit		
	- Numri i operatorëve të shërbimit		

**II. Proçeset e shërbimeve të grumbullimit dhe të transportimit të mbetjeve urbane.**

Respektivisht:

- Zona e parë e shërbimit (pjesa veriore e qytetit):  
Lagjet Administrative Nr. 4 - 5 - 6, dy lagje të Lagjes Nr.1 "Kongresi Elbasanit" e "Luigj Gurakuqi" dhe dy lagje të Lagjes Nr. 3 "Dyli-Haxhire" e "28 Nentori".
- Zona e dytë e shërbimit (pjesa jugore e qytetit):  
Njësitë Administrative Nr. 1 (pa dy lagje) e 2,3(pa dy lagje)

Tabela Nr. 13

Nr	Struktura e Shërbimeve	Njësia matje	Zonat e kontartes	
			Zona Veriore	Zona jugore
1	Transporti e largimi i mbetjeve urbane me mjete teknologjike me kapacitet 10 ton			
	- Numri i popullsise ne Gjendje Civile	nr	79 580	50 250
	- Numri i popullsise qe i ofrohet ky shërbim	nr	73630 - (7800)	46 450 - (3630)
	- Norma gjenerimit	Kg/fryme	0.700	0.700
	- Sasia e mbetjeve të gjeneruar	ton	47.3	32.5
	- Sasia e mbetjeve të grumbulluara	ton	46	30
	- Numri i konteniereve	cop	400	250
	- Numri i mjeteve teknologjike (10 ton)	cop	3	2
	- Frekuenca	nr	7 dite ne jave	7 dite ne jave
	- Numri i konteniereve të përpunuar në një cikël	cop	64	63
	- Numri i cikleve ( rruge)	nr	2	2
	- Sasia e mbetjeve të transportuara	ton	46	30
	- Koha e kryerjes së një cikli për grumbullim	ore	6.4	6.2
	- Distanca deri në Landfill	km	7	7
	- Koha e transportit dhe zbrazjes në Landfill	ore	1.3	1.3
- Koha totale për transport të një mjeti/dite	ore	7.7	7.5	
Nga përlogartijet e më sipërme rezultojnë se : - Për të transportuar mbetjet urbane të grumbulluara me konteniere, me mjete teknologjike një Operator ekonomik duhet që: a. Për zonën veriore; të transportojë 46 ton mbetje në ditë me 3 mjete transporti me kapacitet 10 ton duke përpunuar 400 cope kontenire me kapacitet 1.1 m <sup>3</sup> b. Për zonën jugore; të transportojë 30 ton mbetje në ditë me 2 mjete transporti me kapacitet 10 ton duke përpunuar 250 konteniere me kapacitet 1.1 m <sup>3</sup>				
Transporti e largimi i mbetjeve urbane me mjete të thjeshta me kapacitet 3 ton				
2	- Numri i popullsise qe i ofrohet ky shërbim	nr	7 800	3 650
	- Numri i familjeve	ton	2 600	1 210
	- Norma gjenerimit	kg/fryme	0.700	0.700
	- Sasia e mbetjeve të gjeneruar	ton	6	2.9
	- Sasia e mbetjeve të grumbulluara	cop	5.4	2.5
	- Numri i mjeteve të thjeshta kapaciteti (3 ton)	cop	3	1
	- Frekuenca	dit	7 dite ne jave	7 dite ne jave
	- Numri i cikleve ( rruge)	cop	1	1
	- Numri i familjeve që përpunon një mjet në ditë	nr	2 600	1 210
	- Sasia e mbetjeve të transportuara	nr	6	2
	- Koha e kryerjes së një cikli për grumbullim	ore	6	6
	- Distanca deri në Landfill	km	7	7
	- Koha e transportit dhe zbrazjes në Landfill	ore	0.6	0.6
	- Koha totale për transport të një mjeti/dite	ore	6.6	6.6
Nga përlogartijet e më sipërme rezultojnë se : - Për të transportuar mbetjet urbane direkt nga shtëpitë e qytetarëve një Operator ekonomik duhet që: a. Për zonën veriore; të transportojë 5.4 ton mbetje në ditë me 3 mjete transporti me kapacitet 3 ton duke terhequr mbetjet në 2600 familje në ditë. b. Për zonën jugore; të transportojë 2.5 ton mbetje në ditë me 1 mjet transporti me kapacitet 3 ton duke terhequr mbetjet nga 1210 familje në ditë				



II. Proçeset e shërbimeve të grumbullimit dhe të transportimit të mbetjeve urbane që do të kryhen në Njësitë Administrative të zonave rurale

1. Njësitë Administrative Bradashesh - Gracën - Funar (vetëm në 17 fshatra)

Respektivisht: Bradashesh - Balez Lart - Balez Poshtë - Karakullak- Katundi Ri- Kusarë - Letan - Petresh - Reçan - Rrilë - Shijon - Dopaj - Gjormë - Shingjin- Branesh - Bixelle - Mollagjesh

Tabela Nr. 14

Nr	Struktura e shërbimit	Njësi matje	Zonat në të cilat do të kryhet shërbimi			Shuma
			Zona I			
			Njësitë Administrative Bradashesh	Njësitë Administrative Gracën	Njësitë Administrative Funar	
<b>Transporti i largimi i mbetjeve urbane me mjete teknologjike me kapacitet 10 ton</b>						
- Numri i popullsisë në Gjendje Civile	nr	13 155	2 497	3 062	18 714	
- Numri i fshatrave sipas regjistrimit	nr	17	9	9	35	
- Sasia e gjeneruar sipas standardeve të Regjistrimit	ton	11.4	2.2	2.7	16.3	
- Numri i popullsisë që i ofrohet ky shërbim	nr	8 512	1 497	1 021	11 030	
- Numri i fshatrave që i ofrohet shërbim	nr	11	3	3	17	
<b>- Mbulimi i Njësive me shërbim</b>	<b>%</b>	<b>65 %</b>	<b>30 %</b>	<b>30 %</b>	<b>50%</b>	
- Sasia e mbetjeve të gjeneruar në ditë (që merr shërbim)	ton	7.4	1.3	1	9.7	
- Sasia e mbetjeve të grumbulluara (ton/ditë)	ton	6	1	0.8	7.8	
- Numri i kontenierëve që nevojiten sipas sasise	cop	62	11	9	82	
- Numri i mjeteve teknologjike (10 ton)	cop	1	1	1	1	
- Sasia e mbetjeve të grumbulluara në një javë	ton	42	7	5.6	54.6	
- Frekuenca e kryerjes së shërbimit	dit	3 dit/javë	1 dit/javë	1 ditë/javë	-	
- Sasia e mbetjeve të transportuar në një frekuencë	ton	14	7	5.6	26.6	
- Numri i cikleve (rruge)	nr	2	1	1	8	
- Numri i fshatrave që merr shërbim (në një frekuencë)	nr	6	3	3	10	
- Koha e kryerjes për grumbullim (në një frekuencë)	ore	6	6	4	16	
- Distanca deri në Landfill (km)	km	5	28	30	-	
- Koha e transportit dhe zbrazjes në Landfill	ore	1.3	2	2	5.3	
- Koha totale për transport të një mjeti në një frekuencë	ore	7.3	8	6	21.3	
<b>Analizë:</b>						



2 . Njësia Administrative Paper ( vetem ne 8 fshatra)

Respektivisht: Paperr - Balldreu - Boshka - Lugaj - Murrasi - Ullishta - Valasi - Vidhasi

Tabela Nr. 15

Nr	Struktura e shërbimit	Njësia matje	Zonat ne te cilat do te kryhet shërbimi
			<b>Zona II</b>
<b>Transporti e largimi i mbetjeve urbane me mjete teknologjike me kapacitet 10 ton</b>			
- Numri i popullsisë ne Gjendje Civile		nr	9 341
- Numri i fshatrave sipas regjistrimit		nr	13
- Sasia e gjeneruar sipas standarteve e Regjistrimit		ton	8.1
- Numri i popullsisë qe i ofrohet ky shërbim		nr	5 748
- Numri i fshatrave qe i ofrohet shërbim		nr	8
<b>- Mbulimi i Njësise me shërbim</b>		%	60 %
- Sasia e mbetjeve te gjeneruar ne dite (qe merr shërbim)		ton	5
- Sasia e mbetjeve te grumbulluara (ton/dite)		ton	4.2
- Numri i kontenireve qe nevoiten sipas sasise		cop	42
- Numri mjeteve teknologjike ( 10 ton)		cop	1
- Sasia e mbetjeve te grumbulluara ne nje jave		ton	30
- Frekuenca e kryerjes se shërbimit		dit	3 dite /jave
- Sasia e mbetjeve te transportuar ne nje frekuence		ton	10
- Numri i cikleve ( rruge)		nr	1
- Numri i fshatrave qe merr shërbim ( ne nje frekuene)		nr	3
- Koha e kryerjes per grumbullim( ne nje frekuence)		ore	4
- Distanca deri ne Landffill ( km)		km	18
- Koha e transportit dhe zbrazjes ne Landffill		ore	1.3
- Koha totale per transport te nje mjeti nenje frekuence		ore	5.3
<b>Analize:</b>			



3 . Njësia Administrative Shushica - Gjinar - Labinot Fushe (vetem ne 10 fshatra)

Respektivisht: Shushice - Hajdaran - Mlize - Vreshtaj - Gjinar - Labinot Fushe - Griqan Poshte - Griqan

Lart - Mengel - Xibrake

Tabela Nr. 16

Nr	Struktura e sherbimit	Njësi matje	Zonat ne te cilat do te kryhet sherbimi			Shuma
			Zona III			
			Njësia Administra Shushice	Njësia Administra Gjinar	Njësia Administra Labinot Fushe	
<b>Transporti e largimi i mbetjeve urbane me mjete teknologjike me kapacitet 10 ton</b>						
- Numri i popullsise ne Gjendje Civile		nr	11 342	5 047	6 979	23 368
- Numri i fshatrave sipas regjistrimit		nr	9	11	6	26
- Sasia e gjeneruar sipas standarteve e Regjistrimit		ton	9.8	4.4	6	20.2
- Numri i popullsise qe i ofrohet ky sherbim		nr	5 040	958	4 652	10 650
- Numri i fshatrave qe i ofrohet sherbim		nr	4	1	4	9
<b>- Mbulimi i Njësise me sherbim</b>		%	<b>44 %</b>	<b>-</b>	<b>65 %</b>	<b>35 %</b>
- Sasia e mbetjeve te gjeneruar ne dite (qe merr sherbim)		ton	4.4	1	4	9.4
- Sasia e mbetjeve te grumbulluara (ton/dite)		ton	3.5	1	3.2	7.7
- Numri i kontenireve qe nevoiten sipas sasise		cop	37	10	34	81
- Numri mjeteve teknologjike ( 10 ton)		cop	1	1	1	1
- Sasia e mbetjeve te grumbulluara ne nje jave		ton	24.5	7	28	60
- Frekuenca e kryerjes se sherbimit		dit	3 dite/jave	1dite/jave	3 dite/jave	-
- Sasia e mbetjeve te transportuar ne nje frekuence		ton	8	7	9.3	24.3
- Numri i cikleve ( rruge)		nr	1	1	2	4
- Numri i fshatrave qe merr sherbim ( ne nje frekuene)		nr	4	1	2	9
- Koha e kryerjes per grumbullim ( ne nje frekuence)		ore	5	2	3	10
- Distanca deri ne Landfill ( km)		km	22	35	20	26
- Koha e transportit dhe zbrazjes ne Landfill		ore	2	2	2	6
- Koha totale per transport te nje mjete nenje frekuence		ore	7	4	5	16





4 . Njësia Administrative Shirgjan - Tregan - Gjergjan (vetem ne 14 fshatra)

Respektivisht: Shirgjan - Bathes - Bujqes - Jagodine - Kuqan - Mjebes - Tregan\_ - Kyçyk - Muçan -Gjergjan - Bujaras - Gjonme - Muriqan - Thane

Tabela Nr. 17

Nr	Struktura e sherbimit	Njësi matje	Zonat ne te cilat do te kryhet sherbimi			Shuma
			Zona IV			
			Njësia Administra Shirgjan	Njësia Administr Tregan	Njësia Administr Gjergjan	
<b>Transporti e largimi i mbetjeve urbane me mjete teknologjike me kapacitet 10 ton</b>						
- Numri i popullsise ne Gjendje Civile	nr	10 585	4 606	8 049	23 240	
- Numri i fshatrave sipas regjistrimit	nr	7	12	7	26	
- Sasia e gjeneruar sipas standarteve e Regjistrimit	ton	9.2	4	7	20.2	
- Numri i popullsise qe i ofrohet ky sherbim	nr	9 072	1 151	5 749	15 972	
- Numri i fahatrave qe i ofrohet sherbim	nr	6	2	5	13	
<b>- Mbulimi i Njësise me sherbim</b>	%	90 %	-	70 %	50 %	
- Sasia e mbetjeve te gjeneruar ne dite (qe merr sherbim)	ton	8	1	5	14	
- Sasia e mbetjeve te grumbulluara (ton/dite)	ton	6.5	0.8	4.2	11.5	
- Numri i kontenireve qe nevoiten sipas sasise	cop	67	9	42	118	
- Numri mjeteve teknologjike ( 10 ton)	cop	1	1	1	1	
- Sasia e mbetjeve te grumbulluara ne nje jave	ton	45.5	5.6	29.4	80.5	
- Frekuenca e kryerjes se sherbimit	dit	3 dite/jave	1 dite/jave	3 dit/jave	-	
- Sasia e mbetjeve te transportuar ne nje frekuence	ton	15.1	5.6	9.8	-	
- Numri i cikleve ( ruge)	nr	2	1	2	-	
- Numri i fshatrave qe merr sherbim ( ne nje frekuene)	nr	6	2	3	-	
- Koha e kryerjes per grumbullim ( ne nje frekuence)	ore	6	4	5	15	
- Distanca deri ne Landfill ( km)	km	18	27	20	-	
- Koha e transportit dhe zbrazjes ne Landfill	ore	2	3	2	7	
- Koha totale per transport te nje mjete nenje frekuence	ore	8	7	7	23	

Bashkia po punon me te gjithë Njësitet Administrative per te monitoruar dhe menaxhuar te gjitha dergesat dhe sasine të regjistruara në Landfill per te paraqitur një situatë më reale në lidhje me mbetjet që grumbullohen ne Bashkine Elbasan

Riciklimi dhe kompostimi

Në territorin e Bashkisë Elbasanit nuk regjistrohen aktivitete në lidhje me riciklimin dhe kompostimin në asnjë nga Njësitet Administrative. Qyteti i Elbasanit vite më parë ka testuar vendosjen e sistemit me tre kosha në rrugët kryesore të qytetit, por kjo skeme nuk funksionoi dhe bashkia përsëri ka aplikuar sistemin e grumbullimit të mbetjeve vetëm më një kosh.

Në të shkuarën për pjesën e qytetit ka patur përpjekje për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme nga sektori i biznesit, por përsëri këto përpjekje nuk kanë mundur të kenë sukses të mëtejshëm. Forcimi i biznesit dhe industrisë së riciklimit në vend dhe në rajonin e Elbasanit do të jetë faktor i rëndësishëm së bashku me aktorët kryesorë për zhvillimin e skemave të riciklimit. Skema aktuale e grumbullimit të mbetjeve është klasike, ku mbetjet mbledhen dhe transportohen të përziera, pa ndjekur procesin e ndarjes, për në Landfilli.

Aktualisht, ndonëse në Bashkinë Elbasan mund të ketë patur kërkesa nga aktorë të rajoneve të tjera për të mbledhur disa fraksione të caktuara të mbetjeve të riciklueshme, popullsia Rome është ajo që kryen një aktivitet të përditshëm informal në grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme nga PGM apo në depozitimet ilegale në territor.



Detyra kryesore e Bashkisë Elbasan është të nxisë dhe krijojë një mjedis të qëndrueshëm për zhvillimin e sektorit të riciklimit, duke ngritur një skemë efektive dhe efikase për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të riciklueshme si plastikë, letër & karton, metal, qelq apo produkte të tjera të cilat kanë interes të lartë në tregun shqiptar ashtu dhe në rajon. Afrimi dhe nxitja e biznesit të riciklimit për të mbështetur skemat lokale të ndarjes dhe riciklimit të mbetjeve në zonat urbane të bashkisë do të mundësojë zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori dhe do të ulë barrën financiare të bashkisë.

Përfshirja e sektorit privat, me anë të konçesionit apo PPP do të inkurajohet si një mekanizëm për ofrimin e zgjidhjes më të mirë ekonomike që do të jetë e pranueshme nga pikëpamja mjedisore.

Identifikimi dhe nxitja e biznesit të riciklimit që është aktiv në rajon apo jashtë kufirit shtetëror do të jetë një nga detyrat kryesore të bashkisë për të mbështetur riciklimin në qytet. Skemat e partneritetit - publik-privat mbeten zgjidhjet më të mundshme për një zhvillim të qëndrueshëm të këtij sektori për të ardhmen ku do të aplikohet.

### Landfilli (inceneratori)

Të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Elbasanit i transportojnë mbetjet për depozitim final për në kete Landfillin që nga 16.02.2016. Kur mjetet teknologjike hynë në Landfill ato peshohen rregullisht dhe më pas depozitohen në Landfill.

### Aspektet ekonomiko - financiare te Menaxhimit te Mbetjeve

Kosto e plotë e sistemit të menaxhimit të mbetjeve.

Sipas të dhënave të marra nga Bashkia Elbasan për vitin 2016-2017 Bashkia, ka parashikuar Buxhetin për shërbimin e mbetjeve jo të ndara sipas Njësite Administrative, por sipas planifikimit të bere përpara reformës Administrative Territoriale, ndërsa për vitin 2018 buxheti është parashikuar për të gjithë Bashkinë (e madhe pas reformes).

Shpenzimet e pergjithshme te Menaxhimit të Integruar te Mbetjeve Urbane jane perlloraritut duke ju referuar edhe buxhetit te planifikuar për vitin 2016, 2017 e 2018.

Programi Buxhetor i Bashkisë Elbasan - per menaxhimin i mbetjeve 2016 - 2017 - 2018:

Tabela Nr. 18

Nr	Struktura shërbimeve	Njësi mates	Periudha				
			Gusht 2016 - Gusht 2017 - Gusht 2018				
			Volume pune te Planifikuar	Volume pune te Realizuar	Vlera Planifikuar 000 lek	Vlera Realizuar 000 /lek	Vlera %
<b>I</b>	<b>Sherbime pastrimi</b>						
	- Fshirje rruge 7 dite ne jave	m <sup>2</sup>	104 759 380	86 985 772	22 628 026	18 788 926	83 %
	- Fshirje rruge 3 dite ne jave	m <sup>2</sup>	10 056 985	10 056 985	2 162 251	2 162 251	100 %
	- Mirembajtje e pjeseshm e rrugeve	m <sup>2</sup>	104 397 665	98 740 249	5 011 087	4 739 531	94 %
	- Larje rruge	m <sup>2</sup>	179 080	127 537	107 448	76 522	71 %
	- Freskimi i rrugeve	m <sup>2</sup>	21 828 706	20 257 240	3 929 167	3 646 303	92 %
	- Larja konteniereve	cope	7 920	7920	1 520 640	1 520 640	100 %
			<b>Shuma</b>		<b>35 358 619</b>	<b>30 934 173</b>	<b>87 %</b>
<b>II</b>	<b>Transporti i mbetjeve urbnae</b>						
	- Me mjete teknologjike	ton	35 213	30 112	64 897 559	55 496 416	85 %
	- Direkt nga shtepite e qytetareve	ton	6 570	6 300	1 348 164	1 292 760	95 %
			<b>Shuma</b>		<b>66 245 723</b>	<b>56 789 176</b>	<b>86 %</b>



<b>III</b>	<b>Depozitimi ne Lanffill:</b>			
	- Per kete proces sherbimi, theksojme se ne baze te nje marreveshje dypaleshe midis Subjektit privat qe administron Landfillin e ri ne Elbasn dhe Bashkise Elbasan, eshte arritur qe depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane ne Landfill do te behet pa pagese me nje kohezgjatje te pa percaktuar. Per pasojenuk eshte bere planifikim te shpezimeve ne Buxhetin e kesaj periudhe			
<b>SHUMA E SHPENZIMEVE</b>		<b>101 604 342</b>	<b>87 723 349</b>	<b>86 %</b>

Per periudhen ne fjale nga perpunimi i te dhenave te pasqyruar ne table si me lart rezulton:

- Vlera e shpenzime per kryerjen sherbimeve te pastrimit dhe menaxhimit e pergjithshem te mbetjeve urbane eshte me e vogel se ajo e planifikuar ne Buxhet.
  - Gjate periudhes ne fjale 2016 - 2017 ne baze te investimeve qe jane kryer ne infrastrukturen rrugore dhe siperfaqet urbane shume nga volumet e punes te planifikuar nuk jane kryer si pasoje e rikonstruksionit te rrugeve.
  - Pas muajt Shkurt 2016 u arrit marreveshja me Landfillin, e cila beri te mundur reduktimin e shpezimeve per kryerjen e procesite te depozitimit, manipulimit dhe trajtimit te mbetjeve urbane. (te cilat kryheshin ne Vend - depozitimin e vjeter).
  - Nga zbritja e volumeve te punes per moskryerjen e sherbimeve te percaktuar ne strukturen e pergjithshme, nepermjet kontrolleve dhe vendosjes se indikatorëve mates per çdo sherbim.

Por ne çfare raporti eshte Buxheti i pergjithshem i Bashkise me buxhetin e planifikuar per menaxhimit e mbetjeve urbane?

Në tabelën më poshtë jepet një pasqyrë më e qartë në lidhje me përqindjen që zë Buxheti për menaxhimit e mbetjeve kundrejt buxhetit të planifikuar për sherbimet publike ne teresi me buxhetit total të Bashkisë për dy vitet e fundit:

Tabela Nr. 19

Nr.	Vitet	Buxheti				
		Buxheti Bashkise (000/ leke) ne vit	Buxheti per sherbime publike (000 leke) ne vit		Buxheti per menaxhimit e mbetjeve (000 leke) ne vit	
			Planifikim	Vleresim %	Planifikim	Vleresim %
1	Viti 2016	2 116 273	157 232	7.4 %	118 344	5.5 %
2	Viti 2017	2 306 307	203 492	8.8 %	123 589	5.3 %
3	Viti 2018	2 604 140	269 599	10.4%	131 860	5.1%
4	Viti 2019	2 759 856	274 110	8.9%	116 851	4.2%

- Nga shifrat e pasqyruara rezulton se; per vitin 2016, Buxheti për menaxhimit e mbetjeve urbane përbën 5.5 % të Buxhetit total të Bashkisë.
- Nenvizojme për vitin 2016 (Njësitë Administrative (ish komunat) kishin Buxhete të ndara nga Bashkia e madhe.
- Ndërkohë për vitin 2017, Buxheti për menaxhimit e mbetjeve urbane përbën 5.3 % të Buxhetit total të Bashkisë dhe 8.8 % të buxhetit për shërbimet publike.
- Ndërkohë për vitin 2018, Buxheti për menaxhimit e mbetjeve urbane përbën 5.1 % të Buxhetit total të Bashkisë dhe 8.104 % të buxhetit për shërbimet publike.
- Ndërkohë për vitin 2019, Buxheti për menaxhimit e mbetjeve urbane përbën 4.2 % të Buxhetit total të Bashkisë dhe 8.9 % të buxhetit për shërbimet publike.



Por:

Sa jane shpenzime realisht te harxhuara per menaxhimin e mbetjeve urbane per keto dy vite?

Sa perben ai ne raport me planifikimin dhe me Buxhetin e Bashkise?

- Per kete qellim, fillimisht duhet analizuar dhe perlllogaritur vlersimin ne perqindje te Shpenzimeve te planifikuar sipas kontratave sipermarrese, me shpenzimet reale sipas kyerjes se volumeve te punes dhe vleresimit te pasqyruar ne Situacionet mujore.

Tabela Nr. 20

Nr.	Vitet	Buxheti për menaxhimin e mbetjeve 000 lekë ne vit				
		Planifikim në buxhet	Planifikimi sipas kontratave	Vleresim %	Sipas shpenzimeve reale	Vleresim %
1	Viti 2016	118 344	99 334	84 %	82 896	83 %
2	Viti 2017	123 589	89 270	73 %	96 700	97 %
3	Viti 2018	131 869	118 300	90 %	91 867	77 %
4	Viti 2019	126 708	126 869			

Ne baze te shifrave ne 000/lek te paraqituara ne tabelen e mesipeme rezulton qe:

- Per vitin 2016 per menaxhimin e mbetjeve urbane jane shpenzuar vetem 83 % e Buxhetit te Bashkise te planifikuar per kete qellim  
Nga keto:
  - Shpenzime vetem per sherbimet e pastrimit - 20 060 leke
  - Shpenzime per grubullimin e transoprtin e mbetjeve urbane - 62 836 leke
- Per vitin 2017 per menaxhimin e mbetjeve urbane jane shpenzuar vetem 97 % e Buxhetit te Bashkise te planifikuar per kete qellim  
Nga keto:
  - Shpenzime vetem per sherbimet e pastrimit - 28 320 leke
  - Shpenzime per grubullimin e transoprtin e mbetjeve urbane - 68 380 leke
- Per vitin 2018 per menaxhimin e mbetjeve urbane jane shpenzuar vetem 77 % e Buxhetit te Bashkise te planifikuar per kete qellim  
Nga keto:
  - Shpenzime vetem per sherbimet e pastrimit - 20 160 leke
  - Shpenzime per grubullimin e transoprtin e mbetjeve urbane - 71 707 leke

Pas perpunimit e te dhenave te pasqyruar ne tabelen e mesiperme rezulton:

Tabela Nr. 21

Nr.	Vitet	Buxheti Bashkise (000/leke) ne vit	Buxheti per menaxhimin e mbetjeve 000 leke ne vit			
			Planifikim	Vleresim me planin %	Shpenzimeve reale	Vleresimi me shpenzimet reale %
1	Viti 2016	2 116 273	118 344	5.5 %	85 490	4 %
2	Viti 2017	2 306 307	123 089	5.3 %	85 490	3.7 %
3	Viti 2018	2 604 140	131 860	5.1 %	91 867	3.5 %
4	Viti 2019	2 759 856	247 110	8.9 %		

- Bashkia e madhe ka alokuar vetëm 4 % të Buxhetit të saj total për menaxhimin e mbetjeve urbane per vitet 2016 - 2017 - 2018.

## Sistemi i tarifave të menaxhimit të mbetjeve

- Ekzistojne menyra te ndryshme per te percaktuar tarifen qe ( familjet ) gjeneruesi duhet te paguajnë per sherbimet e pastrimit, grumbullimit dhe transportit te mbetjeve urbane.

Metodologjia dhe kriteret me reale per te perdorur ne sistemin e tearifimit jane:

- Numrin e familjeve.
- Numrin e pjestareve per çdo familje.
- Te ardhurat mujore per çdo familje.
- Paga mujor per çdo pjestar te familjes.
- Siperfaqen e prones per çdo familje.
- Numrin e bizneseve.
- Sipefaqe e prones per çdo biznes.
- Kategorite e bizneseve dhe veprimtaria tyre.
- Numrin e institucioneve dhe numrin e punonjesve per çdo institucion

Por, aktualisht asnjera prej tyre nuk eshte i persosur, prandaj te gjitha sistemet jane objekt diskutimi

Per periudhat ( 2016 - 2017 - 2018 ) niveli i tarifave për Njësitë Administrative të Bashkisë Elbasan jane te aplikuar tarifa mbi menaxhimin e mbetjeve ne baze te:

- Per qytetin ( zona urbane )

A. Per komunitetin

- Numrit te familjeve për çdo Njësi Administrative.
- Te ardhurat per familje.
- Paga mesatare mujore per çdo pjestar te familjes.

B. Per bizneset te cilat kategorizohen:

- Biznesi i madh te kategorizuar sipas aktiviteteve.
- Biznesi i vogel.
- Dhe institucionet publike dhe arsimore.
- Numrit te bizneseve ( te ndara sipas aktiviteteve dhe siperfaqeve te aktivitetit ).

Ky sistem kategorizimi eshte vendosur vetem per Njësite Administrative te qytetit, pasi ne keto Njësi eshte planifikuar dhe zbatohet Struktura e plote e sherbimeve te pastrimit si:

1. Sherbimi i pastrimit me te gjithë proceset e saj.
2. Grumbullimi e transportimi mbetjeve urbane per ne Lanffill.

- Per fshatrat ( zona rurale).
- Numrit te familjeve për çdo Njësi Administrative.
- Numrit te familjevete cilet jane Skemen e ndihmes ekonomike ( te cilet perjashtohen).
- Numrit te pensionistevë dhe invalideve ( te cilet perjashtohen ).
- Numri i familjeve qe kategorizohen sipas siperfaqeve te tokes qe kane ne perdorim.

Në tabelat më poshtë pasqyrohen treguesit te cilet bejne te mundur modelet per perlllogaritjen e tarifave per menaxhimine e mbetjeve urbane.

Per periudhat nga ku jemi referuar ( 2016 - 2017 - 2018 - 2019 ) niveli i tarifave për Lagjet Administrative të qytetit Elbasan jane si më poshte:

Tabela Nr. 22

Nr	Njësiti Administrative	Nr. lagjeve	Popullsia Regjistruar		Popullsia që ofrohet shërbime		Tarifa vendosur leke/vit familje
			Nr. familjeve	Nr. banoreve	Nr. familjeve	Nr. banoreve	
I	Zona urbane qytet						
I.a	Lagjia 1	4	7 470	22 407	6 892	20 678	1000
	Lagjia 2	4	7 751	23 253	7 173	21 521	1000
	Lagjia 3	4	9 208	27 626	8 630	25 892	1000
	Lagjia 4	4	7 378	22 136	6 800	20 402	1000
	Lagjia 5	3	4 133	12 400	3 556	10 668	1000
	Lagjia 6	1	7 374	22 122	6 796	20 390	1000
	<b>Shuma</b>	<b>20</b>	<b>43 314</b>	<b>129 944</b>	<b>39 847</b>	<b>119 541</b>	
I.b	Bizneset	Nj.matje	Regjistruara		Tarifa vendosur leke/vit		
	A. Biznesi madh						
	- Eksport - Import	nr			30 000		
	- Prodhimi	nr			55 000		
	- Ndertimi	nr			60 000		
	B. Biznesi vogel						
	- Tarifa mesatare	nr			20 000		
I.c	Institucionet	nr			30 000		
	<b>Shuma</b>						
II	NJ.A zonat rurale	Nr. fshatrave	Popullsia Regjistruar		Popullsia që ofrohet shërbime		Tarifa vendosur leke familje
			Nr. familjeve	Nr. banoreve	Nr. familjeve	Nr. banoreve	
1	Shushice	9	3 780	11 342	3 478	10 435	1000
2	Shirgjan	7	3 528	10 585	3 246	9 738	1000
3	Gjergjan	7	2 683	8 049	2 468	7 406	1000
4	Tregan	11	1 535	4 606	1 412	4 236	1000
5	Gjinar	11	1 682	5 047	1 548	4 644	1000
6	Zavaline	6	638	1 914	600	1 801	1000
7	Bradashesh	17	4 375	13 125	4 034	12 103	1000
8	Paper	13	3 113	9 341	2 868	8 604	1000
9	Gracen	9	832	2 497	765	2 297	1000
10	Funar	9	1 021	3 063	937	2 813	1000
11	Labinot- Mal	10	1921	5 764	1 734	5 204	1000
12	Labinot- Fushe	6	2 326	6 979	2 140	6 421	1000
	<b>Shuma</b>	<b>116</b>	<b>27 450</b>	<b>82 342</b>	<b>25 234</b>	<b>75 702</b>	
					<b>Tarifohen</b>		
					<b>6 000</b>		
	<b>Shuma pergjithshme</b>						

Shifrat e pasqyruar ne tabelen e mesiperme tregojne se Niveli i tarifave të pastrimit dhe te menaxhimit te mbetjeve ne Bashkinë Elbasan jane te njejta per komunitetin dhe te ndryshme per bizneset dhe institucionet.

Në tabelën më poshtë tregohet se si kanë përfomuar Njësiti Administrative gjatë vitit 2016, 2017 dhe 2018 me mbledhjen e të ardhurave:





Të ardhurat nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbetjeve 2019 - 2024

Tabela Nr. 23

Nr	Njësiti Administrative	Per vitin 2019 - 2024 000/lek		
		Planifikuar 000/lek	Realizuar 000/lek	%
I	Njësiti Administrat. (qytet)			
	Lagjja 1			
	Lagjja 2			
	Lagjja 3			
	Lagjja 4			
	Lagjja 5			
	Lagjja 6			
II	Bizneset			
	- Biznesi vogel			
	- Biznesi madh			
	- Institucionet			
	Shuma			
IV	NJ.A zonat rurale			
	Shushice			
	Shirgjan			
	Gjergjan			
	Tregan			
	Gjinar			
	Zavaline			
	Bradashesh			
	Paper			
	Gracen			
	Funar			
	Labinot- Mal			
	Labinot- Fushe			
	Shuma			
	Shuma pergjithshme			

Atehere si rezulton performanca financiare e menaxhimit të mbetjeve në Bashkianë Elbasan per vitin 2016 - 2017 - 2018 ne baze te analizes se mesiperme?

Per Lagjet Administrative te qytetit.

A. Struktura e sherbimeve te pastrimit:

Grumbullimi e Transporti i mbetjeve urbane

Tabela Nr. 24

Nr	Bashkia Elbasan	Periudha Gusht 2016 - Gusht 2017						Kosto totale
		Sherbimet e pastrimit (Fshirje, mirmbejtje, freskim e tjere)		Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve urbane				
		Vlera e shpenzime 000 /leke	Kosto lek/per banore	Vlera shpenzime 000/leke	Sasia ton	Kosto lek/ per ton	Kosto lek/ per banore	
1	Njësiti Administrative	28 760	240	56 790	13 985	4 075	473	713



Nga perlllogaritjet rezulton:

- Per çdo Lagje Administrative te zonave urbane ( te qytetit ):

Per familjaret:

- Kosto per banore per mbuluar shpenzimet per kryerjen e sherbimeve te pastrimit te qytetit eshte 240 lek/banor.
- Ndersa kosto per banore per te kryer sherbimet e grumbullimit e transportimit te mbetjeve urbane per ne Lanfill eshte 473 lek/banor ( pa llogaritur shpenzimet qe i detyrohemi Lanfillit per depozitim e trajtimin e mbetjeve,pasi ne baze te nje kontrate paraprake nga muaji Shkurt i vitit 2016 e ne vazhdim nuk shpenzojme per kete sherbim ).
- Per mbuluar shpenzimet e pergjithshme vjetore per realizimin e Struktures se menaxhimit te integruar te mbetjeve rezulton nje kosto 713 lek/banore ose 2139 lek/familje.
- Ne baze te standarteve dhe regjistrimeve ne Gjendjen Civile rezulton se; ne Njësitet Administrative te qytetit jane te regjistruar rreth 43 314 familje qe perbejne rreth 129 942 banore te regjistruar ( perlllogaritjet jane bere me 8 % te popullsisë me pak te larguar jasht apo brenda vendit ).
- Per periudhat nga ku jemi referuar ( 2016 - 2017 ) niveli i tarifave (takse pastrimi) për nje familje ne Njësitet Administrative të Bashkisë Elbasan, te miratuar ne Keshillin Bashkiak eshte vendosur 1000 leke ne vite per nje familje,ose 333 leke per banore.

Njekohesisht ne baze te planit te te ardhurave nga kjo tarife rezulton,mbledhja e tyre duhet te llogaritet si me poshte:

- Familje te regjistruar 43 920 familje.
- Familje qe u ofrohet ky sherbim 39 920 familje x 1000 leke/familje = 39 920 leke.
- Ne baze te perlllogaritjes se kosos reale te sherbimeve 39 920 familje x 2139 lek per nje familje = 85 390 leke.
- Pra, ne baze te planifikimeve dhe pellogaritjeve te kosos se sherbimeve dhe vendosjes se ketij sistemi tarifimi rezulton qe mbulimi i kosos ze vetem 47 % nga familjaret.
- Per vitet 2016 e 2017, ne baze te faturave ( te regjistruara ne te cilat eshte perfshire pagesa e kesaj tarife nga Ndermarrja e Uje - Sjellese Kanalizimeve) rezulton se nuk jane faturuar me shume se 36 500 familje.
- Nga kjo rezulton se mbulimi i kosose eshte akoma me i ulet si.
- 36 500 familje x 1000 leke/familje = 36 500 leke.
- Ne peperfundim rezulton qe; efienca ne mbledhjen e tarifes se sherbimeve te pastrimit ne Njësitet Administrative te qytetit per familjaret llogaritet te jete 42%.

Per Njësitet Administrative te zonave rurale:

A. Sherbime grumbullimi e transoprti i mbetjeve urbane:

Tabela Nr. 25

Nr	Bashkia Elbasan	Viti 2016 - 2017 - 2018				
		Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve urbane				
		Vlera shpenzime 000/leke	Sasia e Gumbulluar e transportuar ton	Kosto lek/ton	Nr. familjeve	Kosto lek/ per banore
1	Njësitet Administrative					
	8 (tete) Njësi	14 643	3 438	4260	6 152	793

Nga perlllogaritjet rezultton:

- Per Njësitate Administrative te zonave rurale ( fshatra ):

Tabela Nr. 26

II	Njësitate zonat rurale	Nr. fshatrave		Popullsia Regjistruar		Popullsia qe kerkon sherbime		Tarifa vendosur leke familje	
		Sipas regjistri	Ofrohet sherbim	Nr. familjeve	Nr. banoreve	Nr. familjeve	Nr. banoreve		
1	Njësia Shushice	9	3	3 780	11 342	3 478	10 435	1000	
2	Shirgjan	7	6	3 528	10 585	3 246	9 738	1000	
3	Gjergjan	7	5	2 683	8 049	2 468	7 406	1000	
4	Tregan	11	2	1 535	4 606	1 412	4 236	1000	
5	Gjinar	11	1	1 682	5 047	1 548	4 644	1000	
-	Zavaline	-	-	-	-	-	-	-	
6	Bradashesh	17	11	4 375	13 125	4 034	12 103	1000	
7	Paper	13	8	3 113	9 341	2 868	8 604	1000	
-	Gracen	-	-	-	-	-	-	-	
-	Funar	-	-	-	-	-	-	-	
-	Labinot- Mal	-	-	-	-	-	-	-	
8	Labinot- Fushe	6	4	2 326	6 979	2 140	6 421	1000	
<b>Shuma</b>		<b>74</b>	<b>40</b>	<b>23 022</b>	<b>69 066</b>	<b>18 152</b>	<b>54 456</b>		
						<b>Tarifohen</b>	<b>6 152</b>	<b>18 456</b>	

1. Duhet te nenvizojme qe; nisur nga vete karakteristikat e pozicionit gjeografik dhe relievit te Njësive Administrative te zonave rurale si dhe gjendjes ekonomike sociale,nga studimet e bera per keto faktore qe ndikojne ne keto familje ka rezultuar qe jo te gjithë Njësive Administrative t;u ofrojme te gjitha sherbimet e pastrimit qe kane te bejne me menaxhimin e integruar te mbetjeve.
2. Nisur nga analizat e mesiperme, per periudhen 2016, 2017, 2018 e ne vazhdim, eshte planifikuar qe Njësitate Administrative te zonave rurale te perfshihen vetem 8 Njësi Administrative duke ofruar vetem sherbimin e grumbullimit dhe te transportimit te mbetjeve urbane.
3. Gjithashtu në funksion te shifrave te pasqyruar ne tabelen e mesiperme mbi planifikimin e fshatrave me sherbimin e grumbullimit dhe te transportimit te mbetjeve urbane, duhet theksuar se edhe ne ato Njësi Administrative te planifikuara, nuk perfshihen te gjitha fshatrat respektive, por vetem ato fshatra ne te cilat mundeson infrastruktura rrugore.
4. Njekohesisht nga skema e tarifimit jane perjashtuar dhe ato familje te cilat eshte menduar qe nuk i permbushin kriteret ekonomiko-sociale per te paguar tarifen e sherbimit.

Duke marre në analize shifrat te pasqyruar ne tabelat dhe faktore qe ndikojne ne sitemin e tarifimit dhe mbulimit te saj, nga perlllogaritjet, sipas skenareve te meposhtme rezultton:

- Sherbimi i ofruar ne Njësitate Administrative te zonave rurale, kryhet dhe menaxhohet nga Agjensia e Sherbimeve Publike prane Bashkise.
- Ne te gjithë siperfaqet e Njësive Administrative te zonave rurale jane te regjistruar sipas Gjendjes Civile rreth 82 342 banore qe perbejne rreth 27 450 familje.
- Ndersa familjet qe kane nevojë per sherbime publike jane rreth 25 234 ( duke zbritur 8% ) qe perbejne vetem 75 702 banore.



- Por nisur nga buxheti dhe faktoret që ndikojnë në mos kryerjen e shërbimit të grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane, në Njësitë Administrative të zonave rurale është planifikuar të kryhet vetëm në 8 (tete) Njësi që përbejnë 74 fshatra.
- Pra sipas të dhënave të dala nga studimi dhe planifikimi për periudhën 2016, 2017, 2018 tregon se territori i Njësitë Administrative është i mbuluar vetëm 63 % me këto shërbime.
- Por duke bërë kontrollë dhe monitorime me të detajuar në këto sipërfaqe, është planifikuar që shërbimi i grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane të bëhet në këto 8 (tete) Njësi Administrative por vetëm në 40 fshatra, nga ku rezultojnë që mbulimi me shërbime është vetëm në 35 % të territorit.
- Nga përpunimi i këtyre të dhënave rezultojnë: që sipas planifikimit, u ofrohet ky shërbim në 8 Njësitë Administrative ku përfitojnë realisht 40 fshatra, me rreth 18152 familje me rreth 54 456 banorë.
- Por nisur nga ndërtimi i skemës së tarifimit në të cilin janë përjashtuar ato familje të cilat nuk i përmbushin kriteret ekonomiko-sociale për të paguar tarifën e shërbimit, rezultojnë nga përlogaritje, se për koston e shërbimeve dhe në procesin e tarifimit duhet të përshihen rreth 6 152 familje me 18 456 banorë.
- Edhe për Njësitë Administrative të zonave rurale me miratim të Këshillit Bashkiak është vendosur që tarifa e shërbimit të jetë 1000 lekë për familje në vit.

Nga përpunimi i të dhënave sa më sipër dhe nga përlogaritjet e bëra rezultojnë:

1. Shpenzimet e përgjithshme për realizimin e shërbimit të grumbullimit dhe të transportimit të mbetjeve urbane në Njësitë Administrative të zonave rurale është 14 643 lekë
2. Sasia e grumbulluar dhe e transportuar 3438 ton ( relativisht 287 ton/muaj ).
3. Kosto për kryerjen e këtij shërbimi është 4230 lekë/ton ( ndikon largësia deri në Landfill ).
4. Kosto për banorë sipas popullsisë që u ( ofrohet shërbimi ) për mbuluar shpenzimet për kryerjen e shërbimeve të grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane është 269 lekë/banor.
5. Njehkohesisht në bazë të planit të të ardhurave nga kjo tarifë, mbledhja e tyre duhet të llogaritet si më poshtë:
  - a. Familje të regjistruar që u ofrohet shërbimi 18 152 familje x 1000 lekë/familje = 18 152 lekë ( 000/lekë ).
  - b. Familje që janë në skemën e tarifimit 6 152 familje x 1000 lekë/familje = 6 152 lekë (000/lekë ). Pra në bazë të planifikimeve dhe përlogaritjeve të kostos së shërbimeve dhe vendosjes së këtij sistemi tarifimi rezultojnë që mbulimi i kostos së vetëm 34 % nga familjarët. Në përfundim rezultojnë që, eficienta në mbledhjen e tarifës së shërbimeve të pastrimit në Njësitë Administrative të zonave rurale për familjarët llogaritet të jetë vetëm 34 %.

### **Sistemi i tarifave të menaxhimit të mbetjeve**

Per bizneset:

Ashtu siç është punuar për të vendosur një sistem tarifimi të menaxhimit të mbetjeve, për Lagjeve Administrative të qytetit e të fshatit, po ashtu është vepruar edhe për bizneset të ndryshme të shtrira në të gjithë territorin e Bashkisë.

Gjatë studimit dhe planifikimit për vendosjen e tarifave për këto biznese, krahas analizës së shumë tregues është bërë dhe kategorizimi i tarifave për çdo aktivitet të tyre.

Edhe për këto kategori përlogaritjet janë bërë në bazë të shpenzimeve për menaxhimin e mbetjeve duke ju referuar zbatimit të strukturës së shërbimeve të pastrimit të qytetit si:

1. Shërbimi i pastrimit me të gjithë proceset e saj.
2. Grumbullimi e transportimi mbetjeve urbane për në Lanffill.

Nisur nga kjo logjike e trgueseve ekonomiko - financiare, rezulton kjo skeme e ndarjes së numrit të bizneseve që ushtrojnë aktivitete në gjithë territorin e Bashkisë ( qytet e fshat ).

Tabela Nr. 27

Nr.	Bizneset	Sistemi i tarifimit		
		Nr. bizneseve	Tarifa ne/vit	Vlera 000/leke
I	Biznesi vogel			
	- Biznes me xhiro te vogel	1730	8 000	13 840
	- Biznes me TVSH	896	15 000	13 440
	- Biznes mesatar	931	20 000	18 620
II	Biznesi madh			
	- Prodhimi	219	55 000	12 045
	- Ndertimi	90	60 000	5 400
III	Institucione	117	30 000	3 510
			Shuma	66 855

### Indikatorët e performancës

Në përfundim të procesit për evidentimin e gjendjes ekzistues të shërbimit në Bashkinë Elbasan, u bë vlerësimi i performancës bazuar në indikatorët:

- Cilësia e shërbimit.
- Qendrueshmëria mjedisore.
- Qendrueshmëria ekonomike dhe financiare.

Secili nga tre indikatorët ka indikatorët e tij specifikë, të cilët u përdorën për llogaritjen e indikatorit kryesor, siç shpjegohet më poshtë:

### Cilësia e shërbimit.

Ky indikator përbëhet nga dy indikatorë specifikë.

#### 1. Mbulimi i zonës me shërbim:

Ky indikator tregon sasinë e mbetjeve të grumbulluara në Njësiti Administrative nga Operatori ekonomik ( firma private ) e autorizuar nga Bashkia njësisia vetë ( nëse nuk e kryen ajo shërbimin ) kundrejt sasisë totale të mbetjeve të gjeneruara në Njësiti Administrative.

Për këtë indikator u përdor formula për zonat urbane dhe për zonat rurale të Bashkisë Elbasan:

Kjo kosto ka dalë shumë e lartë pasi është llogaritur mbi bazën e familjeve, të cilat marrin aktualisht shërbim.

Në rastin e Bashkisë Elbasan për llogaritjen e këtij indikator, janë marrë vlerat e sasisë së mbetjeve që depozitohen në Landfillin dhe vlerat e llogaritura në sajë të normës së gjenerimit dhe numrit të popullsisë, për të llogaritur përqindjen e mbulimit të zonës me shërbim

#### 2. Pastërtia e territorit të Bashkisë:

Ky është një indikator gjithëpërfshirës, i cili vlerësohet nga tre kriterë vlerësimi:

- Efektiviteti i grumbullimit të mbetjeve (prezenca e mbetjeve të akumuara rreth VGM);
- Efektiviteti i pastrimit të rrugëve (prezenca e mbetjeve në rrugë).
- Efektiviteti i grumbullimit të mbetjeve në zonat e largëta (prezenca e mbetjeve të akumuara pika ilegale djegie të mbetjeve në rrugë).



Në përcaktimin e këtij indikator, situata është vlerësuar si nga vëzhgimet në terren në të gjitha Njësive Administrative të Bashkisë Elbasan ashtu edhe në bashkëpunim me stafin e Njësive për të na diktuar fenomene të ndryshme në lidhje me pastërtinë e territorit dhe zonat ku duhet të ndërhyhet.

### Qëndrueshmëria mjedisore.

Shkalla e kënaqësisë publike:

Ky është një indikator cilësor për shërbimin që ofron Bashkia, dhe vlerësohet në sajë të pyetsorëve të ndryshëm me komunitetin. Zakonisht ky indikator llogaritet në sajë të një pyetje të vetme:

A jeni të kënaqur me shërbimin e grumbullimit të mbetjeve që ofrohet në njësinë tuaj?

Për vlerësimin e këtij indikator kanë shërbyer fushatat e pyetsorëve dhe dëgjesat publike të zhvilluara nga bashkia.

Ne vehtvete ky indikator përbëhet nga dy indikatorë specifikë.

Shkalla e grumbullimit të diferencuar: ky indikator prezanton shkallën e sasisë të mbetjeve që grumbullohen të ndara kundrejt sasisë totale të mbetjeve të grumbulluara.

Formula për llogaritjen e këtij indikator jepet si më poshtë:

Në lidhje me llogaritjen e këtij indikator, për Lagjet Administrative të Bashkisë nuk është kryer ndonjë llogaritje pasi nuk ka iniciativa për grumbullimin e ndarë të mbetjeve.

Shkalla e mbetjeve të trajtuara sipas normave:

Ky indikator shpreh sasinë e mbetjeve që trajtohen në impiante të autorizuar.

Formula për llogaritjen e këtij indikator jepet si më poshtë:

Në lidhje me këtë indikator, të gjitha Njësive Administrative, tashmë i dërgojnë mbetjet në Landfillin ndonëse në territor ka përsëri pika ilegale ku hidhen mbetjet.

### Qëndrueshmëria ekonomike dhe financiare.

Ky indikator përbëhet nga tre indikatorë specifikë:

- Mbulimi i Kostos:

Ky indikator vlerëson; sa kosto e plotë e shërbimit e mbuluar nga grumbullimi i tarifave.

Llogaritja e këtij indikator, ashtu siç tregohet edhe në analizën financiare të gjendjes ekzistuese, është kryer në sajë të konsultave me zyrën e financës dhe të taksave në Bashki për të gjitha Njësive Administrative.

- Shkalla e mbledhjes së tarifës:

Ky indikator reflekton kapacitetin e popullsisë për të paguar tarifën.

Llogaritja e këtij indikator, ashtu siç tregohet edhe në analizën financiare të gjendjes ekzistuese, është kryer në sajë të konsultave me zyrën taksave në Bashki për të gjitha Njësive Administrative.

- Transparenca në sistemin e tarifimit:

Ky është një indikator cilësor, i cili ka tre shkallë vlerësimi:

- I ulët: nuk ka një sistem faturimi për tarifën e pastrimit.
- Mesatar: ka një sistem faturimi dhe konsumatori merr një faturë.
- I lartë: ka një sistem faturimi dhe konsumatori ka informacion dhe kupton tarifën e llogaritur dhe mënyra e llogaritjes është e qartë dhe transparente për të gjithë komuniteti.





## Planifikimi Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane

### Vizioni

Vizioni i Planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Bashkisë Elbasan u formëzua:

- Në sajë të një procesi të vazhdueshëm diskutimi dhe konsultimi midis palëve të interesuara të përfshira drejtpërdrejtë në përgatitjen e këtij Plani.
- Në sajë të analizimit gjendjes ekzistuese të ofrimit të shërbimit dhe propozimeve për konsolidimin e shërbimit në të gjithë territorin e Bashkisë.

Referuar statusit aktual të menaxhimit të mbetjeve, në kuadrin e ndarjes së re Administrative prioritetet e përgjithshme dhe konkrete konsistojnë në:

- Në pritshmëritë për zhvillimin e këtij sektori.
- Vlerave dhe normave qytetare.
- Nevojave për ndryshim.
- Ruajtjes së burimeve natyrore:

### Objektivat

Bashkia Elbasan gjatë 5 vjeçarit të zbatimit të Planit Lokal për menaxhimin e integruar të mbetjeve kërkon mbi të gjitha:

- Të konsolidojë shërbimin në zonat ku aktualisht e ofron këtë shërbim,
- Duke rritur gradualisht cilësinë e shërbimit të pastrimit dhe grumbullimit dhe transportit të mbetjeve për në Landfillin.
- Më tej ajo kërkon të fillojë të zbatojë skema për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve urbane, duke synuar mbylljen e ciklit të plotë të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve.
- Ky plan ka parashikuar hartimin e objektivave emergjente dhe objektiva afat gjatë.

Objektivat emergjente:

- Plotësim i kuadrit ligjor dhe rregullator lokal për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane.
- Miratimi i planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve;
- Hartimi i rregulloreve për shërbime të caktuara të mbetjeve, duke përcaktuar standardet minimale që duhen plotësuar;
- Adoptimi i modelit të dldp-së për llogaritjen e kostos dhe tarifave
- Përmirësimi i sistemit të klientëve dhe rifreskimi i të dhenave
- Konsolidimi i shërbimit në Njësitë Administrative në zonat rurale, si dhe zgjerimi i shërbimit në Njësitë Administrative të tjera ku aktualisht nuk ofrohet shërbim ( në masën 60% ) gjatë periudhës 2019 – 2024
- Në Njësitë Administrative ku aktualisht ofrohet shërbimi, Bashkia do të rrisë standardin e shërbimit duke përmirësuar infrastrukturën për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve.
- Në Njësitë Administrative të reja që fillojnë për herë të parë këtë shërbimin, do të mundosohen me infrastrukturë për grumbullim dhe transportin e mbetjeve.
- Reduktimi depozitimeve ilegale të mbetjeve urbane dhe sidomos të mbetjeve voluminoze.



Objektiva afatgjatë:

Nxitja e iniciativave për minimizimin e mbetjeve përmes stimulimit të grumbullimit të ndarë dhe kompostimit. Minimizimi i mbetjeve urbane që shkojnë në Landfill me 30% gjatë periudhës 2019 – 2024.

- Promovimi i ndarjes në dy rryma të mbetjeve urbane (të thata dhe të njoma) në lagjet kryesore të qytetit të Elbasanit;
- Shtrirja e e skemës në dy rryma në lagje të tjera të qytetit, deri në mbulimin e plotë e tij;
- Promovimi i skemave të kompostimit të mbetjeve në Njësite Administrative të zonave rurale
- Shtrirja e skemave të kompostimit edhe në Njëstë e tjera Administrative me karakter rural.
- Rritja e nivelit të të ardhurave nga tarifat nga njësitë, të cilat marrin shërbim me 40% gjatë periudhës 2019 – 2024.
- Informimi i qytetarëve në lidhje me shërbimet e pastrimit që do të mbulohen nga tarifa.
- Aplikimi i fushatave ndërgjegjëse në lidhje me pagesën e tarifës së pastrimit dhe rritjet progresive në sajë të përmirësimit dhe shtimit të shërbimeve për mbetjet.
- Dëgjesa publike në të gjithë territorin e Bashkisë me grupe të ndryshme interesi.
- Forcimi i kuadrit financiar të manaxhimit të mbetjeve, duke konsoliduar mekanizimin e hartimit të buxhetit për shërbimet e mbetjeve dhe hartimin e marrëveshjeve dhe kontratave bazuar në standardet e paracaktuara në rregulloret përkatëse të shërbimit.
- Sensibilizimi i komunitetit dhe bizneseve për t'u bërë pjesë e iniciativave të Bashkisë për mbajtjen pastër të territorit si dhe për aplikimin e skemave inovative për minimizimin e mbetjeve.

Rryma e mbetjeve, objekti i planit.

Sipas legjislacionit në fuqi ky plan do të fokusohet në rrymën e mbetjeve Bashkiake (urbane) për të cilën Bashkia Elbasan është drejtpërdrejt apo pjesërisht përgjegjëse:

Sipas përbërjes dhe mënyrës së manaxhimit të mbetjeve, mbetjet bashkiake do të klasifikohen në:

- Mbetje urbane (mbetje shtëpiake, ushqime, bimë, të riciklueshme, të dekompozuar, etj.
- Mbetje të veçanta urbane (mbetje ndërtimet dhe prishjet, voluminoze, pajisje elektrike dhe mobiljesh, etj.) që prodhohen nga familjet apo njësitë tregtare.
- Mbetje të rrezikshme që prodhohen brenda territorit të bashkisë nga banorë të përhershëm apo të përkohshëm.

Sipas burimit të gjenerimit mbetjet urbane (bashkiake) klasifikohen në dy rryma:

1. Mbetjet e gjeneruara nga familjet (MF).
2. Mbetjet e gjeneruara nga bizneset dhe institucionet (MB), ku përbërja e mbetjeve nuk ndryshon nga karakteristikat e mbetjeve urbane.

Ndërkohë, rryma të tjera të mbetjeve klasifikohen si mbetje masive, mbetje nga ndërtimet dhe prishjet ( inerte ), mbetje nga kopshtet që prodhohen në familje dhe që quhen 'mbetje të veçanta, për të cilat njëzia vendore duhet t'i ofrojë e vetme ose në bashkëpunim alternativa të përshtatshme për grumbullimin dhe transportin e tyre, megjithëse largimi i tyre është përgjegjësi direkte e prodhuesit.

Zona e Administrimit të Mbetjeve (ZAM) dhe përfituesit e shërbimit të pastrimit.

Në funksion të organizimit më të mirë të shërbimeve dhe efijencës së sistemit që do të propozohet, zonat e mbetjeve ose zona brenda kufijve administrative të Bashkisë do ndahet në nën-zona mbetjesh që kanë diferenca në lidhje me:



- Tipologjinë urbane.
- Infrastrukturën rrugore.
- Lloji i konsumatorëve.

Kjo është e rëndësishme që sistemet dhe metodat që do të identifikohen dhe analizohen në vijim të këtij plani të përshaten më mirë me qëllim e rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve.

Kjo do të shërbejë për të planifikuar infrastrukturën e nevojshme për skemat e mbledhjes dhe transportit, si dhe shërbime të tjera të ngjashme apo organizimin e programeve për minimizimin e mbetjeve.

Për këtë qëllim, zona e mbetjeve ndahet në këto nënzona:

Nën-zona e parë:

Në këtë nën-zonë do të kategorizojmë zonat me dendësi të lartë popullesie si dhe zonat me tipare të ngjashme me zonat urbane.

Referuar metodologjisë për këtë zonë do të konsiderojmë:

- Kryerjen e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve per çdo ditë ( 7 ditë/javë ).
- VGM do të jenë të shpërndara në mënyrë uniforme kryesisht çdo 50- 100 m nga njëri-tjetri, konkretisht në Njësitate Administrative te qytetit.

Nën-zona e dytë:

Kjo nën-zonë do të kategorizohen nga pjesë të territorit me tipare rurale fushore me numër jo të lartë banorësh, ku shërbimi parashikohet të kryhet:

- Mesatarisht 2-3 herë në javë dhe distanca midis PGM do të jetë 150-200 m larg njëri-tjetrit. Në këtë nën zonë parashikohen të jenë disa Njësitate Administrative .

Nën-zona e tretë:

Do të kategorizohen zonat malore apo ato të thella dhe me dendësi të ulët popullesie.

- Në këto zona shërbimi do të jetë i rrallë ( 1 herë në javë ose 2-3 herë në muaj në varësi të sasisë dhe distancave ) dhe distanca e PGM do të jetë mbi 300 m, pasi do të jenë pika grumbullimi në distancë të madhe nga njëra tjetra ( një për çdo fshat ).

### Shërbimet e menaxhimit të mbetjeve.

Në këtë plan 5 vjeçar, Bashkia Elbasan, parashikon keto shërbime kryesore të menaxhimit të integruar te mbetjeve urbane, të cilat konsistojnë në:

- Shërbimi i pastrimit, fshirjes, mrembajtjes e freskimit të rrugëve.
- Shërbimi i grumbullimit, transportit i mbetjeve.
- Depozitimi i mbetjeve në Landfillin.
- Shërbimi i minimizimit të mbetjeve.

Të katër këto shërbime pasi do të shpjegohen shkurtimisht më poshtë, do të përfshihen në dy skenarët e propozuar nga Bashkia për organizimin e shërbimit në territorin e saj gjatë viteve 2019- 2024.

Shërbimet e pastrimit ne infrastrukturën rrugore dhe sipërfaqet urbane

Organizimi i shërbimeve të pastrimit sipas nje strukture.

- Struktura duhet të marrë në konsideratë:
  - Nevojat për pastrimin e rrugëve dhe shkallën e ndotjes ditore nga mbetjet dhe hedhurinat, apo brenda një periudhe të caktuar ditësh.
  - Për këtë qëllim propozimi i frekuencave për secilën kategori rrugësh duhet të jetë objekt i një vlerësimi apo testi deri në përcaktimin përfundimtar në specifikime teknike te mundshme në rast se ky shërbim do të kontraktohet në të ardhmen.
  - Një element shumë i rëndësishëm në organizimin e shërbimeve të pastrimit të rrugëve është edhe kategorizimi i rrugëve në funksion të rëndësisë si më poshtë:

### 1. Kategoria e Parë.

- Përfshin rrugët kryesore dhe rrugët tregtare për të cilat nevojitet:
  - Shërbimi i fshirjes manuale me frekuenca për çdo ditë.
  - Është më i parapëlqyer pastrimi me makinë teknologjike të akseve kryesore ( kur është e mundur dhe ka efektivitet ).
  - Shërbimi i mirëmbajtjes tyre gjatë ditës, me frekuenca për çdo ditë.
  - Grumbullimi i mbetjeve në VGM.
  - Pastrimi ditor i kontenierëve të mbetjeve urbane.
  - Shërbimi i larjes dhe freskimit, me makinën teknologjike.

### 2. Kategoria e dytë.

- Përfshin rrugët kryesore me aktivitet të ulët komercial dhe me densitet të ulët kalimtar për të cilat nevojitet:
  - Kryerja e procesit të fshirjes manuale të rrugëve me frekuenca për çdo ditë.
  - Shërbimi i mirëmbajtjes tyre gjatë ditës, me frekuenca për çdo ditë.
  - Grumbullimi i mbetjeve në VGM.
  - Pastrimi ditor i kontenierëve të mbetjeve urbane.

### 3. Kategoria e tretë.

- Sistem rrugor periferik në zonë me dendësi të ulët urbane, apo në zonë me infrastrukturë jo të rregullt dhe rrugë të paasfaltuara është i nevojshëm:
  - Një shërbim mujor pastrimi, fshirje ose thjesht mbledhje mbetjesh dhe hedhurinash. Nisur nga studimi mbi kategorizimin e rrugëve dhe planifikimin e tyre për shërbime pastrimi, aktualisht Bashkia Elbasan ka përfshirë.
  - Rreth 30 rrugë ( kategoritë të parë ) në procesin e fshirjes me krah ( fshesare ) sipërfaqet e të cilave kanë një volum pune ditor rreth 300 000 m<sup>2</sup>. Për realizimin e këtij shërbimi, mesatarisht janë të anagzhuar 40 punëtorë ( fshesare ) të cilët kanë një normë ditore pastrimi prej 8500 m<sup>2</sup>/ditë/punëtor. Ky shërbim kryhet me frekuenca për çdo ditë me një turne, dhe Bashkia kërkon ta mbajë këtë standard edhe gjatë 5 viteve të ardhshme.
  - Krahas procesit të "Fshirjes me krah" në strukturën e shërbimeve të pastrimit është parashikuar edhe procesi i "Mirëmbajtjes së pjesëshme". Ky shërbim kryhet me frekuenca për çdo ditë duke realizuar një volum pune prej 320 000 m<sup>2</sup>. Në bazë të monitorimeve rezultojnë se një operator ( mirëmbajtjes ) duhet të kryejë rreth 32 000 m<sup>2</sup> volum pune si normë ditore
  - Bashkia synon të rrisë cilësinë dhe performancën e shërbimeve të pastrimit, prandaj ajo ka vendosur të planifikojë në disa rrugë të kategoritë të parë për kryerjen e shërbimit të "Larjes dhe freskimit" e këtij shërbimi. Ky shërbim aktualisht kryhet nga një autobot me frekuenca për çdo ditë, vetëm në periudhën Prill-Tetor.

Për këtë qëllim Bashkia Elbasan krahas studimeve dhe planifikimit të sipërfaqeve të pastrimit ka përgatitur dhe hartat përkatëse për çdo rrugë dhe sipërfaqe urbane.

### Shërbimet e Grumbullimit të transportit të mbetjeve

Bashkia Elbasan në planifikimin e parashikimin e shërbimeve të grumbullimit dhe transportit të ka marrë në konsideratë parimin për reduktimin e mbetjeve të gjeneruara dhe parandalimin e ndotjes.

Cilësia dhe kostot e shërbimit të mbledhjes dhe largimit të mbetjeve urbane lidhen drejtpërdrejtë me mënyrën se si sillen konsumatorët në:

- Hedhjen e mbetjeve urbane.
- Perdorimin e Vend - grumbullimeve.
- Respektimin e orareve të përcaktuara.
- Zbatimin e rregullave lokale për menaxhimin e mbetjeve.



Per te arritur keto standarte Bashkia duhet të plotësojë kuadrin e saj rregullator në:

- Hartimit të një rregulloreje vendore për manaxhimin e mbetjeve, ku do të përcaktohen procedurat, protokollet e punës, parashikimet se çfarë do të ndodh në rast avarish apo aksidentesh në punë, të drejtat dhe detyrimet e të gjitha grupeve të interesit të përfshira në menaxhimin e mbetjeve si dhe sanksionet përkatëse në rast të shkeljeve të evidentuara.
- Si parakusht, Bashkia duhet të caktojë një grup pune për monitorimin dhe për të vënë në zbatim këto rregulla.
- Parandalimin e hedhjes së paligjshme dhe derdhjen e mbetjeve jashtë kontenierëve gjë që duhet të sjellë në vëmendje rëndësinë kryesore që kanë fushatat e ndërgjegjësimit dhe programet e edukimit;
- Marrëveshje me konsumatorët e mëdhenj, për të përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrimet e secilës palë, ku rekomandohet vendosja e orareve në ditë dhe orë të caktuara për dorëzimin e mbetjeve nga konsumatori në pikat e caktuara nga bashkia, ose grumbullimi i tyre nga bashkia, në sajë të një kontrate të veçantë, në pikat e gjenerimit të tyre.

Ndërkohë elemente të tjerë që kanë të bëjnë me shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve, që Bashkia duhet të marrë në konsideratë gjatë planifikimit të shërbimit në territorin e saj, janë si më poshtë:

1. Orare pune efektive dhe të përshtatshme:

- Për të operuar sipas nevojave të pastërtisë dhe në mënyrë të efektshme dhe me kosto të ulët, Bashkia duhet të hartojë një program efektiv dhe të përshtatshëm pune.
- Ky program duhet të marrë parasysh ndryshimet ditore, javore dhe mujore në lidhje me numrin e banorëve dhe veprimtarive tregtare.

2. Numri i duhur i kontenierëve:

- Për të ofruar një shërbim të efektshëm dhe me kosto të ulët, Bashkia duhet të sigurojë numrin e duhur të kontenierëve apo koshave dhe rregullsinë e mbledhjes së mbetjeve.

3. Itenerar efektiv për mbledhjen e mbetjeve:

- Përcaktimi i saktë i itenerarit për makinat e mbetjeve do të ulë koston duke pakësuar forcat që shpenzohen për mbledhjen e mbetjeve. Rekomandohet verifikimi i përputhshmërisë me parimet e efektshmërisë së itenerarit të grumbullimit të mbetjeve si dhe të kohës efektive me metodën MTM–Metodës të Matjes së Kohës.

4. Rritja e rendimentit në punë:

- Bashkia apo kompanitë private duhet të gjejnë mekanizma për të përmirësuar punën duke rritur rendimentin. Masat që mund të ndërmerren për të rritur moralin, përfshijnë përmirësimin e kushteve të përgjithshme të punës, pajisja me uniformë, stimujt për punë të mirë, trajnimi dhe forcimi i punës në gup.

5. Mirëmbajtja e përshtatshme e kontenierëve, makinave për grumbullimin dhe transportit të mbetjeve:

- Mirëmbajtja dhe riparimi i specializuar i makinave dhe pajisjeve janë çështje të rëndësishme për shërbimin e mbledhjes së mbetjeve. Pavarësisht nëse shërbimi ofrohet nga Bashkia apo kontraktohet një kompani private, Bashkia duhet të përcaktojë ose parashikojë në kontratë mirëmbajtjen e duhur dhe standardet e riparimit që duhet të vihen në zbatim. Referuar gjëndjes aktuale të shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve si dhe eksperiencës, arritjeve dhe problematikës të identifikuar në kapitujt e mëparshëm të këtij plani, nënvizojmë se shërbimi i ofruar në qytetin e Elbasanit është më mirë se në zonat urbane se sa ato rurale.





- Duke kaluar në një përfaqje teknike, ekzistojnë mënyra të ndryshme për grumbullimin, ruajtjen dhe transportin e mbetjeve në funksion të kategorive të konsumatorëve dhe tipologjisë urbane të zonave të banuara.
- Sipas legjislacionit aktual dhe tipologjisë së zbatuar më së shumti për mbledhjen e mbetjeve, Bashkia është përgjegjëse për të mbledhur vetëm "mbetjet urbane", sipas përcaktimeve të dokumentave ligjorë dhe të këtij plani.
- Mbetje të tjera që ndryshojnë në përmbajtje ( përbërje ) nga mbetjet urbane nuk pranohen nga sistemi i Bashkiak për grumbullimin e mbetjeve. Për disa mbetje të ashtuquajtura "të veçanta" që prodhohen nga banorët mund të organizohen metoda për grumbullimin e tyre në mënyrë të diferencuar nga sistemi publik, bazë Bashkiak.
- Ekzistojnë kufizime të tjera për përdorimin e sistemit bazë Bashkiak të grumbullimit të mbetjeve që lidhet me madhësinë dhe sasinë e mbetjeve veçanërisht nga konsumatorët jo-banorë. Duke iu referuar përcaktimeve ligjore ( Neni 12 i Ligjit Nr. 8094, datë 21.3.1996 ), konsumatorët jo-banorë që prodhojnë mbi  $\frac{1}{4}$  e sasisë që mund të hidhet në një kontenier mbetjesh ( zakonisht 1.1m<sup>3</sup> ) nuk lejohen të përdorin sistemin publik të grumbullimit të mbetjeve. Autoritetet vendore apo personat përgjegjës për grumbullimin e mbetjeve duhet të ofrojnë mundësi dhe metoda të tjera për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve, në përmbushje të kërkesave dhe nevojave të konsumatorëve, shoqëruar me një sistem të ndryshëm tarifash.
- Në lidhje me përcaktimin e infrastrukturës së nevojshme për zbatimin e skemës së përbashkët për grumbullimin e mbetjeve, duke marrë në konsideratë numrin e popullsisë sipas formulës të llogaritur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe qëllimit për mbulimin e të gjithë territorit të Bashkisë më shërbim, u realizua analiza për llogaritjen e infrastrukturës së nevojshme: kontenierë dhe makina teknologjike. Si fillim u përcaktua kapaciteti i përshtatshëm i kontenierëve si dhe frekuenca e dëshirueshme e shërbimit.
- Për vete tipologjinë e territorit e saj Bashkia preferon mjete teknologjike 10 ton dhe mjete të thjeshta me kapacitet 3 ton, dhe vetëm në rastin e zonave rurale mund të përdorin mjeteve ( hapura ) teknologjike 5ton.

### Trajtimi dhe depozitimi përfundimtar i mbetjeve.

#### Trajtimi i mbetjeve:

- Sipas ligjit për Vetqeverisjen Vendore, Bashkite kanë si funksion shërbimet e menaxhimit të mbetjeve, krahas grumbullimit e transportit kerkohet dhe trajtim final të tyre.  
Në këtë llogjikë, rekomandohet që autoritetet vendore të rehabilitojnë vend-depozitimet e pakontrolluara dhe të parashikojnë depozitimimin e mbetjeve në Landfilllet rajonale të ardhshme apo ato ekzistuese në qarqet përkatëse.
- Prej disa viteve Lagjet Administrative Elbasan dhe Njësitë e tjera Administrative të zonave rurale i depozitojnë mbetjet urbane në vend-depozitimimin ( Landfillin ) pranë shtratit të lumit Shkumbin dhe Varrezave Publike, sipërfaqe kjo publike e cila administrohet nga vete Bashkia.
- Në këto vend-depozitim ( qysh nga vitet 1980 ) bëhet thjesht depozitimi, por trajtimi dhe manipulimi sipa standarteve teknike bëhet me sipërmarrje një kosto përkatëse.
- Duhet të theksohet edhe pse vëmendja e Bashkisë ka qenë maksimale në drejtim të menaxhimit të këtij objekti, ndikimet në mjedis kanë qenë vazhdimisht të pranishme dhe me kosto për shëndetin e banorëve të NJA Elbasan.





- Gjatë gjithë kohës Bashkia Elbasan dhe në veçanti kembengulja e Kryetarit të Bashkisë ka bërë përpjekje maksimale për ngritjen e një Lndfilli (incenerator) në Qarkun e Elbasanit për depozitim dhe trajtimin e mbetjeve urbane me metoda ekologjike.
- Aktualisht (qysh nga 16.02.2016) depozitimi i mbetjeve urbane për NJA Elbasan kryhet në Landfillin e ri (dampa e TEC) ku gjitha Njësitë Administrative të qytetit të zonave rurale dhe me gjere depozitohen dhe trajtohen në këtë Landfill.

### Minimizimi i mbetjeve.

Për minimizimin e mbetjeve urbane në zbatim dhe të VKM nr. 48, datë 25.06.2017 "Për grumbullimin e ndarë të mbetjeve në burim", në kemi përcaktuara disa objektiva, të cilat duhet të plotësohen nga Bashkia Elbasan - të deri në vitin 2020.

Konkretisht:

1. Lagjet Administrative të qytetit, deri në fund të vitit 2020, duhe të grumbullojnë në mënyrë të diferencuar, të paktën mbetje të letrës, metalit, plastikës dhe qelqit.
2. Brenda vitit 2020, ato duhet të arrijnë normën e riciklimit me 50% të sasisë të mbetjeve të viteve 2017 - 2018.
3. Brenda vitit 2020, sasia e mbetjeve që shkojnë në Landfill do të jetë 50 % e sasisë së mbetjeve që prodhohet, dhe pjesa tjetër duhet të shkojë për riciklim, kompostim apo për rekuperim me energji.

### Riciklimi i mbetjeve.

Riciklimi është një nga elementet themelore të minimizimit të mbetjeve, e cila kërkon një përpjekje të përbashkët dhe të krduar të të gjithë aktoreve vendore.

Në zbatim të politikave të menaxhimit të mbetjeve, duhet të përfshihen në Planet Vendore këto veprimtari:

- Si ta bëjmë sistemin sa më funksional? ku përfshihen:
  - Masat përgatitore.
  - Të sigurohet afersia me tregun e riciklimit.
  - Të analizohen përfitimet ekonomike.
  - Ndergjegjesimi i komuniteti dhe pëfshirja e të gjithë aktoreve për riciklim.
  - Sigurimi i burimeve financiare.
  - Të sigurohet cilësia e produkteve.

Pavarësisht mungesës së eksperiencës së autoriteteve lokale dhe operatorëve të mbetjeve si dhe vetë komunitetit për të ndarë mbetjet, Bashkia Elbasan, ka shprehur vullnetin e saj për fillimin e skemave të ndarjes së mbetjeve në burim në rrugë kryesore (pilot) në qytetin e Elbasanit e të shkollat 9-vjeçare dhe të mesme të qytetit (me katër rryma për mbetjet e riciklueshme: letër, qelq, plastikë, metal)

- Sistemi parësor i ndarjes:

Njihet gjerësisht si ndarja në burim dhe jep rezultatin më të mirë të ndarjes. Ndarja në burim i referohet ndarjes së materialeve të riciklueshme dhe të ripërdorshme në pikën e prodhimit të tyre.
- Sistemi dytësor i ndarjes:

Nënkupton ndarjen e tyre në PGM publike të grumbullimit të tyre. Bashkia Elbasan do të fillojë me sistemin dytësor të ndarjes në burim me pesë rrugë kryesore të saj, në shkollat e qytetit dhe në disa Njësi Administrative të zonave rurale.

Më poshtë jepet një përshkrim se si funksionojnë këto sisteme.

Sistemi parësor – skemat individuale të ndarjes së mbetjeve:

Sistemi i mbledhjes individuale nga familjet dhe bizneset përbën bazën për ngritjen e sistemit të ndarjes së mbetjeve. Duhet thesuar se sistemi i ndarjes në burim duket më i preferueshëm sesa sistemi i ndarjes së mbetjeve në rrugë.

- Nga këndvështrimi i angazhimit të drejtpërdrejtë të pronarëve apo personave të kontaktit të bizneseve apo familjeve, ky sistem siguron më shumë ndërgjegjshmëri, efektivitet dhe mundësi financimi sesa sistemi i hapur mbi të cilin mbështetet skema e përbashkët.
- Ndarja në burim mund të jetë më praktike dhe e efektshme për biznesin dhe industrinë, ku duhet të mundësohet shërbimi individual i grumbullimit të mbetjeve.
- Kontenieret për ndarjen e mbetjeve në burim mund të vendosen në çdo njësi të madhe biznesi apo institucion shtetëror duke ndjekur të njëjtën teknologji si sistemi i mbledhjes individuale. Sistemi duhet të jetë sa më i thjeshtë duke synuar vetëm ato mbetje apo komponentë që mund të riciklohen.
- Për këtë arsye, sistemi me katër kontenierë të vegjël duket më i favorshëm se të tjerët. Kjo nënkupton caktimin e një kodi me ngjyra për alternativën me katër kontenierë që konsumatorët ta kenë parasysh, kur vendosin të depozitojnë mbetjet aty.

Sistemi dytësor – skemat e përbashkëta për ndarjen e mbetjeve:

- Përdorimi i sistemit aktual të grumbullimit të mbetjeve urbane shërben si një bazë për të vënë në funksionim dhe prezantuar sistemin e mbledhjes së diferencuar të tyre. Kjo mënyrë mund të jetë praktike vetëm kur qytetarët dhe bizneset janë mësuar me këtë lloj sistemi dhe do të mund të përshtaten më mirë.
- Kjo metodë është e preferueshme kryesisht në qytete të mëdha ku është i pamundur krijimi i sistemeve individuale për ndarjen e mbetjeve dhe blloqet e banimit janë kolektive.
- Sektori informal, i cili është krahu kryesor i punës në sektorin e grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme nuk është plotësisht në vëmendje nga strukturat shtetërore.

Ky sektor sjell mjaft dobi në sektorin e menaxhimit të mbetjeve, si:

- Ul mesatarisht deri 15-30% sasinë e mbetjeve që depozitohen në Landfill.
- Ul koston e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve.
- Është burim të ardhurash për rreth 2% të popullsisë së zonave të varfra.
- Sipas shifrave nga literatura e huaj llogaritet që çdo ton mbetje e riciklueshme e grumbulluar është e barabartë me një vend pune. Ashtu si hierarkia e përgjithshme e menaxhimit të mbetjeve, edhe menaxhimi i mbetjeve të riciklueshme duhet të mbështetet në një hierarki të ngjashme, ku objektivi kryesor është parandalimi sa më shumë i gjenerimit të mbetjeve.
- Riprodhimi i mbetjeve të riciklueshme
- Grumbullimi i mbetjeve të riciklueshme nga tregtarët
- Mbledhësit formalë të mbetjeve të riciklueshme
- Grumbulluesit fillestarë të mbetjeve të riciklueshme

### Kompostimi i mbetjeve.

Një argument i rëndësishëm në favor të kompostimit është fakti se pothuajse Njësite Administrative të Bashkisë Elbasan, duke përjashtuar ato qytetin e Elbasanit, i cili ka karakter urban, pjesa tjetër ka karakter suburban dhe kryesisht rural, dhe sasia e mbetjeve organike, kryesisht nga kopshtet, bujqësia apo blegtoria në zonë, përbëjnë një sasi të konsiderueshme për zhvillimin e Kompostimit familjar ( individual ) dhe kolektiv.

Bashkia mund ta përdorë produktin e kompostit në bujqësinë e zonës, apo për lulishtet e qytetit.



Kompostimi në nivel individual.

Paraqet një nga metodat më të parapëlqyera të kompostimit që rekomandohet për t'u përdorur në familjet në zonat suburbane apo rurale.

- Kjo metodë është më pak e kushtueshme dhe më e efektshme se sa transferimi i mbetjeve organike në pikën e mbledhjes dhe më pas transportimi i tyre në Landfill, ku përfshihen edhe depozitimi si dhe të gjitha kostot e tjera që shoqërojnë këto procese.
- Ky proces është mjaft i rëndësishëm nga ana mjedisore, pasi ul ndjeshëm sasinë e mbetjeve që hedhin familjet për trajtim final, duke ulur në këtë mënyrë edhe koston transportit dhe të trajtimit final të mbetjeve.
- Në rastin e mbetjeve drusore, të cilat në zonat sub-urbane/rurale janë të shumta, Bashkia mund të ofrojë shërbimin e copëtimit ( grirjes ) për familjet që ndërmarrin një nismë të tillë, duke copëtuar mbetjet drusore, disa herë në vit.

Kompostimi në mjedis të hapur ( kolektiv ).

- Përveç kompostimit në nivel individual, një ndër metodat më të përshtatshme për kushtet dhe koston relativisht të ulët që ka, mund të jetë kompostimi në mjedis të hapur ( kolektiv ).
- Kjo metodë nuk ka një kosto të lartë për investimin fillestar dhe mund të japë rezultate mjaft të favorshme, jo vetëm për uljen e sasisë së mbetjeve që shkojnë për trajtimin final, por edhe në prodhimin e një sasive të konsiderueshme komposti si pleh organik, që mund të përdoret nga Bashkia për qëllime publike.

**Ndarja e mbetjeve urbane.**

Planifikimi dhe zhvillimi i skemave për ndarjen e mbetjeve duhet të marre në konsiderat dhe të bazohet në këto çështje:

1. Sa e rëndësishme është ndarja e mbetjeve për prioritetet vendore?
2. Ç'fare mbetjesh, sa mbetje cila është perberjeja e tyre.?
3. Cilat janë skemat më të përshtatshme dhe efektive që përshtaten me realitetin tonë?

Kryesisht këto çështje duhet të qartësojnë dhe të zgjidhin:

- Mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit
- Maksimizimin e ndarjes dhe reduktimin e vëllimit të mbetjeve urbane
- Reduktimi i kostos së Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve
- Ç'fare ndahe,sa duhet dhe a ka interes për to.
- Ku gjendet sasia më e madhe e këtyre mbetjeve.
- Ç'fare skeme do të përdoret, madhësia e projekteve
- Numri i rrymave të mbetjeve që do të ndahen
- Përcaktimi i metodologjive në nivel vendor.

**Manaxhimi i mbetjeve voluminoze ndërtimore.**

Sipas kuadrit ligjor në fuqi për administrimin e mbetjeve ( VKM nr.575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte") është përgjegjësia e prodhuesit ( familje, biznes apo industri ) që të largojë dhe transportojë mbetjet inerte (mbetjet nga ndërtimi dhe prishjet ), ndërtimore apo voluminoze që mund të gjenerojë nga aktiviteti që kryen për në vendet e përcaktuara nga pushteti vendor për këtë qëllim. Ndonëse ekziston ky kuadër ligjor, i cili përcakton mjaft mirë detyrat për secilin aktor të përfshirë në këtë fushatë, Bashkia e përcaktuar një vend depozitimin provizor për mbetjet inerte.

- Në kuadrin ligjor theksohet se këto vende të përcaktuara për depozitimin e mbetjeve inerte/ ndërtimore/voluminoze duhet të jenë të pajisur me leje mjedisore të posaçme



dhe duhet të pranojnë vetëm këto lloj mbetjesh, dhe jo përzjerje apo përpunime të këtyre mbetjeve me elemente të tjerë, pasi ato mund të jenë të rrezikshme.

- Të gjitha venddepozitimet e mbetjeve inerte kanë të njëjtën mënyrë operimi si Landfilllet për mbetjet urbane, ku gjeneruesi i mbetjeve duhet të paguajë një tarifë kundrejt sasisë së mbetjeve inerte që transportohet, e cila mbulon koston e operimit të fushës, trajtimit të tyre dhe mbylljen përfundimtare të saj.
- Ndërkohë ndalohet ndërtimi i vend-depozitimeve të përkohshme të mbetjeve inerte nga njësitë e qeverisjes vendore në zonat e mëposhtme:
  - Zonat e mbrojtura, arkeologjike, turistike apo në çdo zonë që mbrohet me një akt normativ.
  - Zonat në distancë 300 metra nga një pus furnizues me ujë dhe çdo burim tjetër ujor;
  - Zonat në distancë 100 metra nga një përrua, argjinaturë lumore, liqen, lum ose kompleks ligatinor.
  - Zonat në distancë 300 metra nga një zonë e mbrojtur në përputhje me pikën e parë.
- Landfilllet e mbetjeve inerte mund të jenë Landfille vendore, të cilat shërbejnë për trajtimin e mbetjeve të prodhuara brenda territorit të një NJQV-je ose Landfille rajonale, të cilat shërbejnë për trajtimin e mbetjeve të shumë NJQV-ve.
- Njësitë e qeverisjes vendore mund të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për përcaktimin e vendit, ku do të ndërtohet Landfilli rajonal dhe të mënyrës së funksionimit të tij. Operatorët, të cilët merren me trajtimin e mbetjeve në Landfille dhe venddepozitimet e përkohshme të mbetjeve inerte, janë të detyruar të raportojnë pranë NJQV-ve dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për të dhënat e mbetjeve që trajtojnë.
- Në mënyrë të veçantë, ka një treg ripërdorimi për agregatet që rrjedhin nga mbetjet e ndërtimeve në rrugë, kanalizime dhe projekte të tjera ndërtimi. Nëse nuk ndahen që në burim apo nuk transportohen veçmas, ato mund të përmbajnë sasi të vogla të mbetjeve të rrezikshme, përzjerja e të cilave mund të paraqesë rrezik të veçantë për mjedisin dhe mund të pengojë riciklimin.
- Shpesh herë mbetjet inerte përzihen me mbetjet urbane dhe më pas depozitohen në Landfillin i cili nuk është parashikuar të përdoret vetëm për depozitimin e mbetjeve urbane. Nga ana tjetër gjeneruesit e mbetjeve inerte shpesh herë i shkarkojnë ato në vende ilegale, atje ku të munden. Bashkia duhet të përcaktojë një zonë të caktuar në territorin e saj, ku të gjithë gjeneruesit e mbetjeve inerte të mund të dërgojnë mbetjet e tyre në këtë pikë dhe jo t'i hedhin ato në PGM të mbetjeve urbane apo në depozitime ilegale.

## Studime dhe propozimet për realizimin e Planit Vendor 2020 - 2024 e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane

Hyrja në fuqi e reformës territoriale u shoqërua edhe me një riorganizim të shërbimeve publike, ku njëri prej tyre është edhe ai i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve.

Aktualisht Bashkia Elbasan ka nënshkruar në vijimesi kontrata me Operator ekonomik (kompanitë private të shpjeguara si më lart), për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve, për kohezgjatje të ndryshme (deri në fund të vitit 2019)

Pas përfundimit të këtyre kontratave Bashkia do të bëjë një riorganizim nga ku :

- Do të ridimensionohen zonat e shërbimeve, duke menduar ndarjen e tyre në disa në zona në të gjithë territorin e saj.
- Për ofrimin e një shërbimi me standarde sa më të larta.
- Me kosto optimale dhe të përballueshëm nga taksa paguesit.
- Për të synuar mbulimin e plotë të kostonë së shërbimit.



Tashme eshte pergatitur Plani i Menaxhimit te Integruar te Mbetjeve sebashku me dokumentacioni ne te cilin jane pasqyruar te gjithe elementet e menaxhimit te sherbimeve te pastrimit dhe te grumbullimit dhe transportimit te mbetjeve urbane. Njekohesisht dhe te gjitha perlllogaritjet mbi shpenzimet e pergjithshme qe kerkejne keta sherbime.

Per hartimin e Planit Lokal te Menaxhimit te Integruar te Mbetjeve Urbane, Bashkia Elbasan propozon ate skenar per te cilin perlllogaritjet e kosos jane kryer sipas modelit te dldp, nga ku ka bere edhe studimet per rritjen e tarife se sherbimeve.

### Propozimet.

Nga vete pozicioni i ketyre Njësive Administrative te shtrira ne siperfaqet urbane te qytetit si dhe ne baze te numrit te banoreve, si dhe nisur nga studimet per kete qellim rezulton se per arritjet e standarteve mbi Menaxhimin e Integruar te Mbetjeve dhe ofrimin e sherbimeve publike per komunitetin Zonat ku do te kryhen sherbimet ( e kontrates ) te ndahet si me poshte:

Per Lagjet Administrative te qytetit:

Zona e pare:

Tabela Nr. 29

Nr	Nenzonat	Lagjet Administrative	Lagjet	Gjeneruesit ( popullsia)	
				Nr. Familjeve	Nr.Banoreve
1	Nenzona pare	I	- Luigj Gurakuqi	2320	6960
		I	- Kongresi Elbasanit	1350	4050
		III	- 28 Nentori	2960	8880
		IV	- Kala	650	1950
		<b>Shuma</b>	<b>4 lagje</b>	<b>7280</b>	<b>21840</b>
2	Nenzona dyte	III	- Dyli - Haxhire	2364	7092
		IV	- Partizani	2094	6282
		IV	- Aqif Pasha	2324	6972
		IV	- Visarion Xhuvani	2310	6930
		<b>Shuma</b>	<b>4 lagje</b>	<b>9092</b>	<b>27276</b>
3	Nenzona trete	V	- Vullnetari	846	2538
		V	- Haxhias	1540	4620
		V	- 11 Nentori	1747	5241
		VI	- 5 Maji	7374	22122
		<b>Shuma</b>	<b>4 lagje</b>	<b>11507</b>	<b>34521</b>
<b>Shuma totale</b>			<b>12 lagje</b>	<b>27 879</b>	<b>83 637</b>



Zona e dyte:

Tabela Nr. 30

Nr	Nenzonat	Lagjet Administrative	Lagjet	Gjeneruesit ( popullsia)	
				Nr. Familjeve	Nr.Banoreve
1	Nenzona pare	I	- Emin Matraxhiu	2440	7320
		I	- Beqir Dardha	1360	4080
		II	- Qemal Stafa	1250	3750
			<b>3 lagje</b>	<b>5050</b>	<b>15150</b>
2	Nenzona dyte	II	- Çlirimi	1560	4860
		II	- Shenkoll	2030	6090
		II	- Brigada 17	1070	3210
		II	- Sule Papri	1841	5523
			<b>4 lagje</b>	<b>6501</b>	<b>19503</b>
3	Nenzona trete	III	- Syrja Dylgjeri	1350	4050
		III	- Skenderbej	2534	7602
			<b>2 lagje</b>	<b>3884</b>	<b>11652</b>
<b>Shuma totale</b>			<b>9 lagje</b>	<b>15435</b>	<b>46305</b>

Theksojme se referuar pozicinit gjeografik te Bashkise Elbasan, si dhe shtrirjes teritoriale te sipërfaqeve urbane dhe infrastruktures rrugore te Njësive Administrative, keto zona dhe nenzona sherbimi jane percaktuara duke marre ne konsiderate keto standarte:

- Per te patur sa me shume efektivitet dhe produktivitet ne kryerjen e sherbimeve.
- Per rritjen e cilesise se sherbimeve.
- Lagjet Administrative ne zonat urbane te qytetit.

I. Shërbimet që do të përfshihen në këtë Skenar:

Në Njësive Administrative te qytetit e ndare ne dy nenzona (qe perfaqesojne pjesen veriore dhe jugore te qytetit me vije ndarese rruga kryesore "Qemal Stafa", do të ofrohet:

- Shërbimi i pastrimit sipas Struktures se proçeseve te sherbimit.
- Grumbullimit dhe transportit të mbetjeve nga pikat e grumbullimit ( të pajisur me kontenierë ) për në Landfillin e Qarkut.
- Në zonën qendrore ( qyteti te Elbasanit ) përveç shërbimeve të mesiperme, Bashkia po ben studime dhe po parshikon parashikojë edhe dy shërbime të tjera si:
  - a. Fshirja dhe larja mekanike në rrugët kryesore të qytetit.
  - b. Fshirja me mjet tekonologjik me kapacitet te vogel ne rruget dytesore dhe në rrugicat e ngushta të qytetit.

II. Të dhënat teknike në lidhje me ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve:

Riorganizimi i shërbimit te pastrimit dhe transportit te mbejeve urbane me 2 zona kontrate, do te sjelle edhe ndryshime në lidhje me infrastrukturën e mbeshtetese te domosdoshme për ofrimin e shërbimit, investimet për kontenierë apo mjete dhe frekuencat e ofrimit të shërbimit.

Në tabelën më poshtë jepet një përmbledhje në lidhje me infrastrukturën e nevojshme dhe të dhënat teknike për të dy zonat e këtij skenari për vitet 2020 - 2024.



Tabela Nr. 31

Nr	Nenzonat	Struktura e sherbimeve te pastrimit					
		Fshirja		Mirembajtje		Larja	
		Manuale	Mekanike	Pjeseshme	Plote	Larje	Freskim
1	Nenzona e pare						
2	Nenzona e dyte						

Nr	Nenzonat	Struktura e transportit dhe largimit te mbetjeve urbane						
		Numri popullsia	Norma e gjenerimit	Numri i mjeteve		Frekuenc	Numri kontenier	Sasia e mbetjeve
				Teknologj 10 ton	Te thjeshta 3 ton			
1	Nenzona e pare							
2	Nenzona e dyte							

**Rrugëtimi i mjeteve**

Mjetet e transportit teknologjike apo te thjeshta, gjate procesit te grumbullimit te mbetjeve urbane si nga kontenieret dhe transportimit per ne Landfill kryejne kete rrugtim.

**Transporti i mbetjeve nga Njësitet Administrative te qytetit**

Proçesi i pare i sherbimit.

Nga monitorimi qe i jane bere ketij proçesi me mjete teknologjike rezulton:

- Nje mjet transporti teknologjik me kapacitet deri ne 10 ton, i cili punon me frekuence per çdo dite dhe kryen dy cikle ( rruge ) ne dite.
- Ne baze te sasise se mbetjeve te gjeneruara dhe percaktimit te numrit te konteniereve me kapacite 1.1 m<sup>3</sup> rezulton, qe nje teknologjik duhet te zbraze rreth 80 cope konteniere ne nje rruge, pra 160 cope ne dite.
- Per te kryer sherbimin e grumbullimit, d.m.th zbrazen e konteniereve, i duhet 3 minuta per shkuar nga nje PGM ne tjetren, njekohesisht dhe zbrasja e kontenierit.
- Pasi eshte kryer proçesi i zbrazjes ne nje rruge ( 80 cope konteniere ne nje rruge ) mjetit i duhet 20 minuta per te shkuar ne Landfill duke pershkruar nje distance prej 7 km, njekohesisht edhe ne kthim.

Përlllogaritja e shpenzimeve mbi harxhimin e karburantit në një ditë për një mjet transporti teknologjik me kapacitet 10 ton

Tabela Nr. 32

Nr	Mjeti transportit	Përpunimi kontenierëvë				Koha levizjes		Koha Total min	Harxhim karburant		Vlera në një ditë	
		Nr. në një rrug	Nr. rrug	Nr. në një ditë	Koha Përp. një konte	V a j t j e	A r d h j e		N o r m a	Litra në një ditë	Ç m i m i	Vlera
1	Kapacitet 10 ton											

Proçesi i dyte i shërbimit.

Nga monitorimi që i është bërë proçesit të shërbimit të transportit dhe largimit të mbetjeve urbane direkt nga shtëpitë e qytetarëve rezulton:

<b>B. Detyrimet</b>							
	- Sigurimi i mjetit	lek/vit	1 mjet	-	-	43493	43 493
	- Regjistrimi e kontrolli teknik	-*-	1 mjet	-	-	38500	38 500
	- Mirembajtje te mjetit	lek/muaj	1 mjet	-	-	28000	336 000
<b>C. Perlllogartija e kostos per grumbullim e te transportit</b>							
	- Koha e shpenzuar	ore/cikel	7	1	çdo dite	7 cikle/jav	-
	- Distanca	km/cikel	108	1	-	-	-
	- Konsumi karburantit	lit/ore	6.5	1	30 cikle/muaj		-
<b>D. Perlllogartitjae kosos se personelit</b>							
	- Personeli	Shofer 1	Operator 2	çdo dite		30 cikle/muaj	
	- Oret e punes	ore/cikel	3 p x 7 ore = 21 ore//dite		150 lek/ore		
	- Pagat	lek/dit	3150	30 cikle/muaj	94 500		1 1134 000
<b>• Kosto depozitimi ne Landffill</b>							
	- Tarife hyrje	lek/ton					
<b>• Kosto amortizimi</b>							
	- Per mjetet e transportit	lek/vit	20 % /vit			600 000	600 000
	- Per kontenieret	lek/vit	20 % / vit			7 200	7 200
<b>• Investime kapitale</b>							
	- Cikle (rruge)	nr	1	1	çdo dite	-	-
	- Blerje mjeti teknologjik 10 ton	cop	1			3 000 000	3 000 000
	- Blerje konteniene 1.1 m <sup>3</sup>	cop	37			36 000	1 332 000

**Zona e trete:**

Njësitë Administrative Shushice, Gjinar, Labinot Fushe, Mjetet e transportit me kapacitet 10 ton.

Tabela Nr. 58

Nr	Elementet e kostos	Njësia	Sasia	Nr. cikli	Frekuenc	Çmimi	Vlera ne/vit
<b>• Te dhena te pergjithshme te Njësise Administrative</b>							
	- Tipologjia	Zone urale relievi fushor - kodrinor e malore					
	- Popullsia (qe u ofrohet sherbimi)	nr	10 285	Nga 26 fshatra ofrohet sherbimi per 9 fshatra			
	- Distanca (dhe levizjet ne fshatra)	km	44	-	-	-	-
	- Sasia e mbetjeve te gjeneruara	ton/dit	7.2	1	çdo dite	-	-
<b>• Kosto operative</b>							
<b>A. Variablat kryesore :</b>							
	- Dite ne vit qe kryhet sherbimi	nr	12	-	-	-	-
	- Kosto e karburantit	lit/cikel	39	6 ore x 6.5.lit/ore		147 lek/litri	1 685 500
<b>B. Detyrimet</b>							
	- Sigurimi i mjetit	lek/vit	1 mjet	-	-	43493	43 493
	- Regjistrimi e kontrolli teknik	-*-	1 mjet	-	-	38500	38 500
	- Mirembajtje te mjetit	lek/muaj	1 mjet	-	-	28000	336 000
<b>C. Perlogartija e kostos per grumbullim e te transportit</b>							
	- Koha e shpenzuar	ore/cikel	6	çdo dite		30 cikle/muaj	
	- Distanca	km/cikel	44	1	-	-	-
	- Konsumi karburantit	lit/ore	18	1	30 cikle/muaj		-
<b>D. Perlogartitjae kosos se personelit</b>							
	- Personeli	Shofer 1	Operator 2	Per çdo dite		30 cikle/muaj	
	- Oret e punes	ore/cikel	3 p x 6 ore = 18 ore//dite			150 lek/ore	
	- Pagat	lek/dit	2700	30 cikle/muaj		81 000	972 000
<b>• Kosto depozitimi ne Landffill</b>							
	- Tarife hyrje	lek/ton					
<b>• Kosto amortizimi</b>							
	- Per mjetet e transportit	lek/vit	20 % /vit	-	-	600 000	600 000
	- Per kontenieret	lek/vit	20 % / vit	-	-	7 200	7 200
<b>• Investime kapitale</b>							
	- Cikle (rruge)	nr	1	1	çdo dite	-	-
	- Blerje mjeti teknonologjik 10 ton	cop	1	-	-	3 000 000	3 000 000
	- Blerje konteniere 1.1 m <sup>3</sup>	cop	37	-	-	36 000	1 332 000



**Zona e katert:**

Njësitë Administrative Shirgjan, Tregan, Gjerjgjan, Mjetet e transportit me kapacitet 10 ton.

Tabela Nr. 59

Nr	Elementet e kostos	Njësia	Sasia	Nr. cikli	Frekuenc	Çmimi	Vlera ne/vit
<b>• Te dhena te pergjithshme te Njësise Administrative</b>							
	- Tipologjia	Zone urale relievi fushor - kodrinor					
	- Popullsia (qe u ofrohet sherbimi)	nr	16 032	Nga 26 fshatra ofrohet sherbimi per 14 fshatra			
	- Distanca (dhe levizjet ne fshatra)	km	103	-	-	-	-
	- Sasia e mbetjeve te gjeneruara	ton/dit	12.3	2	çdo dite	-	-
<b>• Kosto operative</b>							
<b>A. Variablat kryesore :</b>							
	- Dite ne vit qe kryhet sherbimi	nr	12	-	-	-	-
	- Kosto e karburantit	lit/cikel	45.5	7 ore x 6.5lit/ore		147 lek/litri	1 963 920
<b>B. Detyrimet</b>							
	- Sigurimi i mjetit	lek/vit	1 mjet	-	-	43493	43 493
	- Regjistrimi e kontrolli teknik	-*-	1 mjet	-	-	38500	38 500
	- Mirembajtje te mjetit	lek/muaj	1 mjet	-	-	28000	336 000
<b>C. Perllogartija e kostos per grumbullim e te transportit</b>							
	- Koha e shpenzuar	ore/cikel	3.5	2 cikle x 3.5 ore		7 ore pune/ dite	
	- Distanca	km/cikel	52	2 cikle x 52 km		-	
	- Konsumi karburantit	lit/ore	6.5	7 ore x 6.5.litr/ore		-	
<b>D. Perllogartitjae kosos se personelit</b>							
	- Personeli	Shofer 1	Operator 2	per çdo dite		30 dite/pune x 2 cikle/dite	
	- Oret e punes	ore/cikel	3 puntore	3 puntore x 3.5 ore		2 rruge/dite x 3.5 ore/rruga	
	- Pagat	lek/cikli	1575	1575 x 60 cikle		94 500	1 134 000
<b>• Kosto depozitimi ne Landffill</b>							
	- Tarife hyrje	lek/ton					
<b>• Kosto amortizimi</b>							
	- Per mjetet e transportit	lek/vit	20 % /vit	-	-	600 000	600 000
	- Per kontenieret	lek/vit	20 % / vit	-	-	7 200	7 200
<b>• Investime kapitale</b>							
	- Cikle (rruge)	nr	1	-	-	-	-
	- Blerje mjeti teknologjik 10 ton	cop	1	-	-	3 000 000	3 000 000
	- Blerje konteniere 1.1 m <sup>3</sup>	cop	37	-	-	36 000	1 332 000

Të dhënat teknike në lidhje me ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve deri ne vitin 2024

Riroganizimit të shërbimit, i cili konsiston ne ndarjen e territorit te Bashkisë në disa Zona dhe nenzona per menaxhimin e pergjithshem te mbetjeve urbane të Bashkisë, nga ku eshte menduar qe do t'i shtohen edhe shërbimet te tjera duke perfshire dhe proceset e sherbimit mbi ndarjen në burim të mbetjeve.





Në tabelën më poshtë jepet një përmbledhje në lidhje me infrastrukturën e nevojshme dhe të dhënat teknike për të dy nga zonat e shërbimit të Lagjet Administrative të qytetit si këto zoneve të shërbimit Njësive Administrative të fshatit.

Tabela Nr. 60

Nr	Lagja Administrative Zona e shërbimit	Te dhenat e përgjithshme							
		Tipologji	Popullsia që ofrohet shërbim	Vizitor Turist	Distan	Sasia e mbetjeve	Nr. mjeteve	Nr. kontenier	
• Lagjet Administrative të zonave urbane									
I	Zona shërbimit	urbane			7				
	Nenzona pare	(me konteniere)	70000		7	49	3	445	
		(direkt nga shtëpitë)	8000		7	5.6	3	-	
		<b>Shuma</b>	<b>78000</b>			<b>54.6</b>		<b>445</b>	
	Nenzona dyte	(me konteniere)	44 300		7	31	2	282	
		(direkt nga shtëpitë)	3 300		7	2.3	1	-	
		<b>Shuma</b>	<b>47600</b>			<b>32.3</b>	<b>2</b>	<b>282</b>	
	Shuma për gjithë Njësitet Administrative			<b>125 600</b>			<b>88</b>	<b>727</b>	
• Njësitet Administrative të zonave rurale									
II	Zona e shërbimit	Fush - kod	<b>6400</b>		<b>20</b>	<b>4.5</b>	<b>1</b>	<b>41</b>	
	Zona dyte e shërbimit								
	Nenzona pare	fushor	9390		4	6.5	1	60	
	Nenzona dyte	malor	985		30	1	-	10	
	Nenzona trete	malor	1000		30	1	-	10	
	<b>Shuma</b>		<b>11 375</b>			<b>8</b>	<b>1</b>	<b>73</b>	
	Zona e trete e shërbimit								
	Nenzona pare	Fush - kod	5500		10	7.8	1	71	
	Nenzona dyte	malor	1200		28	1	-	10	
	Nenzona trete	Fush - kod	5100		10	3.5	-	32	
	<b>Shuma</b>		<b>11800</b>			<b>8.2</b>	<b>1</b>	<b>75</b>	
	Zona e katert e shërbimit								
	Nenzona pare	fushor	9900		8	7	1	64	
	Nenzona dyte	Kod -mal	1550		25	2		20	
	Nenzona trete	fushor	6300		15	4.5	1	40	
	<b>Shuma</b>		<b>17750</b>			<b>12.4</b>	<b>1</b>	<b>123</b>	
	Shuma për gjithë Njësitet Administrative			<b>47325</b>			<b>33</b>	<b>4</b>	<b>300</b>
	Shuma përgjithshme Bashkia			<b>172 925</b>			<b>121</b>	<b>8</b>	<b>1027</b>

### Kosto totale operacionale

Udhëzimi për llogaritjen e kostos për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve Urbane:

Sistemi standard i përlogaritjes së kostos së përgjithshme për menaxhimin e mbetjeve në Njësitet e Vetëqeverisjeje Vendore duhet të bazohet në pakten në 6 ( gjashtë ) kollona kryesore, si:



1. Te dhenat e pergjithshme per Njësine Administrative ne te cilat jane percaktuar **zonat e sherbimit**.
2. Investimet kapitale.
3. Kostot operative.
4. Kosto per depozitim dhe trajtim te Landffill.
5. Kostot e amortizimit.
6. Kostot administrative .
7. Perlllogartija e kostove totale te sherbimeve.

### **Qellimi:**

Te gjithë elementet e mesiperme duhet te ofrojne:

- Te gjithë infrastrukturen perkatese per te kryer sherbimet e pastrimit.
- Burimet Njerzore.
- Mjetet e nevojshme financiare per funksionimin e sistemit te menaxhimit.

Udhezimet dhe modelet detyrimisht duhet te perfshijne:

- Metodot ekologjike te trajtimit te mbetjeve urbane.
- Sasine e mbetjeve qe mund te trajtohen ne burim; reduktim, riperdorim, riciklim.
- Te zhvilloje skemat e partneritetit publik - privat.

Çdo kollone e menaxhimit duhet te pershkruaj me detaje, per menyren e perdorimit dhe bashkeveprimit qe realizohet ne sistem.

Specialistet perkates te sistemit te kostimit duhet te jene ne gjendje:

- Te perdorin kete sistem dhe te kuptojne se si eshte zhvilluar ai.
- Te interpretojne rezultatet.
- Te zhvillojne ate me tej, bazuar ne variablat dhe kostot standarte.

Para se te fillojme perdorimin e ketij sistemi te menaxhimit te te kosos, duhet detyrimisht qe te mbledhjen nje grup te dhenash, te cilat kane te bejne me:

- Popullsine ( te regjistruar dhe ate qe u ofrohet sherbime realisht ).
- Shtrirjen gjeografike.
- Rruget; parametrat, karakteristikat dhe gjendja teknike dhe funksipnale e tyre.
- Mjete e transportit dhe kontenieret e mbetjeve urbane.
- Kostot aktuale te karburanteve.
- Sistemin e pagave.

Shumica e ketyre te dhenave mund te mblidhet duke ju refetruar :

- Strategjive ekzistuese kombetare dhe rajnale.
- Bazave e te dhenave dhe raporteve.

Ndersa me kryesoreve si :

- Sasia e gjeneruar e mbetjeve.
- Norma e gjenerimit per fryme dhe e bizneseve.
- Distancat dhe kushtet e rrugeve duhet te llogariten ne baze te monitorimeve, vrojttimeve dhe vleresimeve ne terren.

**Konkretisht: Per percaktimin dhe vleresimin e situates**

Te dhena te pergjithshme te Njësive Administrative:

- Tipologjia.  
Konsiston ne percaktimin e Njësise Administrative apo te zones se sherbimit ne urbane, rurale apo mikse, variabel ky mjaft i rendesishem ne percaktimin se sasise se mbetjeve te gjeneruara dhe te gjitha kostot e lidhuara me te.

- **Popullsia.**  
Normalisht popullsia e Njësive Administrative perbehet nga banoret rezident te korrektuar sipas Regjistrit te Gjendjes Civile, si dhe banoreve sezonale qe jetojne aty ne nje periudhe me shume se 6 muaj. Per kete qellim, lind detyrimi ligjor per çdo Bashki qe te krijojne regjistrin e te dhenave per banoret dhe familjet qe jetojne ne territorin administrative.
- **Vizitore dhe turiste.**  
Keta gjenerues mbetjesh duhet te konsiderohen te ndare. Njësitate Administrative duhet te kene te dhena te sakta per vizore te perditshem si dhe ato me nje kohezgjatje (muaj) zyrtar te sezonit turistik.
- **Distanca dhe kushtet e rrugëve.**  
Duhet te vrojtuar e vleresuar per:
  - Distançen dhe kohen per grumbullim per mbushur nje mjet transporti.
  - Distançen dhe kohen per transportim per te shkuar dhe kthyer nga Landfilli.
- **Sasia e mbetjeve te gjeneruara.**  
Kjo shifer eshte e barazvlefshme me kg/fryme, qe perfshin mesatarisht tre gjenerues:
  - Banoret.
  - Bizneset.
  - Institucionet.

Sasia e mbetjeve te gjeneruara si me lart, konsiston vetem ne mbetje shtepiake, duke mos perfshire mbetjet te tjera si ato spitalore, bujqesore apo inerte te cilat trajtohen me ligj te veçante.

Kjo shifer eshte me e rendesishme, pasi ndikon ne te gjithë sistemin.

**Perllogaritje e nevojave per investime kapitale:**

Kjo bazohet ne te dhenat e kollones se pare, nga duhet llogarisim nevojat per grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve te gjeneruara. Variablat jane:

- **Ciklet ( rruget e nje mjeti transportues ).**  
Te cilat nevitin per grumbullimin e transportimin e mbetjeve urbane per ne Lanfill ( vajtje - ardhje ).
- **Tipi dhe kapaciteti i mjetit transportues:**  
Keto mjete transportuese sugjerohen ne varesi te tipologjise se Njësise Administrative (zones se sherbimit) ku zakonisht rekomendohen mjete me kapacitet deri ne 10 ton me dhe kapacitet real mbushes deri ne 85 % te kapacitetit total. Ndersa ne zonat rurale dhe ne rruget e ngushta rekomandohen mjete te thjeshta transportuese ( vetshkarkuese ) me kapacitet deri ne 3 ton.
- **Numri dhe kapaciteti i konteniereve te mbetjeve urbane:**  
Rekomandohet qe Njësitate Administrative te perdorin konteniere me vellim 1.1 m<sup>3</sup> i cili ka nje kapacitet maksimal mbajtes rreth 0.110 ton. Numri i konteniereve llogaritet ne baze te sasise se gjeneruar te mbetjeve shtepiake per çdo zone sherbimi.

**Perllogaritja e kostove operative.**

Keto llogaritje konsistojne ne mirembajtjen e infrastruktures dhe transportit duke perfshire dhe koston e personelit, Keto jane kosto vjetore dhe jane mjaft te rendesishme sepse jane te lidhura ngushte me ndryshimet e tregut e te inflancionit.

Variablat kryesore te perdorura jane:

- **Perllogaritja e koston se mirembajtjes:**
  - Shpenzime per sigurimet, regjistrimet dhe kontrollin teknik.
  - Mirembajtja e mjeteve te transportit.



- Mirembajtje mekanike ( ne baze numrit te sherbimeve mekanike vjetore ).
- Ditet ne nje vit gjate te cilave kryhet sherbimi.  
Keto llogaritje varen nga:
  - Numri i diteve te punes ne nje vit.
  - Frekuenca e kryerjes se sherbimit, duke ju referuar standartit; per nje gjenerim deri ne 3.5 ton/dit kerkohet sherbim per çdo dite.
- Kostoja e karburantit.
  - Ky variabel ndikon ndjeshem ne koston e pergjithshme te menaxhimit te mbetjeve, pasi ze nje pjese te konsiderueshme te shpenzimeve dhe eshte subjekt i ndryshimeve ndërkombetare dhe inflacionit te vendit.
- Perlllogaritja e kostove te grumbullimit dhe te transportimit.  
Variablat kryesore jane:
  - Koha e shpenzuar e cila perben :
    - a. Koha e shpenzuar per grumbullim.
    - b. Koha e shpenzuar per transportin.

Per llogartijen e ketyre shifrave, zakonisht i referohemi vrojttimeve te kryera ne terren dhe steandarteve ku:

- Ne nje cikel (rruge) koha e grumbullimit per nje mjet transporti me kapacitet 10ton eshte rreth 4 ore.
- Dhe koha per transport ne nje distance prej 7 km eshte 0.3 ore.
- Distanca e pergjithshme:  
Kjo llogaritet nga distanca qe nevoitet gjate grumbullimit te mbetjeve urbane duke percaktuar itenerarin per çdo VDM, dhe distances deri ne Landfill.
- Konsumi i karburantit:  
Konsumi i karburantit varet nga tipi i mjetit transportues dhe numri i sherbimeve vjetore qe i kryhen mjetit. per te qene sa me efektive, duhet te llogaritet sasia qe nevoitet per grumbullim si dhe ajo qe nevoitet per transportim.

- Perlllogaritja e kostove te personelit:  
Variablat e perdorura ne kete pjese te sistemit jane:

- Personeli:

Ketu perlllogariten ne baze te numrit te shoferave dhe te operatoreve, nga ku merret parasysh numri i rrugeve dhe dhe respektimi ligjor i oreve te punes ne dite dhe ne nje jave.

- Oret e punes:

Ditet e punes se personelit, perbehet nga koha per grumbullimin, transportin dhe mirmbejtjen e mjetit transportues.

- Pagat:

Llogaritjet e pagave behet ne baze te Kodit te punes, duke respektuar pagen minimale te miratuar me VKM dhe diteve efektive te punes.

### Perlllogaritja e kostove operative:

Qellimi i perlllogaritjes se kesaj kostoje, eshte mbajtja e nje llogarie te veçante e cila lidhet me nje Operatore ekonomik te trete.

Njësitate Administrative duhet te llogarisin kostot per depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve urbane ne Landfill ne te gjitha format e pronesise.

Kjo kosto per depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve konsiston ne nje tarife hyrje dhe zokonisht llogaritet dhe paguhet me ton.



Tarifa percaktohet nga Autoritetit qe menaxhon Landfillin nepermjet nje kontrate dypaleshe.

Kjo kosto perllogaritet nga raporti i sasise se mbetjeve qe dergohet per çdo dite me tarifen hyrese.

- Perllogartija e kostove te amortizimit.

Perllogartijae koston se amortizimit behet sipas percaktimeve ne ligjin "Per tatimin mbi te ardhurat"

Variablat ne llogaritjen e kesaj kostoje jane te thjeshte pasi ato lidhen direkt me koston vjetore te amortizimit te mjeteve te transportit dhe konteniereve te mbetjeve urbane.

Kjo shifer do te jete 5 vite duke konsideruar nje mesatare vjetore 20 %.

- Perllogartija e kostove administrative.

Ne elementet e llogartjes se koston administrative futen nevojat per infrastrukturen mbeshtetese per personelin qe perfshin:

- Rrobat e punes.
- Antidote.
- Pastrues kimik ( detergjente ).
- Vegla pune e paisje per çdo proces sherbimi.

Ne perllogartijen e koston administrative mund te perfshihet edhe shpenzimet per fushatat e ndergjegjesimit publik, e cila ndihmon ne rikuperimin e kostove te tjera.

Shifrat mund te perllogartiten edhe ne baze te nje perqindje te kostove totale operacionale.

- Perllogartija e kostove totale te sherbimeve.

Duke i renditur te gjitha tabelat e mesiperme, zhvillohet nje sistem i plote i llogartije se koston totale.

Ky sistem na jep nje informacion te detajuar mbi nevojat per :

- Shpenzime per investime kapitale.
- Shpenzime operative ( mirmabjtje, transp dhe personel ).
- Shpenzime per depozitim dhe trajtimin ne Landfill.
- Shpenzime per amortizim ( ri-investime ).
- Shpenzime administrative.

Qe te paraqiten ne menyre te detajuar vendimarreseve vendor, nga ku perllogaritet ;

- a. Perllogartja e kostove per ton mbetje.
- b. Perllogartja e kostove per banore.

Ne perfundim keto rezultate grupohen ne 4 (kater) **kategori baze menaxhimi** per te kuptuar shkallen e influences se secilit prej tyre ne koston totale.

- Grumbullim.
- Transport.
- Amortizim.
- Depozitim e trajtim ne Landfill.

## Politika e mbulimit të koston me të ardhurat nga tarifat e pastrimit.

Metodologji për mbulimin e koston

Politika e mbulimit të koston.

### **"Mbulimi i koston"**

- Përfshin një sistem tarifash dhe taksash, të cilat kanë si qëllim specifikisht të mbulojnë disa ose të gjitha koston e ofrimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve nga përdoruesit e këtij shërbimi, në përputhje me principin "ndotësi – paguan".
- Avantazhet e sistemit të mbulimit të koston qëndrojnë në faktin se të gjitha kategoritë e konsumatorëve të shërbimit njihen me koston e plotë të tij, janë të

përfshirë në mënyrë më të drejtëpërdrejtë me problemet e cilësisë së shërbimit, vlerësojnë peshën që merr pagesa e tarifës së tyre në mbledhjen e të ardhurave dhe mundësitë reale të bashkive për t’i ofuar konsumatorëve këtë shërbim.

- Hartimi i politikave të mbulimit të koston është përgjegjësi e Bashkisë dhe synon të përcaktojë nivelin e rikuperimit të koston që duhet të arrihet për një periudhë të caktuar kohore, duke përcaktuar më parë:
  - Llogaritjen e koston së plotë të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve të ngurta Bashkiake.
  - Planifikimin e buxhetit e të Bashkisë mbi këtë kosto.
  - Përcaktimin e tarifave për kategoritë e ndryshme që përfitojnë shërbimin bazuar mbi nivelin e rikuperimit të koston të përcaktuar.
  - Procedurat e zbatimit dhe monitorimit.
- Ndërkohë që literatura dhe eksperiencia tregojnë disa opsionet për objektiva të ndryshme të mbulimit të koston, Bashkia do të hartojë objektivat e saj të rikuperimit të koston duke vlerësuar më parë kushtet në të cilat ndodhen ( analiza e plotë financiare ) si dhe më pas duke u konsultuar në mënyrë të vazhdueshme me ofruesin e shërbimit për të përcaktuar në mënyrë të qartë çfarë do të thotë kosto e plotë e shërbimit.

Opsionet e mbulimit të koston së shërbimit të menaxhimit të integruar të mbetjeve, konkretisht Bashkia duke analizuar gjendjen e saj mund të kuptojë se në cilat nga këto opsione ajo është aktualisht dhe ku ajo kërkon të shkojë, në sajë të objektivave që ajo do të vendosë:

Përshkrimi i opsioneve të mbulimit të koston:

- Megjithatë për të ndërtuar një politikë të qëndrueshme dhe mbi të gjitha të zbatueshme të rikuperimit apo mbulimit të plotë të koston, Bashkia ka nevojë për një bashkëpunim me nivelin qëndror të politikë bërjes.
- Kështu në nivelin qëndror duhet të zhvillohen standartet e ofrimit të shërbimit për të pasur një kuptim të përbashkët për të gjitha Bashkitë për nivelin e ofrimit të shërbimit.
- Vetëm në këtë mënyrë mund të kemi procedura të standartizuara për monitorimin e shërbimit si dhe nivele të standartizuara ( klasa ) të krahasueshme në ofrimin e tij.
- Gjithashtu duhet të hartohen guidat e reja të përgatitjes së buxhetit sipas “qëndrave të buxhetimit apo të koston” për elemente të veçantë të shërbimit të mbetjeve (grumbullim, transport, riciklim, programe ndërgjegjësimi etj).

Vetëm në këtë mënyrë Bashkia do të ketë mundësi të njohë koston e plotë të shërbimit që ajo ofron.

Hapat që duhen ndjekur për të zbatuar politikën e rikuperimit të koston:

- Identifikimi.
- Kategorizimi.
- Përditësimi.
- Mat efikasitetin dhe eficiencën.
- Vlerëso dëshirën për të paguar.
- Krijoni një sistem të qartë të mbledhjes së tarifës.
- Komunikoni tarifën në mënyrë të personalizuar.
- Fushatat e sensibilizimit.
- Përcaktoni koston.
- Hartoni dhe lidhni marrëveshjet.
- Monitoroni ekzekutimin e marrëveshjeve.



Strategjia për vjeljen e tarifave:

- Bazat për qëndrueshmërinë financiare të shërbimeve të mbetjevemund të arrihen nëpërmjet sigurimit të shërbimeve efektive dhe me kosto eficiente, si dhe me sigurimin e një sistemi të qëndrueshëm financiar të bazuar në një politikë të drejtë dhe efektive të rikuperimit të koston.
- Aspektet financiare janë thelbësore për shërbimet dhe për qëndrueshmërinë.
- Performanca financiare është e lidhur me përmbushjen e objektivave mbi çështjet financiare dhe matet nëpërmjet disa treguesve financiarë që shqyrtohen përmes pyetjeve të mëposhtme:
  - Sa i mbulon buxheti vjetor shpenzimet që rezultojnë nga nevojat (përkatësisht kostot kapitale, kostot operative, apo kostot e amortizimit)?
  - Sa të ndryshme janë tarifat e miratuara në krahasim me ato që janë parashikuar në procesin e planifikimit?
  - Sa mblidhen të ardhurat kundrejt planifikimit të tyre?
  - Sa nga buxheti në përqindje mbulohet nga të ardhurat?
  - Cili është raporti i mbulimit të shpenzimeve nga tarifat e mbetjeve dhe të ardhurave specifike të Bashkisë?
  - Sa të gatshëm janë konsumatorët (familjet, bizneset etj.) për të paguar për një shërbim më të mirë?

Strategjia për mënyrën e vjeljes së tarifave që Bashkia Elbasan do të zbatojë:

- Rregjistrimi i konsumatorëve:

Që është edhe hapi i parë, përfshin identifikimin e të gjitha subjekteve që përfitojnë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve, kategorizimin e tyre sipas karakteristikave (tipi, madhësia, natyra e mbetjeve që gjenerojnë, sasia, etj.) duke synuar ngritjen dhe mirëmbajtjen e një sistemi të përditësuar të dhënash brenda kufijve të Bashkisë. Ky sistem duhet të kontrollohet rregullisht të paktën *një herë në vit* për të reflektuar të gjitha lëvizjet e popullsisë si dhe regjistrimin e të gjitha bizneseve të reja.
- Komunikimi me konsumatorët:

Që përfitojnë shërbimin është një moment tjetër shumë i rëndësishëm në ndërtimin e një sistemi efikas në vjeljen e tarifave. Ky hap synon diferencimin e tarifave për konsumatorët e ndryshëm të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve si dhe lidhja e tarifës me nivelin e cilësisë të shërbimit. Marrja e opinionit qytetar përmes pyetësorëve në lidhje me cilësinë e shërbimit të ofruar synon jo vetëm evidentimin e problemeve, por ka për qëllim edhe matjen e dëshirës dhe mundësive për të paguar duke kontribuar në krijimin e një sistemi të qartë procedurash për hartimin dhe vjeljen e tarifave. Një pikë tjetër e rëndësishme përsa i përket komunikimit me konsumatorët është bërja transparente e tarifave përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit ( media e shkruar dhe vizive, web site etj ).
- Procesin e vjeljes së tarifave  
Pjesa më e madhe e autoriteteve vendore e kryejnë vetë procesin e vjeljes së tarifave nëpërmjet zyrave të tyre vendore të taksave apo drejtorisë vendore të taksave dhe tarifave. Ndonjëherë tarifat e mbetjeve vendosen së bashku me tarifat e tjera vendore ( të tilla si fatura e furnizimit me ujë, ashtu siç e aplikon Bashkia Elbasan aktualisht ) apo taksa të tjera vendore ( tatimi mbi pronën ) brenda së njëjtës faturë. Për të siguruar qëndrueshmërinë e sistemit është e rëndësishme që të hartohen edhe disa mekanizma të rëndësishëm, duke filluar me mjetet e njoftimit për t'i bërë konsumatorët më të vetëdijshëm për përgjegjësinë ose detyrimin për të paguar, deri në aplikimin e mjeteve të zbatimit të tilla si sanksionet, gjobat, etj.

- Detyrimi:

Hapi i fundit, por jo më pak i rëndësishëm është edhe *detyrimi* i cili përfshin ngritjen e një sistemi me struktura adekuate kontrolli, të cilat do të hartojnë masat dhe sanksionet në rastet e mospagimit. Krijimi i strukturave të tilla me detyra dhe përgjegjësi të qarta duhet të jetë subjekt i çdo plani vendor për menaxhimin e mbetjeve. Të gjitha masat dhe sanksionet duhet të hartohen në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe politikat lokale të menaxhimit të mbetjeve. Gjithësesi shumë e rëndësishme për ekzekutimin efikas është që këto masa dhe sanksione të miratohen me Vendim Këshilli Bashkiak dhe t'i komunikohen të gjithë konsumatorëve të shërbimit përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit. Bashkia duhet të ndërmarrë një fushatë të fuqishme sensibilizimi për të gjithë konsumatorët, veçanërisht për banorët, duke reklamuar shërbimin e grumbullimit të mbetjeve, rregullat dhe përgjegjësitë.

### Planifikimi i të ardhurave nga tarifa e pastrimit për menaxhimin e mbetjeve:

Bashkia Elbasan është angazhuar në përditësimin e databazës së klientëve ( konsumatorët familjarë dhe biznese ) për të përmirësuar planifikimin e tarifave vendore, jo vetëm tarifave të pastrimit, për të kuptuar më mirë potencialin fiskal të saj për të përballuar koston e shërbimit.

Ky proces, specifikisht kërkon një iniciativë jo vetëm nga qendra e Bashkisë Elbasan por nga të gjithë administratorët e Njësi Administrative për të regjistruar të gjithë klientët në databazën e Bashkisë. Përsa i takon politikës fiskale për tarifën e pastrimit, Bashkia Elbasan gjatë procesit të hartimit të planit, ka zhvilluar dëgjesa publike me komunitetin në të gjitha njësitë vendore, ku ajo ka prezantuar edhe rritjen e tarifës së pastrimit për tre kontratat e reja të shërbimit të mbetjeve për gjitha variantet e përshkruar më lart.

Në objektivat e Bashkisë, rritja në të ardhmen e tarifës së pastrimit është një ushtrim, i cili do të kërkojë shumë përpjekje nga ana e saj, si në përmirësimin e cilësisë së shërbimit, duke futur teknologji të reja, ashtu edhe në informimin e rregullt të komunitetit.

Bashkia parashikon që për kontratat e ardhshme tarifa e pastrimit mos të pësojë rritje të ndjeshme, por të mbetet në këto nivele, në sajë të skenarit që do të përzgjidhet për ofrimin e shërbimit në të gjitha njësitë administrative.

Në tabelat më poshtë, për secilën nga tre zonat e shërbimit, kemi parashikuar se sa përqind e koston operative do të mbulohet nga familjet, në sajë të një rritje prej 3% çdo vit të numrit të familjeve, ku tarifa e pastrimit mbetet në ato nivele të përcaktuara së fundmi nga bashkia në dëgjesat publike.

Si fillim janë marrë si referencë nivelet e grumbullimit të të ardhurave të raportuara nga Bashkia për vitin 2017-2018, ku vit pas viti është propozuar një rritje me 10% e nivelit të grumbullimit të të ardhurave.

Në rastin e bizneseve ato janë marrë të përmbeldhura në dy tabela ( biznesi i madh dhe biznesi i vogël ) në ndryshim nga familjet, ku ato janë marrë më vetë për secilën njësi vendore.

Për sa i takon përqindjes të koston që zënë tre kategoritë e konsumatorëve, bashkia ka përcaktuar:

- Familjet zënë **55%** të koston operative.
- Bizneset e mëdha dhe institucionet zënë **25%** të koston operative.
- Bizneset e vogla zënë **20%** të koston operative.

Tarifa familjare nga kosto operative e shërbimit per Lagjet Administrative te qytetit



Zona e pare e sherbimit

Tabela Nr. 62

Nr	Periudha	Nr familjeve	Tarifa vjetore	Planifikimi te ardhurave	Te ardhurat e grumbulluara	Niveli %	Pjesa e koston operative per familje	Niveli %
1	2020							
2	2021							
3	2022							
4	2023							
5	2024							

Zona e dyte e sherbimit

Tabela Nr. 63

Nr	Periudha	Nr familjeve	Tarifa vjetore	Planifikimi te ardhurave	Te ardhurat e grumbulluara	Niveli %	Pjesa e koston operative per familje	Niveli %
1	2020							
2	2021							
3	2022							
4	2023							
5	2024							

Bizneset e medha dhe institucionet

Tabela Nr. 64

Nr	Periudha	Nr familjeve	Tarifa vjetore	Planifikimi te ardhurave	Te ardhurat e grumbulluara	Niveli %	Pjesa e koston operative per familje	Niveli %
1	2020							
2	2021							
3	2022							
4	2023							
5	2024							



Bizneset e vogla

Tabela Nr. 65

Nr	Periudha	Nr familjeve	Tarifa vjetore	Planifikimi te ardhurave	Te ardhurat e grumbulluara	Niveli %	Pjesa e koston operative per familje	Niveli %
1	2020							
2	2021							
3	2022							
4	2023							
5	2024							

Tarifa familjare nga kosto operative e shërbimit per Njësitate Administrative te zonave rurale

Zona e pare e shërbimit

Tabela Nr. 66

Nr	Periudha	Nr familjeve	Tarifa vjetore	Planifikimi te ardhurave	Te ardhurat e grumbulluara	Niveli %	Pjesa e koston operative per familje	Niveli %
1	2020							
2	2021							
3	2022							
4	2023							
5	2024							

Zona e dyte e shërbimit

Tabela Nr. 67

Nr	Periudha	Nr familjeve	Tarifa vjetore	Planifikimi te ardhurave	Te ardhurat e grumbulluara	Niveli %	Pjesa e koston operative per familje	Niveli %
1	2020							
2	2021							
3	2022							
4	2023							
5	2024							



Zona e trete e sherbimit

Tabela Nr. 68

Nr	Periudha	Nr familjeve	Tarifa vjetore	Planifikimi te ardhurave	Te ardhurat e grumbulluara	Niveli %	Pjesa e koston operative per familje	Niveli %
1	2020							
2	2021							
3	2022							
4	2023							
5	2024							

Zona e katert e sherbimit

Tabela Nr. 69

Nr	Periudha	Nr familjeve	Tarifa vjetore	Planifikimi te ardhurave	Te ardhurat e grumbulluara	Niveli %	Pjesa e koston operative per familje	Niveli %
1	2020							
2	2021							
3	2022							
4	2023							
5	2024							

## Kuadri Ligjor dhe Institucional

### Rregullorja Vendore:

Bashkia Elbasan do të përgatisë dhe miratojë:

- Rregulloren lokale për administrimin e shërbimit të mbetjeve, ku të përcaktohet qartë rolin dhe përgjegjësia e prodhuesve dhe operatorëve të mbetjeve, me qëllim administrimin e suksesshëm të tyre brenda territorit të saj administrativ.
- Kjo rregullore duhet të përcaktojë rregullat dhe procedurat për administrimin vendor të mbetjeve, procedurat për trajtimin e ankesave të qytetarëve si dhe gamën e sanksioneve për mosrespektim të rregullave.

Më konkretisht kjo rregullore duhet të përfshijë:

Standardet lokale të punës dhe cilësisë, metodologjitë dhe teknologjitë, rregullat e sigurisë dhe të shëndetit për shërbimet e pastrimit dhe të administrimit të mbetjeve;

- Rregullat dhe detyrimet e prodhuesve të mbetjeve.
- Sanksione në raste të dëmtimit të kontenierëve, të ndryshimit të funksionit apo vendodhjes së PGM apo kontenierëve.
- Marrjen e masave parandaluese për mosdjegien e mbetjeve në kazanë, për moshedhjen e mbetjeve në rrymat ujore dhe kanalizimet, apo në vende të tjera nga ato të miratuara nga Bashkia.



- Marrjen e masave parandaluese për moshedhjen e mbetjeve voluminoze dhe atyre të rrezikshme, mosdepozitimim e kafshëve të ngordhura dhe mbetjeve të rrezikshme në PGM të mbetjeve urbane.
- Shmangien e parkimit të automjeteve përballë apo pranë pikave të caktuara të grumbullimit të mbetjeve.
- Marrjen e masave për pastrimin nga ana e pronarëve të hapësirave rreth dyqaneve dhe pikave ambulatorie të shitjes.
- Marrjen e masave për sigurimin e një pastërtie të pranueshme duke dezinfektuar kontenierët dhe koshat rrugorë të depozitimit të mbetjeve.
- Mbajtja e uniformave gjatë proceseve të punës nga punonjësit e pastrimit.
- Përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të administruesve të mbetjeve ( operatorët e mbetjeve, industria e mbetjeve ):
  - \* Veprimet të kryhen vetëm nga kontraktorë të licencuar.
  - \* Procedurat administrative për dhënien dhe heqjen e licencave.
  - \* Pagesa e tarifave dhe taksave të vendosura nga autoriteti vendor.
  - \* Përdorimi i makinerive dhe kontenierëve të përshtatsh.
  - \* Përdorim i vendeve të licensuara të depozitimit.
  - \* Regjistrimi i konsumatorëve që përfitojnë shërbime pastrimi.
  - \* Mbajtja e të dhënave historike për mbetjet.
  - \* Parandalimi i problemeve për shëndetin publik.

Zbatimi dhe sanksionet:

Rregullorja vendore e administrimit të mbetjeve shoqërohet me një sërë gjobash dhe sanksionet që duhet të caktohen dhe miratohen nga Këshilli Bashkiak. Niveli i gjobave dhe sanksioneve duhet të bazohen në shërbimin e ofruar dhe në parimin "ndotësi paguan", ku shkelësi duhet të ndëshkohet me qëllim që të merren parasysh kostot e pastrimit apo mbledhjes së mbetjeve, kostot mjedisore dhe për më tepër të krijohet një sistem i drejtë për dekurajimin dhe parandalimin e ndotësve.

Gjobat lokale duhet të vendosen nga inspektorët bashkiakë që janë nën juridiksionin e Bashkisë. Përgjegjësia kryesore e këtyre inspektorëve është të vendosin sanksione për personat fizikë apo juridikë që shkelin kushtet ligjore në lidhje me mbledhjen, largimin dhe transportin e mbetjeve.

Pjesëmarrja e sektorit privat:

Ekzistojnë një sërë përfitimesh dhe avantazhesh lidhur me përfshirjen e sektorit privat në sektorin e menaxhimit të mbetjeve: Pse?

- Sektori privat zotëron një ekspertizë më të mirë teknike dhe akses më të madh ndaj kapitaleve financiare sesa sektori publik.
- Skemat e minimizimit të mbetjeve që kërkojnë financime në teknologji ( makineri dhe kontenierë ) mund të jenë shumë të përshatshme për një bashkpunim PPP.
- Administrata e sektorit privat është më efektive se ajo e sektorit publik.
- Aty ku sektori privat mund të realizojë shërbimet me standarde të njëjta apo më të mira dhe me kosto më të ulët për njësi, dhënia me kontratë e shërbimeve është një mundësi mjaft e mirë për të përmirësuar performancën e përgjithshme të shërbimeve të Bashkisë.
- Dukë qënë që është i orientuar drejt fitimit, sektori privat ofron kontroll më të mirë të standardeve operative dhe teknike, etj.
- Kontraktimi i shërbimeve të largimit të mbetjeve voluminoze, mbetjeve të riciklueshme apo dhënia me koncension e impianteve apo aktiviteteve për trajtimin



mbetjeve ( përfshirë edhe Stacionin e Transferimit të Mbetjeve ), duhet të shihet si një mundësi për të tërhequr investime nga sektori privat në infrastrukturën e mbetjeve.

- Përfshirja e sektorit privat me anë të koncesionit apo partneritetit publik-privat duhet të nxitet si një mekanizëm për të ofruar një zgjidhje më të mirë ekonomike dhe që mund të jetë e pranueshme nga pikëpamja mjedisore.
- Sektori privat mund të marrë pjesë në secilën nga veprimtaritë e administrimit të mbetjeve të ngurta, siç jepet edhe më poshtë:
  - Ofrimi i mjeteve apo makinerive të rënda – me qira ose marrëveshje qiraje me pronarët e pajisjeve.
  - Fshirja apo pastrimi i rrugëve dhe zonave të hapura – me kontratë shërbimi.
  - Mbledhja e mbetjeve të përgjithshme urbane nga të gjitha lagjet – me kontratë shërbimi.
  - Riparimi i mjeteve të bashkisë për mbetjet urbane – me kontratë shërbimi sipas nevojave apo me kontratë afatgjatë.
  - Ofrimi i kontenerëve të posaçëm për skemat e minimizimit të mbetjeve Operimi i ST – me kontratë shërbimi ose koncesion.
  - Mbledhja e mbetjeve komerciale nga hotelet, zyrat, tregjet apo dyqanet.
  - Vjelja e tarifave të përdoruesit apo taksave të mbetjeve Bashkia ose me të drejtë ekskluzive për mbledhjen e tarifave me agjentë UKE, OSHEE, etj.

## Ndergjegjesimi publik

Për të siguruar mirëfunktionimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve, rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve si dhe sigurimin e pastërtisë në nivele të kërkuara në territorin e Bashkisë, është shumë i domosdoshëm përfshirja dhe ndergjegjesimi i komunitetit.

- Komuniteti jo vetëm duhet të kuptojë funksionimin e sistemit, por duhet ta mbështesë atë.
- Suksesi i çdo skeme menaxhimi mbetjesh bazohet plotësisht nga mbështetja e përdoruesve.
- Konsumatorët si familjet, bizneset apo institucionet, në sajë të një fushatë të fortë ndergjegjesimi mund të ndikojnë në përmirësimin e sistemit të grumbullimit, duke zbatuar kërkesat e hedhjes dhe ndarjes së mbetjeve dhe duke penguar materialet e padëshirueshme ( psh. mbetjet e rrezikshme ), të hyjnë në rrymën e mbetjeve të grumbulluara.
- Ndergjegjesimi publik ndaj çështjeve të mbetjeve dhe nivelit të pastërtisë, konsiderohet si një prioritet dhe objektiv primar krahas objektivave të tjerë që lidhen me infrastrukturën apo medepozitimimin e sigurtë të mbetjeve.

Ka disa mënyrë për të rritur ndergjegjesimin publik për çështjet e mbetjeve dhe për të dhënë informacion se si mund të trajtohen ato, me një kosto relativisht të ulët, por mjaft efektive për arritjen e objektivit.

Hartimi i një plani ndergjegjesimi do të mundësojë:

- \* Ofrimin e një informacioni të përgjithshëm dhe të veçantë për publikun në lidhje me nismat vendore të mbledhjes, riciklimit të mbetjeve, pastërtisë së territorit dhe koston së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve.
- \* Ndergjegjesimin e publikut për detyrimet ligjore, rregullat dhe detyrimet vendore.
- \* Nxitjen e qëndrimit miqësor ndaj mjedisit.

Metoda për komunikimin dhe informimin:



Metodat më të përdorura të komunikimit të informacionit janë broshurat, artikujt në gazeta, njoftimet, dhe reklamat në TV dhe radio lokale, dhe fletëpalosje që shpërndahen në shkolla. Një zhvillim të lartë sot në vend ka edhe teknologjia e informacionit si edhe aksesit në internet. Kjo teknologji si edhe tërheqja pas rrjeteve sociale të komunitetit ( kryesisht atij në moshë të re ) mund të jetë një mundësi e mirë për komunikimin dhe informimin e publikut për shkak edhe të kostos së ulët si edhe shpejtësisë që ofron. Gjithashtu mund të shfrytëzohen dhe evente të karaktereve të ndryshme ( festa, tubime, koncerte ), ku ka grumbullime të mëdha njerëzish dhe ku informimi dhe komunikimi me publikun bëhet më i lehtë. Në programet e riciklimit apo minimizimit të mbetjeve metoda më e mirë është ajo “derë më derë”. Kjo metodë fton konsumatorët në nismat e riciklimit dhe kompostimit, për të përmirësuar qëndrimin e tyre ndaj ndarjes së mbetjeve në burim, për të zbatuar rregullat dhe respektuar oraret.

Banorëve dhe bizneseve iu shpërndahen fletë informative për llojet e mbetjeve që mund të riciklohen, kompostohen dhe mënyrën se si ato duhet të veprojnë për t’u bërë pjesë e procesit. Përdorimi i makinave teknologjike që shërbejnë për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve apo kontenierët për informim: Tek të gjithë makinat dhe nëse është e mundur tek kontenierët e mbetjeve duhet të shkruhet qartë dhe lehtësisht e lexueshme një slogane domethënëse për të mbajtur pastër zonën, numrin e telefonit të ofruesit të shërbimit si dhe numrin e telefonit falas që caktohet nga autoritetet vendore, sipas një formati të miratuar paraprakisht.

Marrja e opinionëve të qytetarëve:

Një tjetër çështje e rëndësishme është krijimi i mekanizmave për marrjen e mendimeve dhe reagimit të qytetarëve: si mund të ftohet publiku t’i japë Bashkisë mendime apo opinione ose komente për shërbimin e mbetjeve?

Dy metodat kryesore për të marrë mendimin e publikut janë:

1. Mundësia e publikut për t’u ankuar: Bashkia apo operatori i shërbimit duhet të ketë zyrën e kontaktit/informacioni për të marrë ankesat. Numri i ankesave dhe zgjidhja e tyre është një nga parametrat e matjes së performancës së institucionit lidhur me menaxhimin e mbetjeve.
2. Vlerësimi i kërkesës dhe sondazhi/studimi i “vullnetit për të paguar”.

Për të vlerësuar:

- Kërkesën, vullnetin dhe mundësinë për të paguar, lind nevoja për të komunikuar me përfittuesit e mundshëm të shërbimit lidhur me alternativat e shërbimit, kostot, buxhetin dhe tarifën.
- Për secilën zonë të komunitetit apo zonë për t’u përfshirë në sondazh, kampionet që duhet të realizohen duhet të variojnë midis 100 dhe 200 të intervistuar.
- Kjo praktikë duhet të kryhet periodikisht nga Bashkia, ose sa herë ajo e shikon të arsyeshme për të marrë opinionin e publikut në lidhje me vlerësimin e performancës të shërbimit.

**Fushata e informimit në Bashkinë Elbasan gjatë hartimit të planit:**

Gjatë fazës të hartimit të planit Bashkia Elbasan ka zhvilluar dëgjesa publike me komunitetin e të gjitha njësive administrative dy faza të ndryshme:

- Faza e parë për prezantimin e tarifës së re të pastrimit në sajë të rritjes së tarifës të Landfillit.
- Faza e dytë për prezantimin e skenarëve të planit të menaxhimit të mbetjeve.



Në të gjithë Bashkinë janë zhvilluar disa dëgjesa publike, me pjesëmarrjen e komunitetit pothuajse në të gjithë Njësitet Administrative.

Ndërkohë në Njësitet Administrative, stafi i Bashkisë organizoi takime edhe me komunitetin e bizneseve për diskutimin e tarifës së re të pastrimit për kategoritë e ndryshme të bizneseve të mëdha dhe të vogla.

Gjatë diskutimeve që ka zhvilluar stafi i Bashkisë me komunitetin ata kanë shprehur gadishmërinë e tyre për të paguar tarifën e re, duke vlerësuar faktin se shërbimi i pastrimit është një ndër shërbimet publike me cilësinë më lartë në zonën e tyre.

Ndonëse një pjesë e tyre kanë shprehur rezerva në lidhje me rritjen e tarifës, stafi i Bashkisë ka shpjeguar teknikisht nevojën për një menaxhim më cilësor të Landfillit me një kosto më të lartë, duke sjellë edhe si pajojë rritjen e tarifës hyrëse të mbetjeve në Landfill e ri.

Në lidhje me dëgjesat publike për skenarët e planit, komuniteti është shprehur mjaft pozitiv me shërbimet e reja që bashkia kërkon të ofrojë në kontratat e reja dhe shpreh gadishmërinë e tij në pagesën e tarifës dhe në kontributin për zhvillimin shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve në tre zonat e reja të mbetjeve që Bashkia kë përcaktuar.

Model për hartimin e një fushatë informimi për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve dhe skemave për minimizimin e tyre:

Ky program, do t'ju vijë në ndihmë jo vetëm komunitetit, i cili do të njihet me skemat e reja dhe iniciativat pilot të riciklimit dhe kompostimit, por edhe nxënësve të shkollave, të cilët do të marrin iniciativën për t'u njohur me skemat e menaxhimit të mbetjeve dhe do të jenë pjesë e procesit të riciklimit dhe kompostimit, në nivel komuniteti apo në ambientet e shkollave.

Objektivat potencialë të një fushate ndërgjegjësimit dhe informimi mund të formulohen nga Bashkia si më poshtë:

1. Ndërgjegjësimin dhe informimin e qytetarëve në të gjithë zonën e parashikuar në lidhje me skemat e reja të menaxhimit të mbetjeve, si do të kryhen, si dhe angazhimin e tyre konkret në aplikimin e tyre.
2. Ndërgjegjësimin dhe rritja e numrit të qytetarëve që paguajnë tarifën për shërbimet e mbetjeve.
3. Mbështetje në aplikimin e skemave nxitëse për tarifa më të ulta të mbetjeve në sajë të angazhimit të komunitetit në aplikimin e skemave të riciklimit dhe kompostimit, duke përmirësuar në këtë mënyrë edhe shërbimin dhe cilësinë e mjedisit.
4. Rritja e numrit të qytetarëve dhe nr. nxënësve të shkollave të informuar në lidhje me procesin e e minimizimit të mbetjeve ( riciklim apo kompostim ) dhe njëkohësisht që janë gati të ndërmarrin iniciativën për riciklimin e mbetjeve, si plastika, alumini, letra apo fillimin e skemave të kompostimit në zonat rurale.
5. Ndërgjegjësimin dhe informimin e qytetarëve në të gjithë zonën e parashikuar në lidhje me procesin se si do të kryhet riciklimi dhe kompostimi, si dhe angazhimi i tyre konkret në aplikimin e skemave.
6. Prezantimin e skemave të ndryshme të minimizimit të mbetjeve për kategori të ndryshme të qytetarëve dhe aktorëve që do të përfshihen në këtë iniciativë.
7. Prezantimin e modeleve/metodave që do të ndihmojnë në informimin dhe trajnimin e aktorëve të interesuar në aplikimin konkret të riciklimit dhe kompostimit të mbetjeve.
8. Prezantimin e skemave nxitëse për rritjen e pjesëmarrjes të aktorëve që do të aplikojnë skemat e minimizimit të mbetjeve.
9. Promovimi i mbrojtjes së mjedisit urban dhe rural.



Fushata ndërgjegjësuere dhe komunikuese do të jetë pjesë e programit të Bashkisë, ku ajo do të marrë përsipër zbatimin e saj në të gjithë territorin e saj.

Me anë të këtij programi bashkia duhet të synojë që periodikisht ( ashtu siç është përcaktuar edhe në hapat më poshtë ) gjatë gjithë vitit, të zhvillojë fushata intensive ndërgjegjësimi dhe informimi për komunitetin dhe specifiku për nxënësit e shkollave.

Bashkia duhet të sigurojnë burimet e nevojshme financiare dhe njerëzore për të realizuar periodikisht gjatë vitit këtë program.

Në lidhje me burimet financiare Bashkia do të parashikojnë si fillim në buxhetin e saj një zë të veçantë për programin e ndërgjegjesimit dhe informimit, ku duhet të merret në konsideratë elementet si më poshtë:

Shembull i programit të ndërgjegjesimit dhe informimit

Tema e fushatës:

## Rritja e njohurive të komunitetit dhe nxënësve në lidhje me skemat e manaxhimit të mbetjeve

Veprimtari paraprake e ndërgjegjesimit:

- Bashkia do të promovojë në vazhdim me komunitet apo në zonat pilot, ide dhe mënyra të reja për manaxhimin e mbetjeve, si prezantimi i skemave të reja për grumbullimin e mbetjeve ( në burim), ndarjen e mbetjeve, ripërdorimi i mbetjeve, metodat alternative të dorëzimit të mbetjeve, etj., duke ndërmarrë fushata ndërgjegjësimi për publikun e gjerë, të fokusuar për disa konsumatorë apo në një zonë pilot.
- Synimi për këtë fazë është t'i informojë komunitetin se është marrë një vendim për aplikimin e një skeme të re; apo se ekziston një mënyrë tjetër më e preferueshme për manaxhimin e mbetjeve në krahasim me mënyrën tradicionale; dhe se ekzistojnë arsye të mira për të ndërmarrë një ndryshim në praktikën aktuale të manaxhimit të mbetjeve.
- Shpërndarja e këtij informacioni në publik duhet të vijë jo vetëm si një vendim i marrë në nivel Bashkie, por edhe në formën e një kërkesë ( me anë të një pyetësi, i cili do të vlerësojë nevojat e komunitetit dhe mendimi që ka komuniteti për aplikimin e skemave të reja të manaxhimit të mbetjeve ).
- Nisur nga ky fakt, Bashkia mund të fillojë fushatën e ndërgjegjesimit me anë të një pyetësi, i cili mund të përsëritet periodikisht ( 1-2 herë në vit ), për të vlerësuar si fillim opinionin e tyre në lidhje me gjendjen ekzistuese të manaxhimit të mbetjeve dhe prezantimit të metodave të reja të manaxhimit të mbetjeve, si ndarja në burim, riciklimi, kompostimi i mbetjeve.
